



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2022 – Numri: 81

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 31 maj 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 18.5.2022	Për përcaktimin e rregullave për krijimin, aksesin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve..... 10203
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 26.5.2022	Për emërim në detyrë..... 10206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 26.5.2022	Për emërimin në detyrë të disa anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile..... 10206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 26.5.2022	Për emërimin e një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura..... 10206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 26.5.2022	Për transferimin, në pronësi të Bashkisë Krujë, për Njësinë Administrative Fushë-Krujë, të një pjese të pasurive 303, 173, 174/2 dhe të pasurisë 174/1, me vendndodhje në zonën kadastrale 1665..... 10206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 340, datë 26.5.2022	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2022, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave..... 10212
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 26.5.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 10213
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 345, datë 26.5.2022	Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë..... 10244
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 26.5.2022	Për sigurimin e jetës së personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohet në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit..... 10246

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 26.5.2022	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Kukësit.....	10247
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 26.5.2022	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre”.....	10247
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 26.5.2022	Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve, që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit.....	10260
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 26.5.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 71, datë 2.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit nga punonjësit dhe ish-punonjësit e Rafinerisë së Naftës, Ballsh”.....	10268
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 26.5.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1090, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për funksionimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues, për mënyrën e komunikimit në formë elektronike dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve përgjegjëse shtetërore, si dhe për mënyrën e afatet e komunikimit mes Regjistrit të Pronarëve Përfitues, Regjistrit Tregtar dhe Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse”.....	10268
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 26.5.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit ‘Për akcizat’”, të ndryshuar.....	10269
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 26.5.2022	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e degëve të thesarit.....	10270
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 26.5.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar.....	10273
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 356, datë 26.5.2022	Për përcaktimin e organizatave të punëdhënësve dhe të organizatave sindikale në Këshillin Kombëtar të Punës.....	10291
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 26.5.2022	Për përcaktimin e kriterëve dhe të rregullave të transferimit të të drejtave minerare nga zotëruesi.....	10291
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 26.5.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Sistemim-asfaltim i rrugës ‘Fuat Toptani’”.....	10294

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 363, datë 26.5.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim”, të ndryshuar.....	10301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 367, datë 30.5.2022	Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme.....	10301
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 26.5.2022	Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga rekursat e depozituara nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të pashqyrtuara nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative.....	10304
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 234, datë 24.5.2022	Për delegim kompetence.....	10305
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 313, datë 24.5.2022	Për delegim kompetencash.....	10306



VENDIM
Nr. 323, datë 18.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR KRIJIMIN, AKSESIN,
FUNKSIONIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E REGJISTRIT
ELEKTRONIK TË ARMËVE, PJSËVE
KRYESORE DHE MUNICIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 10, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e regjistrit elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, i cili menaxhohet nga Policia e Shtetit.

2. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, krijohet mbi bazën e të dhënave të armëve, pjesëve kryesore të tyre, municioneve, si dhe të dhënave për personat fizikë dhe juridikë, që i kanë ato në pronësi.

3. Regjistri i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, mbahet në format elektronik në sistem të informatizuar.

4. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë është sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, përmban të dhëna për:

a) gjeneralitetet e personit fizik ose juridik, që ka në pronësi armën/armët e zjarrit, pjesët kryesore të tyre dhe municionet, përfshirë adresat e furnitorëve, së bashku me datën ose datat përkatëse;

b) armën/armët e zjarrit, pjesët kryesore të tyre dhe municionet, si:

i. llojin, markën, modelin, kalibrin, numrin e serisë së çdo arme zjarri dhe markimin e vendosur në pjesën kryesore për çdo armë zjarri;

ii. numrin e serisë ose markimin unik të vendosur në pjesët kryesore të çdo arme zjarri, në rastin kur ndryshon nga markimi në trupin ose djepin e armës së zjarrit;

c) licencën, autorizimin dhe vendimin për pajisjen me armë zjarri;

ç) dokumentet e pajisjes dhe heqjes së armës së zjarrit;

d) çdo modifikim që i bëhet armës së zjarrit dhe që çon në ndryshimin e kategorisë apo nënkategorisë së saj, duke përfshirë çaktivizimin apo shkatërrimin e certifikuar të saj, si dhe datën ose datat përkatëse;

dh) certifikatën e çaktivizimit.

6. Të dhënat, që administrohen në regjistrin elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, mund të aksesohen nga autoritetet kompetente për:

a) lëshimin ose revokimin e autorizimeve e licencave;

b) parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale.

7. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë menaxhohet nga Policia e Shtetit, duke garantuar, si vijon:

a) organet përgjegjëse të Policisë së Shtetit janë subjekte, të cilat plotësojnë të dhënat në regjistrë, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;

b) organeve përgjegjëse të Policisë së Shtetit u garantohet aksesimi për leximin e të dhënave, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre;

c) organit të prokurorisë dhe gjykatës u garantohet aksesimi për leximin e të dhënave në regjistrin elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë. Aksesimi i të dhënave do të mundësohet duke përdorur lidhje VPN (*Virtual Private Network*) me rrjetin e Policisë së Shtetit.

8. Afati i ruajtjes së të dhënave të regjistrit elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, është:



a) për lëshimin ose revokimin e autorizimeve e licencave, për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh, pas shkatërrimit/çaktivizimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore;

b) për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale, ose ekzekutimin e dënimeve penale, për një periudhë prej 30 (tridhjetë) vjetësh, pas shkatërrimit/çaktivizimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore.

9. Vendimi nr. 292, datë 8.4.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për

krijimin dhe administrimin e regjistrit të armëve”, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 334, datë 26.5.2022

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Hantin Bonati emërohet zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 335, datë 26.5.2022

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DISA ANËTARËVE TË BORDIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin në detyrë të disa anëtarëve të Bordit Mbiqëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, si më poshtë vijon:

- Z. Bashkim Muça;
- Znj. Iris Luarasi;
- Z. Leart Kola;
- Z. Ylljet Aliçka;
- Znj. Vasilika Hysi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 336, datë 26.5.2022

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 5, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Genci Gjeçi emërohet anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 338, datë 26.5.2022

PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË KRUIJË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE FUSHË-KRUIJË, TË NJË PJESE TË PASURIVE 303, 173, 174/2 DHE TË PASURISË 174/1, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 1665

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Krujë, për njësinë administrative Fushë-Krujë, të një pjese



të pasurive 303, 173, 174/2 dhe të pasurisë 174/1, me vendndodhje në zonën kadastrale 1665, sipas formularit dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në funksion të procesit të rindërtimit në njësinë administrative Fushë-Karujë, për të prekurit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

2. Ngarkohen Bashkia Krujë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

A		B					Të dhëna të tjera. (Shënime të veçanta)				
		Zona kadastrale dhe indeksi hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, Adresa	Sip. Totale e pronës (m ²)		Nga sip. Totale: Sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni /Enti përgjegjës administrative	Institucioni/Endi përdorues. Statusi juridik i përdorimit
Nr. Rend.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	1	1665 K-34-88-(136-C)	303-A	Kullotë	"Ish Serat" Fushë-Krujë	2800		Rindërtim, Zona e re për zhvillim në Fushë-Krujë	Bashkia Krujë	Bashkia Krujë	
	2	1665 K-34-88-(136-C)	173-A	Arë	"Ish Serat" Fushë-Krujë	29297		Rindërtim, Zona e re për zhvillim në Fushë-Krujë	Bashkia Krujë	Bashkia Krujë	
	3	1665 K-34-88-(136-C)	174/1	Arë	"Ish Serat" Fushë-Krujë	30000		Rindërtim, Zona e re për zhvillim në Fushë-Krujë	Bashkia Krujë	Bashkia Krujë	
	4	1665 K-34-88-(136-C)	174/2-A	Arë	"Ish Serat" Fushë-Krujë	35695		Rindërtim, Zona e re për zhvillim në Fushë-Krujë	Bashkia Krujë	Bashkia Krujë	

Identifikues: Luzim Daka, Kryetar i Bashkisë Krujë

Supervizori: Eriša Daci, Drejtor B.M.T.P.

Aprovoi: Kryetari i Bashkisë Krujë

Fusha e përdorimit të pronës: Rindërtim (Zona e re për zhvillim në Fushë-Krujë)



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE						3																																			
PRONARI: SHTET		DATË: 26.11.2021		QËLLIMI: TRANSFERIM																																					
VENDNDODHJA																																									
BASHKIA: KRUIË	DVASHK/ZVASHK :KRUIË	ZONA KADASTRALE: 1665	NUMRI PASURISË :303-A	INDEX HARTE:K-34-88-(136-C)																																					
TË DHËNAT E PASURISË																																									
LLOJI PASURISË: KULLOTË	SIP.PASURISË=2800m2	SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT=___m2	NUMRI KATEVE: ___	NUMRI PEMËVE:___																																					
X=476904.25	KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE					X=477391.10																																			
Y=4594686.55						Y=4594686.55																																			
SH 1:2500																																									
						KOORD X ; KOORD Y KRGJSH Pasuria nr.303-A Pika 1. 477007.812; 4594421.389 Pika 2. 477124.519;4594631.808 Pika 3. 477149.542;4594665.109 Pika 4. 477158.874;4594671.219 Pika 5. 477016.371;4594416.486																																			
X=476904.25						X=477391.10																																			
Y=4594363.13						Y=4594363.13																																			
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PËRDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHËNIME TË REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td></td> <td>RRUGË</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td></td> <td>303-B</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td></td> <td>173-A</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERËNDIM</td> <td></td> <td></td> <td>419</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>							Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT	1	VERI			RRUGË			2	JUG			303-B			3	LINDJE			173-A			4	PERËNDIM			419		
Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT																																			
1	VERI			RRUGË																																					
2	JUG			303-B																																					
3	LINDJE			173-A																																					
4	PERËNDIM			419																																					
REALIZOI PËR BASHKINË KRUIË: Drejtoria e menaxhimit të tokës dhe pronave: Ing.Erisa Daci Drejtori: Erisa Daci KONFIRMIMI: KRYETARI I BASHKISË ARTUR BUSHI			TEKNOLOGJIA E MATJEVE:Z-Zyrë; O-Ortofoto Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PËRCAKTIMI KUFIRIT:HK-Harta Kadastrale Kode për përcaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHËNIME TË VEÇANTA: Pasuria me nr.303 ZK 1665 me sip= 3000 m2 e llojit Kullotë sipas kartelës së pasurisë, lëshuar me datë 04.02.2021 nga ASHK Krujë, nga e cila 303-A sip=2800 m2 nga matjet sipas ortofotos dhe koordinatave të vendit nr.63 datë 29.01.2020, kërkohet ti kalojë në pronësi Bashkisë Krujë.																																						
PRONARI/BASHKËPRONARET-DEKLARIM MBI MARRËDHENIET ME KUFITARËT NËNSHKRIMI/																																									
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																									



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE																					
PRONARI: SHTET		DATË: 26.11.2021		QËLLIMI: TRANSFERIM																	
VENDNDODHJA																					
BASHKIA: KRUIË		DVASHK/ZVASHK :KRUIË		INDEX HARTE:K-34-88-(136-C)																	
TË DHËNAT E PASURISË																					
LLOJI PASURISË: ARË		SIP.PASURISË=29297m2		SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT=___m2																	
				NUMRI KATEVE: ___																	
				NUMRI PEMËVE: ___																	
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																					
X=476945.10 Y=4594688.76				X=477431.95 Y=4594688.76																	
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th colspan="2">KOORD X ; KOORD Y</th> </tr> <tr> <th colspan="2">KRGJSH</th> </tr> <tr> <th colspan="2">Pasuria nr.173-A</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Pika 1.</td> <td>477016.371; 4594416.486</td> </tr> <tr> <td>Pika 2.</td> <td>477158.874; 4594671.219</td> </tr> <tr> <td>Pika 3.</td> <td>477164.899; 4594669.288</td> </tr> <tr> <td>Pika 4.</td> <td>477247.370; 4594622.225</td> </tr> <tr> <td>Pika 5.</td> <td>477103.956; 4594368.483</td> </tr> </tbody> </table>						KOORD X ; KOORD Y		KRGJSH		Pasuria nr.173-A		Pika 1.	477016.371; 4594416.486	Pika 2.	477158.874; 4594671.219	Pika 3.	477164.899; 4594669.288	Pika 4.	477247.370; 4594622.225	Pika 5.	477103.956; 4594368.483
KOORD X ; KOORD Y																					
KRGJSH																					
Pasuria nr.173-A																					
Pika 1.	477016.371; 4594416.486																				
Pika 2.	477158.874; 4594671.219																				
Pika 3.	477164.899; 4594669.288																				
Pika 4.	477247.370; 4594622.225																				
Pika 5.	477103.956; 4594368.483																				
X=476945.10 Y=4594338.04		SH 1:2500		X=477431.95 Y=4594338.04																	
Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT															
1	VERI			RRUGË																	
2	JUG			173/1																	
3	LINDJE			391																	
4	PERËNDIM			303-A																	
REALIZOI PËR BASHKINË KRUIË:			TEKNOLOGJIA E MATJEVE:Z-Zyrë; O-Ortofoto																		
Drejtorja e menaxhimit të tokës dhe pronave: Ing.Erisa Daci			Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;																		
Drejtori: Erisa Daci			PËRCAKTIMI KUFIRIT:HK-Harta Kadastrale																		
			Kode për përcaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;																		
KONFIRMOI:			SHËNIME TË VEÇANTA:																		
KRYETARI I BASHKISË ARTUR BUSHI			Pasuria nr.173 sipas kartelës së pasurisë sip.=30000 m2 Arë, nga matjet sipas ortofotos dhe koordinatave të vendimit nr.63 datë 29.01.2020 sip.173-A=29297 m2, kërkohet të kalojë në pronësi Bashkië Kruië.																		
			PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHENIET ME KUFITARËT																		
			EMRI: _____																		
			NËNSHKRIMI _____																		
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																					



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE																			
PRONARI: SHTET		DATË: 26.11.2021		QËLLIMI: TRANSFERIM															
VENDNDODHJA																			
BASHKIA: KRUIË		DVASHK/ZVASHK :KRUIË		ZONA KADASTRALE: 1665															
TË DHËNAT E PASURISË		SIPERFAQE GJURMËS NDËRTIMIT=		NUMRI PASURISË :174/1															
LLOJI PASURISË: ARË		SIP.PASURISË=30000m2		INDEX HARTE:K-34-88-(136-C)															
				NUMRI KATEVE: _____															
				NUMRI PEMËVE _____															
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																			
X=476961.37 Y=4594630.91				X=477448.22 Y=4594630.91															
<table border="1"> <thead> <tr> <th>COORD X ; KOORD Y</th> <th>KRGJSH</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td colspan="2">Pasuria nr.174/1</td> </tr> <tr> <td>Pika 1.</td> <td>477094.324; 4594336.361</td> </tr> <tr> <td>Pika 2.</td> <td>477110.992; 4594365.563</td> </tr> <tr> <td>Pika 3.</td> <td>477255.630; 4594617.319</td> </tr> <tr> <td>Pika 4.</td> <td>477335.778; 4594572.231</td> </tr> <tr> <td>Pika 5.</td> <td>477176.463; 4594292.095</td> </tr> </tbody> </table>						COORD X ; KOORD Y	KRGJSH	Pasuria nr.174/1		Pika 1.	477094.324; 4594336.361	Pika 2.	477110.992; 4594365.563	Pika 3.	477255.630; 4594617.319	Pika 4.	477335.778; 4594572.231	Pika 5.	477176.463; 4594292.095
COORD X ; KOORD Y	KRGJSH																		
Pasuria nr.174/1																			
Pika 1.	477094.324; 4594336.361																		
Pika 2.	477110.992; 4594365.563																		
Pika 3.	477255.630; 4594617.319																		
Pika 4.	477335.778; 4594572.231																		
Pika 5.	477176.463; 4594292.095																		
X=476961.37 Y=4594280.18		SH 1:2500		X=477448.22 Y=4594280.18															
Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT													
1	VERI			RRUGË															
2	JUG			392															
3	LINDJE			392															
4	PERËNDIM			391															
REALIZOI PËR BASHKINË KRUIË: Drejtoria e menaxhimit të tokës dhe pronave: Ing.Erisa Daci			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z-Zyrë; O-Ortofoto Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PËRCAKTIMI KUFIRIT: HK-Harta Kadastrale Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;																
KONFIRMOI: KRYETARI I BASHKISË ARTUR BUSHI			SHËNIME TË VEÇANTA: Pasuria nr. 174/1 sip. =30000 m2 Arë sipas kartelës së pasurisë lëshuar me datë 09.07.2021 nga ASHK Krujë, nga matjet sipas ortofotos dhe koordinateve të vendimit nr.63 datë 29.01.2020 sip. =30000 m2, kërkohet të kalojë në pronësi Bashkisë Krujë. PRONARI/BASHKIA PRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHENIET ME KUFITARËT																
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimin e kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																			



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATË: 26.11.2021		QËLLIMI: TRANSFERIM 6		
VENDNDODHJA						
BASHKIA: KRUIË		DVASHK/ZVASHK :KRUIË		ZONA KADASTRALE: 1665		
TË DHËNAT E PASURISË		NUMRI PASURISË :174/2-A		INDEX HARTE:K-34-88-(136-C)		
LLOJI PASURISË: ARË						
SIP.PASURISË=35695m2		SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT=___m2		NUMRI KATEVE: ___		
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
X=477004.12				X=477490.97		
Y=4594579.28				Y=4594579.28		
KOORD X ; KOORD Y KRGJSH Pasuria nr.174/2-A Pika 1. 477278.128; 4594237.452 Pika 2. 477179.896;4594289.334 Pika 3. 477338.990;4594571.267 Pika 4. 477435.145;4594517.361						
X=477004.12		SH 1:2500		X=477490.97		
Y=4594228.55				Y=4594228.55		
Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1	VERI			RRUGË		
2	JUG			392		
3	LINDJE			174/2-B		
4	PERËNDIM			392		
REALIZOI PËR BASHKINË KRUIË: Drejtoria e menaxhimit të tokës dhe pronave: Ing.Erisa Daci Drejtori: Erisa Daci			TEKNOLOGJIA E MATJEVE:Z-Zyrë; O-Ortofoto Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PËRCAKTIMI KUFIRIT:HK-Harta Kadastrale Kode për përcaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;			
KONFIRMOI: KRYETARI I BASHKISË ARTUR BUSHI 			SHËNIME TË VEÇANTA: Pasuria nr.174/2 sipas kartelës së pasurisë sip.=40000 m2 Arë, nga matjet sipas ortofotos dhe koordinatave të vendimit nr.63 datë 29.01.2020 sip.174/2-A=35695 m2, kërkohet ti kalojë në pronësi Bashkisë Kruië.			
			PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHENIET ME KUFITARËT			
Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale						



VENDIM
Nr. 340, datë 26.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT
2022, PËR BASHKËSITË FETARE QË
KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE
ME KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3, 4, 5 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin, nga buxheti i shtetit, të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, prej 113 000 000 (njëqind e trembëdhjetë milionë) lekësh, nga buxheti i vitit 2022, e miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 33 600 000 (tridhjetë e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 13 824 000 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e katër mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 72 (shtatëdhjetë e dy) punonjës të administratës;

ii. 19 776 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 103 (njëqind e tre) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 26 496 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të ndarë:

i. 20 160 000 (njëzet milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 105 (njëqind e pesë) punonjës të administratës;

ii. 6 336 000 (gjashtë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 33

(tridhjetë e tre) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 26 496 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të ndarë:

i. 6 528 000 (gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 34 (tridhjetë e katër) punonjës të administratës;

ii. 19 968 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 104 (njëqind e katër) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 26 408 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e tetë mijë) lekë, të ndarë:

i. 4 992 000 (katër milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 26 (njëzet e gjashtë) punonjës të administratës;

ii. 14 416 000 (katërmëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, si kontribut në ndërtimin e Teqesë së Elbasanit;

iii. 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshitë Botërore me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj në kërkesën e vitit 2022, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur.

2. Kalimi i fondit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të bëhet njëherësh, brenda muajit maj të vitit 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 341, datë 26.5.2022

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen këto shtesa:

a) në pikën 7, pas fjalëve “... (CFSP) 2022/582 ...” shtohen “... (CFSP) 2022/627, (CFSP) 2022/660 ...”;

b) në fund të pikës 19 shtohen fjalët “... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/596.”;

c) në fund të pikës 26 shtohen fjalët “... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/628.”.

2. Në aneksin 7, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2022/627 dhe (CFSP) 2022/660, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në aneksin 19, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2022/596, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Në aneksin 26, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2022/628, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIMET

VENDIM I KËSHILLIT TË EVROPËS (CFSP) 2022/596

i datës 11 prill 2022

ndryshimin e Vendimit 2011/235/CFSP në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë

të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, duke pasur parasysh:

- (1) Më 12 prill 2011, Këshilli i Evropës miratoi Vendimin 2011/235/CFSP⁽¹⁾.
- (2) Në bazë të një rishikimi të Vendimit 2011/235/CFSP, Këshilli i Evropës konsideron se masat kufizuese të përcaktuara në të duhet të rinovohen deri më 13 prill 2023.
- (3) Tre persona të caktuar në Aneksin e Vendimit 2011/235/CFSP kanë vdekur dhe shënimet në lidhje me ta duhet të hiqen nga Shtojca. Këshilli gjithashtu ka arritur në përfundimin se shënimet në lidhje me 25 persona të përfshirë në Aneksin e Vendimit 2011/235/CFSP duhet të përditësohen.
- (4) Prandaj, Vendimi 2011/235/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/235/CFSP ndryshohet si më poshtë:

- (1) në nenin 6, paragrafi 2 zëvendësohet si vijon:

'2. Ky Vendimdo të zbatohet deri më 13 prill 2023. Ai do të mbahet nën shqyrtim të vazhdueshëm. Ai do të rinovohet, ose do të ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.';

- (2) Shtojca/Aneksi ndryshohet siç përcaktohet në Aneksin e këtij vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Luksemburg, 11 prill 2022.

Për Këshillin e Evropës
Presidenti
J. BORRELL FONTELLES

⁽¹⁾Vendimi i Këshillit të Evropës 2011/235/CFSP i 12 prillit 2011 në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (OJ L 100, 14.4.2011, f. 51).



L 114/69

Shqip

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

12.4.2022

ANEXSI

Aneksi i Vendimit 2011/235/CFSP ("Lista e personave dhe subjekteve të përmendura në nenet 1 dhe 2") është ndryshuar si më poshtë:

(1) të dhënat e regjistruara 27 (në lidhje me ZARGAR Ahmad), 38 (në lidhje me gjeneralmajor FIRUZABADI Dr-Seyyed Hasan) dhe 41 (në lidhje me HEJAZI Mohammad) në listën e titulluar "Personat" janë fshirë;

(2) të dhënat e regjistruara për 25 personat e mëposhtëm zëvendësohen me sa vijon:

Persona

Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
1. AHMADI-MOQADDAM Esmail	Vendi i Lindjes: Teheran (Iran) Data e Lindjes: 1961 Gjinia: Mashkull	Drejtor i Universitetit dhe Institutit të Lartë të Kërkimeve të Mbrojtjes Kombëtare që prej 20 shtatorit 2021. Ish-këshilltar i lartë për çështjet e sigurisë i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shefi i Policisë Kombëtare të Iranit nga viti 2005 deri në fillim të vitit 2015. Gjithashtu kreu i Policisë Kibernetike Iraniane (të listuara në BE) nga janari 2011 deri në fillim të 2015. Forcat nën komandën e tij udhëhoqën sulme brutale ndaj protestave paqësore dhe një sulm të dhunshëm gjatë natës në konvikte të Universitetit të Teheranit më 15 qershor 2009. Ish-kreu i Shtabit të Iranit në mbështetje të popullit jemenas.	12.4.2011
20. MOGHISSEH Mohammad (a.k.a. NASSERIAN)	Gjinia: Mashkull	Gjyqtar në Gjykatën e Lartë që nga nëntori 2020. Ish-kreu i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 28. Gjithashtu konsiderohet përgjegjës për dënimet e anëtarëve të komunitetit Bahai. Ai është marrë me raste pasqëndrore. Ai dha dënime të gjata me burgim gjatë gjyqeve të padrejta të aktivistëve shoqërorë dhe politikë dhe gazetarëve, si dhe dënimet me vdekje për protestuesit dhe aktivistët socialë dhe politikë.	12.4.2011
21. MOHSENI-EJEL Gholam-Hossein	Vendi i Lindjes: Ejiyeh (Iran) Data e lindjes: rreth 1956 Gjinia: Mashkull	Shefi Drejtësisë që nga korriku 2021. Anëtar i Këshillit të Përshtatshmërisë. Prokuror i Përgjithshëm i Iranit nga shtatori 2009 deri në vitin 2014. Ish zëvendësryetar i gjyqësorit (2014 deri në korrik 2021) dhe zëdhënës i gjyqësorit (2010-2019). Ministër i Inteligjencës nga viti 2005 deri në vitin 2009. Ndërsa ai ishte Ministër i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të 2009, agjentët e inteligjencës nën komandën e tij ishin përgjegjës për ndalimin dhe torturimin dhe nxjerrjen e rrethimeve të rreme nën presionin e qindra aktivistëve, gazetarëve, disidentëve dhe reformistëve, politikanët. Përveç kësaj, figurat politike u detyruan të bënin rrefime të rreme nën marrje në pyetje të padurueshme, të cilat përfshinin tortura, abuzime, shantazhe dhe kërcënime të anëtarëve të familjes.	12.4.2011
22. MORTAZAVI Saïd (a.k.a. MORTAZAVI Saïeed)	Vendi i Lindjes: Meybod, Yazd (Iran) Data e lindjes: 1967 Gjinia: Mashkull	Drejtes i Sistemit të Mirëqenies nga viti 2011 deri në 2013. Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit deri në gusht 2009. Si Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit, ai lëshoi një urdhrë të përgjithshëm të përdorur për ndalimin e qindra aktivistëve, gazetarëve dhe studentëve. Në janar 2010, një hetim parlamentar e mbajti atë drejtpërdrejt përgjegjës për ndalimin e tre të burgosurve që vdiqën në pas në parburgim. Ai u pezullua nga detyra në gusht 2010 pas një hetimi nga gjyqësori iranian mbi rolin e tij në vdekjen e tre burrave të arrestuar me urdhër të tij pas zgjedhjeve.	12.4.2011



12.4.2022

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

Shqip

L 114/70

	Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
25.	SALAVATI Abdolghassem	Gjinia: Mashkull	<p>Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjen e të burgosurve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane. Ai u lirua nga një gjykatë iraniane më 19 gusht 2015, me akuzë lidhur me torturën dhe vdekjen e tre të rinjve në qendrën e paraburgimit Kahrizak në 2009. U dënua me burg në 2017 dhe u lirua në shtator 2019. Në gusht 2021, Gjykata e Lartë e Iranit nxori një vendim në mbështetje të plotë të Saïd Mortazavit, duke e përmbytur dënimin e tij të mëparshëm me dy vjet burg.</p> <p>Gjyqtar i Gjykatës Speciale për Krimet Financiare, dega 4 që nga viti 2019. Ish-kryetar i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 15. Gjyqtar i kryerjes në Tribunalin e Teheranit. Në krye të çështjeve paszgjedhore, ai ishte gjyqtari që kryesonte 'gjyqet e shfaqjes' në verën e vitit 2009, ai dënoi me vdekje dy monarkistë që u shfaqën në gjyqet e shfaqjes. Ai ka dënuar më shumë se njëqind të burgosur politikë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe demonstrues me burgime të gjata.</p> <p>Në vitin 2018, raportet treguan se ai vazhdoi të jepte dënime të ngjashme pa respektimin e duhur të procedurave të dëgjimit të drejtë.</p>	12.4.2011
28.	YASAGHI Ali-Akbar	Gjinia: Mashkull	<p>Gjyqtar në Gjykatën e Lartë, drejtues i seksionit të 13-të. Zëvendës Kryeshëfi Ekzekutiv i Fondacionit Setad-e Dieh. Kryegjyqtari, Gjykata Revolucionare e Mashhadit (2001-2011). Gjykimet nën juridiksionin e tij janë zhvilluar në mënyrë të përmbledhur dhe në shtesë të mbyllura, pa respektimin e të drejtave themelore të akuzuarit. Meqenëse vendimet e ekzekutimit u nxorën në masë (deri në 550 midis verës 2009 dhe verës 2011), dënimet me vdekje u dhanë pa respektimin e duhur të procedurave të dëgjimit të drejtë.</p>	12.4.2011
30.	ESMAILI Gholam-Hossein (a.k.a. ESMAILI Gholam Hossein)	Gjinia: Mashkull	<p>Shefi i Shtabit të Presidentit Iranian Raisi që nga gushti 2021. Zëdhënës i gjyqësorit nga prilli 2019 deri në korrik 2021. Ish-kreu i gjyqësorit të Teheranit. Ish-kreu i Organizatës së Burgjeve të Iranit. Në këtë çështje, ai ishte bashkëpunëtor në ndalimin masiv të protestuesve politikë dhe mbulimin e abuzimeve të kryera në sistemin e burgjeve.</p>	12.4.2011
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmud	Gjinia: Mashkull	<p>Deputet (që nga shkurti 2020) dhe kryetar i Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Punët e Jashtme. Ish-këshilltar i Këshillit të Lartë të Iranit për të Drejtat e Njeriut (deri në 2019). Ish-sekretar i Këshillit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Ish-guvernator i provincës Ilam. Ish-drejtor politik i Ministrisë së Brendshme. Si Kryetar i Komisionit të Nenet 10 të Ligjit për Veprimtarinë e Partive dhe Grupeve Politike, ai ishte përgjegjës për autorizimin e demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike dhe regjistrimin e partive politike.</p>	10.10.2011



12.4.2022

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

Shqip

L 114/71

	Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
			Në vitin 2010, ai pezulloi aktivitetet e dy partive politike reformiste të lidhura me Mousavi - Fronti i Pjesëmarrjes së Iranit Islamik dhe Organizata Muxhahedine e Revolucionit Islamik. Nga viti 2009 e tutje, ai vazhdimisht dhe në vazhdimësi ka ndaluar të gjitha tubimet joqeveritare, duke mohuar të drejtën kushtetuese për të protestuar dhe duke çuar në arrestime të shumta të demonstruesve paqësorë në kundërshtim me të drejtën e lirisë së tubimit. Në vitin 2009, ai gjithashtu i mohoi opozitës një leje për një ceremoni për të mbajtur zi për njëerëzit e vrarë në protestat për zgjedhjet presidenciale.	
35.	AKHARIAN Hassan	Gjinia: Mashkull	Shefi i Repartit 5 dhe përgjegjës për izolimin në burgun Rajae Shahr të listuar në BE që nga viti 2015; ish-vojtar i reparitit I të burgut Rajae Shahr, Karadj deri në korrik 2010. Disa ish-të burgosur kanë denoncuar përdorimin e tij të torturës, si dhe urdhrat që ai ka dhënë për të parandaluar marrjen e ndihmës mjekësore të të burgosurve. Sipas një transkripti të një të burgosuri të raportuar në burgun Rajae Shahr, të gjithë gardianët e kanë trahur rëndë, me dijeninë e plotë të Akharianit. Ekziston gjithashtu të paktën një rast i raportuar i keqtrajtimit dhe vdekjes së një të burgosuri, Mohsen Beikvand, nën kujdesin e Akharian. Beikvand vdiq në shtator 2010. Të burgosur të tjerë pretendojnë në mënyrë të besueshme se ai u vra me udhëzimet e Hassan Akharian.	10.10.2011
36.	AVAAE Seyyed Ali-Reza (a.k.a. AVAAE Seyyed Alireza, AVAIE Alireza)	Vendi i lindjes: Dezful (Iran) Data e lindjes: 20.5.1956 Gjinia: Mashkull	Ministër i Drejtësisë deri më 25 gusht 2021. Ish-drejtor i zyrës së hetimeve speciale. Zëvendësministër i Brendshëm dhe Drejtues i Regjistrat Publik deri në korrik 2016. Këshilltar në Gjykatën Disiplinore për Gjyqtarët në Prill 2014. Ish-President i Gjyqësorit të Teheranit. Si President i Gjyqësorit të Teheranit, ai ka qenë përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut, arrestimet arbitrare, mohimin e të drejtave të të burgosurve dhe një numër të madh ekzekutimesh.	10.10.2011
46.	KAMALIAN Behrouz (i njohur ndryshe si Brain Hackers, Behrooz_Ice)	Vendi i lindjes: Teheran (Iran) Data e lindjes: 1983 Gjinia : Mashkull	Kreu i grupit kibernetik 'Ashiyaneh' i lidhur me regjimin Iranian. Siguria Dixhitale 'Ashiyaneh', e themeluar nga Behrouz Kamalian, është përgjegjëse për sulme intensive kibernetike si ndaj kundërshtarëve vendas, ashtu edhe ndaj reformistëve dhe institucioneve të huaja. Puna e organizatës 'Ashiyaneh' të Kamalianit ka ndihmuar goditjen e regjimit kundër opozitës, e cila ka përfshirë shkelje të shumta të rënda të të drejtave të njeriut në vitin 2009. Si Kamalian ashtu edhe grupi kibernetik 'Ashiyaneh' kanë vazhduar aktivitetet e tyre të paktën deri në dhjetor 2021	10.10.2011
47.	KHALILOLLAHI Mousa (i njohur ndryshe si KHALILOLLAHI Mousa, ELAHI Mousa Khali)	Vendi i lindjes: Teheran (Iran) Data e lindjes: 1963 Gjinia : Mashkull	Shefi i Drejtësisë i provincës së Azerbajxhanit Lindor. Ish-prokuror i Tabrizit nga viti 2010 deri në vitin 2019. Ai ishte i përfshirë në rastin e Sakineh Mohammadi-Ashtianit dhe është bashkëpunëtor në shkelje të rënda të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.	10.10.2011



12.4.2022

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

Shoqë

L. 114/72

	Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
53.	TALA Hossein (i njohur ndryshe si TALA Hosseyn)	Vendi i lindjes: Teheran (Iran) Data e lindjes: 1969 Gjinia : Mashkull	Kryetar i Bashkisë së Eslamshahri deri në vitin 2020. Ish-deputet iranian. Ish-Guvernatori i Përgjithshëm ("Farmandar") i provincës së Teheranit deri në Shtator 2010, ai ishte përgjegjës për ndërhyrjen e forcave të policisë dhe për rrjedhojë për shtypjen e demonstratave. Ai mori një çmim në Dhjetor 2010 për rolin e tij në represionin pasqegjedor.	10.10.2011
55.	ZEBHI Hossein	Gjinia : Mashkull	Zëvendës Këshilltar i Parë i Gjyqësorit dhe Gjyqtar i Gjykatës së Lartë (kryetar i Degës 41 të Gjykatës së Lartë, që merret veçanërisht me veprat e sigurisë dhe drogat). Zëvendës i Prokurorit të Përgjithshëm të Iranit (2007-2015). Në këtë rol, ai ishte përgjegjës për çështjet gjyqësore të ngritura pas protestave pasqegjdhore të vitit 2009, të cilat u zhvilluan në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Gjithashtu në këtë rol, ai ka falur dënimet e ekzagjeruara për veprat penale të drogës.	10.10.2011
56.	BAHRAMI Mohammad-Kazem	Gjinia mashkull	Drejtues i gjykatës së drejtësisë administrative deri në Prill 2021. Ai ishte bashkëpunëtor në shtypjen e demonstruesve paqësorë në vitin 2009 si kreu i degës së drejtësisë të forcave të armatosura.	10.10.2011
60.	HOSSEINI Dr Mohammad (i njohur ndryshe si HOSSEYNI Dr. Seyyed Mohammad; Seyyed, Sayyed and Sayyid)	Vendi i lindjes: Rafsanjan, Kerman (Iran) Data e lindjes: 23.7.1961 Gjinia : Mashkull	Nënkryetar për çështjet parlamentare nën Presidentin Raisi që nga Gushti 2021. Ish-këshilltar i Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe zëdhënës i YEKTA, një fraksion politik i linjës së ashpër. Ministër i Kulturës dhe Udhëzimeve Islame (2009-2013). Ish-IRGC, ai ishte bashkëpunëtor në shtypjen e gazetave.	10.10.2011
62.	ZARGHAMI Ezzatoollah	Vendi i lindjes: Dezful (Iran) Data e lindjes: 22.7.1959 Gjinia : Mashkull	Ministër i Kulturës, Artizanatit dhe Turizmit që nga 25 Gusht 2021. Anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike dhe Këshillit të Revolucionit Kulturor që nga viti 2014. Ish-drejtues i Transmetimit të Republikës Islamike të Iranit (IRIB) deri në Nëntor 2014. Në mandatin e tij në IRIB, Ai ishte përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. IRIB ka transmetuar rrëfimet e detyruara të arrestuarve dhe një sërë 'show-gjyqesh' në Gusht 2009 dhe Dhjetor 2011. Këto përbejnë një shkelje të qartë të dispozitave ndër-kombëtare për gjykim të drejtë dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.	23.3.2012
64.	KAZEMI Toraj	Gjinia mashkull	Shefi i divizionit të Teheranit të Madh të Policisë Kibernetike të caktuar nga BE-ja deri në Qershor 2020. Në këtë cilësi, ai shpalli një fushatë për rekrutimin e hakerëve të qeverisë për të arritur një kontroll më të mirë të informacionit në internet dhe për të sulmuar faqet "të rrezikshme".	23.3.2012
- (c) organisations and agencies to which the Union has granted the Humanitarian Partnership Certificate or which are certified or recognised by a Member State in accordance with national procedures, provided that the assistance and services referred to in paragraph 1 are necessary for exclusively humanitarian purposes in the non-government-controlled areas of the Donetsk and Luhansk oblasts of Ukraine; or
- (d) Member States' specialised agencies, provided that the assistance and services referred to in paragraph 1 are necessary for exclusively humanitarian purposes in the non-government-controlled areas of the Donetsk and Luhansk oblasts of Ukraine.

1b. In cases not covered by paragraph 1a, and by way of derogation from paragraph 1, the competent authorities of a Member State may grant general or specific authorisations, under such general and specific terms and conditions as they deem appropriate, for the provision of the assistance and services referred to in paragraph 1 after having determined that such assistance and services are necessary for exclusively humanitarian purposes in the non-government-controlled areas of the Donetsk and Luhansk oblasts of Ukraine.

The Member State concerned shall inform the other Member States and the Commission of any authorisation granted under this paragraph within two weeks of any authorisation granted.;



Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 13 April 2022.

For the Council
The President
J.-Y. LE DRIAN



L 120/11

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

21.4.2022

VENDIMET**VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/660****e datës 21 Prill 2022**

për ndryshimin e Vendimit 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

(1) Më 17 Mars 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/145/CFSP⁽¹⁾.

(2) Bashkimi vazhdon të dënojë veprimet dhe politikat që cenojnë integritetin territorial të Ukrainës.

(3) Këshilli konsideron se dy individë duhet të shtohen në listën e personave, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP për rolin e tyre në cenimin ose kërcënimin e integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësinë e Ukrainës dhe për përfitimin nga vendimmarrësit rusë përgjegjës për aneksimin e Krimesë ose destabilizimin e Ukrainës Lindore.

(4) Vendimi 2014/145/CFSP prandaj duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2014/145/CFSP është ndryshuar në përputhje me aneksin e këtij vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 21 Prill 2022.

Për Këshillin

President

J.-Y. LE DRIAN

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit 2014/145/CFSP i 17 Marsit 2014 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës (OJ L 78, 17.3.2014, f. 16).



L. 120/12	Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian	21.4.2022	
Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
211. Serhiy Vitaliyovich KURCHENKO (Ukrainisht: Сергій Віталійович Курченко; Rusisht: Сергей Витальевич КУРЧЕНКО)	Gjinia: Mashkull Data e lindjes : 21.9.1985 Vendi i lindjes: Kharkiv, Ukrainë Kombësia: Ukrainase	<p>Z. Serhiy Kurchenko është një biznesmen Ukrainas. Me mbështetjen e separatistëve pro-Rusë, ai mori kontrollin e disa fabrikave të mëdha metalurgjike, kimike dhe energjetike në zonat e Donbasit të kontrolluara nga separatistët. Kompania e tij "Gaz-Alliance" monopolizoi minierat e qymyrit në Donbas pasi konkurrentët e tij ishin detyruar të dëlinin nga tregu, siç thuhet me ndihmën e Rusisë. Ai organizoi dhe përfitoi nga skema e paligjshme e eksportit të qymyrit të Donbasit në Rusi dhe Evropë, pavarësisht sanksioneve të BE-së. Qymyri i nxjerrë në minierat e zotit Kurchenko është rregjistruar dhe eksportuar ilegalisht përmes porteve Ruse.</p> <p>Z. Kurchenko ndihmoi kompanitë e mëdha Ruse dhe pronat shtetërore për të anashkaluar masat kaufizuese të BE-së duke vepruar si nënkontraktor i tyre në territoret e kontrolluara nga Rusia. Ai ka qenë një ndërmjetës në eksportet ruse të gazit, karburantit dhe energjisë elektrike në pjesët e Donbasit të kontrolluara nga separatistët, gjë që forcoi furnizimet e tyre të pavarura me energji dhe mtoi integrimin e tyre ekonomik me Ukrainën. Për më tepër, ai dërgoi karburant në Gadishullin e Krimesë të pushtuar ilegalisht. Duke vepruar kështu, ai forcoi furnizimin me energji të pavarur të këtij territori. Ai gjithashtu zotëron depon më të madhe të naftës në Gadishullin e Krimesë.</p> <p>Në këtë mënyrë ai përfitoi nga vendimmarrësit rusë përgjegjës për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës Lindore, kreu transaksione me grupet separatiste në rajonin e Donbasit të Ukrainës dhe mbështeti në mënyrë aktive veprime dhe politika që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe sovranitetin dhe pavarësia e Ukrainës.</p>	21.4.2022



234.	<p>Yevgeniy Viktorovich PRIGOZHIN (Евгений Викторович ПРИГОЖИН)</p>	<p>Data e lindjes : 1.6.1961 Vendi i lindjes: Leningrad, ish-BRSS (tani Shën Peter sburg, Federata Ruse) Funksioni: Biznesmen i shquar, me lidhje të ngushta me udhëheqjen politike Ruse</p>	<p>Yevgeniy Prigozhin është një biznesmen i shquar Rus me lidhje të ngushta me Presidentin Putin dhe Ministrinë Ruse të Mbrojtjes. Ai është financuesi dhe kreu jozyrtar i Grupit Wagner, një ent ushtarak i pa inkuorporuar me bazë në Rusi, përgjegjës për vendosjen e mercenarëve të Grupit Wagner në Ukrainë.</p> <p>Concord, i njohur gjithashtu si КОМБИНАТ ПТИЦА И КОНКОРД ООО, një kompani të cilën Prigozhin e themeloi dhe e zotëronte deri në nëntor 2019, dhe një grup kompanish të tjera me lidhje me të, duke përfshirë Concord Management and Consulting LLC dhe Megaline LLC, kanë përfutur nga kontrata të mëdha publike me Ministrinë Ruse e Mbrojtjes pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe pushtimit të Ukrainës Lindore nga separatistët e mbështetur nga Rusia.</p>	21.4.2022
------	---	--	--	-----------

L.120/12

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

21.4.2022

Emri	Informacion identifikues	Arsyzet	Data e listimit
	<p>Personat e lidhur: Lyubov Valentimovna Prigozhina (bashkëshortja); Violetta Prigozhina (nëna) Subjektet e lidhura: Wagner Group, Agjencia e Kërkimeve në Internet, Grupi i Kompanisë Concord, Concord Management and Consulting LLC, Megaline LLC Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull</p>	<p>Prandaj, ai është përgjegjës dhe ka zbatuar në mënyrë aktive veprime që kanë minuar dhe kërcënuar integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. Ai gjithashtu ka përfutur nga vendimmarrësit ruse përgjegjës për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës Lindore.</p>	



DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/660

of 21 April 2022

amending Decision 2014/145/CFSP concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 17 March 2014 the Council adopted Decision 2014/145/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) The Union continues to condemn actions and policies undermining the territorial integrity of Ukraine.
- (3) The Council considers that two individuals should be added to the list of persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP for their role in undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine and for benefitting from Russian decision-makers responsible for the annexation of Crimea or the destabilisation of Eastern Ukraine.
- (4) Decision 2014/145/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision 2014/145/CFSP is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 21 April 2022.

For the Council
The President
J.-Y. LE DRIAN

⁽¹⁾ Council Decision 2014/145/CFSP of 17 March 2014 concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine (OJ L 78, 17.3.2014, p. 16).



ANNEX

The following persons are added to the list of persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP:

Persons

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
211.	Serhiy Vitaliyovich KURCHENKO (Ukrainian: Сергій Віталійович Курченко; Russian: Сергей Витальевич КУРЧЕНКО)	Gender: male DOB: 21.9.1985 POB: Kharkiv, Ukraine Nationality: Ukrainian	<p>Mr Serhiy Kurchenko is a Ukrainian businessman. With support from pro-Russia separatists, he took control of several large metallurgical, chemical and energy plants in the separatist-held areas of Donbas. His "Gaz-Alliance" company monopolised coal mining in Donbas after its competitors had been forced out of the market, reportedly with help from Russia. He organised and benefitted from the illegal scheme of exporting Donbas coal to Russia and Europe despite EU sanctions. Coal extracted in Mr Kurchenko's mines has been re-registered and illegally exported via Russian ports.</p> <p>Mr Kurchenko helped large Russian companies and State-owned holdings to bypass EU restrictive measures by acting as their sub-contractor in the Russian-held territories. He has been an intermediary in Russian gas, fuel and electricity exports to the separatist-held parts of Donbas, which strengthened their independent energy supplies and undermined their economic integration with Ukraine. Moreover, he delivered fuel to the illegally occupied Crimean Peninsula. By doing so, he strengthened the independent power supplies of this territory. He also owns the largest oil depot on the Crimean Peninsula.</p> <p>He thereby benefitted from Russian decision-makers responsible for the annexation of Crimea and the destabilisation of Eastern Ukraine, conducted transactions with the separatist groups in the Donbas region of Ukraine, and actively supported actions and policies which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.</p>	21.4.2022
234.	Yevgeniy Viktorovich PRIGOZHIN (Евгений Викторович ПРИГОЖИН)	DOB: 1.6.1961 POB: Leningrad, former USSR (now St Petersburg, Russian Federation) Function: prominent businessman, with close ties to Russian political leadership	<p>Yevgeniy Prigozhin is a prominent Russian businessman with close ties to President Putin and the Russian Ministry of Defence. He is the founder and unofficial head of the Wagner Group, a Russia-based unincorporated military entity, responsible for the deployment of Wagner Group mercenaries in Ukraine.</p> <p>Concord, also known as KOMBINAT PITANIYA KONKORD OOO, a company which Prigozhin founded and owned until November 2019, and a group of other companies with ties to him, including Concord Management and Consulting LLC and Megaline LLC, have been benefitting from large public contracts with the Russian Ministry of Defence following the illegal annexation of Crimea by Russia and occupation of Eastern Ukraine by Russia-backed separatists.</p>	21.4.2022



	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
		<p>Associated persons: Lyubov Valentinovna Prigozhina (spouse); Violetta Prigozhina (mother)</p> <p>Associated entities: Wagner Group; internet Research Agency; Concord company group; Concord Management and Consulting LLC; Megaline LLC</p> <p>Nationality: Russian</p> <p>Gender: male</p>	<p>He is thus responsible for and has actively implemented actions which have undermined and threatened the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine. He has also been benefiting from Russian decision-makers responsible for the annexation of Crimea and the destabilisation of Eastern Ukraine.</p>	



VENDIM
Nr. 345, datë 26.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË
MBLEDHJES DHE ADMINISTRIMIT TË
TË DHËNAVE TË HUMBJEVE NGA
FATKEQËSITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë ruhen dhe përpunohen të dhënat, si më poshtë vijon:

a) të dhëna për datën e ndodhjes së fatkeqësisë, shtrirjen territoriale të saj dhe çdo e dhënë tjetër mbi fatkeqësinë konkrete;

b) të dhëna për dëmet materiale dhe jomateriale, të shkaktuara nga fatkeqësia;

c) të dhëna për humbjet e shkaktuara nga fatkeqësia.

2. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e grumbulluara nga kjo bazë të dhënash, të cilat janë:

a) të dhëna mbi fatkeqësinë, të cilat do të përfshijnë informacion, për:

i. llojin e fatkeqësisë;

ii. datën e ndodhjes së fatkeqësisë;

iii. shtrirjen territoriale të fatkeqësisë;

b) të dhëna për dëmet e shkaktuara, të cilat do të përfshijnë informacion për:

i. listën e pronave publike dhe shtetërore të dëmtuara, si dhe shkallën e dëmeve të shkaktuara;

ii. listën e pronave private të dëmtuara, si dhe shkallën e dëmeve të shkaktuara;

iii. listën e dëmeve të shkaktuara në mjedis;

iv. listën e pasurive kulturore të dëmtuara, si dhe shkallën e dëmeve të shkaktuara;

v. numrin e personave të plagosur, të prekur nga sëmundje infektive dhe sëmundjet që lidhen me traumën e shkaktuar.

c) të dhëna mbi humbjet, të cilat do të përfshijnë informacion për:

i. numrin e humbjeve në jetë njerëzish;

ii. humbjet në gjënë e gjallë, duke përcaktuar llojin e gjësë së gjallë, sasinë dhe koston financiare për çdo lloj;

iii. koston financiare të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia;

iv. koston e shpenzimeve për marrjen e masave rehabilituese ndaj fatkeqësive në infrastrukturën e dëmtuar;

v. koston e shpenzimeve për marrjen e masave parandaluese ndaj fatkeqësive në infrastrukturën e dëmtuar.

3. Të dhëna dytësore, të cilat administrohen nga një tjetër bazë të dhënash shtetërore dhe reflektohen në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, përmes ndërveprimit, janë:

a) të dhënat identifikuese për personat e vdekur ose të dëmtuar si pasojë e ndodhjes së një fatkeqësie;

b) të dhënat identifikuese për pasuritë e paluajtshme.

4. Baza e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë shkëmben informacion e ndërvepron me baza shtetërore të të dhënave elektronike, si më poshtë vijon:

a) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, për të dhënat dytësore që lidhen me përbërësit e gjendjes civile të personave të vdekur.

b) Bazën Shtetërore të të Dhënave Kadastrale, për të dhënat dytësore që lidhen me përbërësit dhe elementet identifikuese të pasurive të paluajtshme.

5. Dhënës të informacionit në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë janë:

a) bashkitë për territorin e tyre;

b) ministritë e linjës dhe institucionet qendrore sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë;

c) institucionet e tjera publike dhe subjekte private, në bazë të kërkesës së AKMC-së.

6. AKMC-ja, kur vlerëson se institucionet e tjera publike zotërojnë informacion për një fatkeqësi dhe, për shkak të natyrës së veprimtarisë, institucioni nuk ka privilegjet e përdoruesit dhe ndërvepruesit në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, kërkon zyrtarisht prej tyre dhënien e informacionit. Kërkesa për informacion drejtuar institucionit publik i bëhet me dije edhe organit të tij epror.

7. AKMC-ja, kur vlerëson se një subjekt privat, i cili, për shkak të veprimtarisë, zotëron informacion për një fatkeqësi apo është cenuar nga një fatkeqësi, kërkon zyrtarisht prej tij dhënien e informacionit.

8. Në kërkesën për informacion drejtuar institucioneve të tjera publike dhe subjekteve private, AKMC-ja duhet të përcaktojë qartësisht



informacionin dhe të dhënat konkrete që kërkohen, formën dhe mënyrën e dhënies së informacionit.

9. Institucionet e tjera publike dhe subjektet private, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, duhet të japin informacionin e kërkuar nga ana e AKMC-së.

10. Në rastet kur për shkaqe objektive informacioni i kërkuar është i pamundur të jepet brenda afatit 15-ditor, institucionet e tjera publike dhe subjektet private i kërkojnë AKMC-së shtyrjen e afatit të dhënies së informacionit, duke shpjeguar arsyet. Afati për dhënien e informacionit mund të shtyhet deri në 15 ditë, pas përfundimit të afatit 15-ditor.

11. Detyrimet e institucioneve në lidhje me Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë janë:

a) AKMC-ja, si administrator i Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, në bashkëpunim me njësinë e dedikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ka këto detyra:

i. sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimit të Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë;

ii. arkivimin e sigurt të të dhënave dhe ruajtjen periodike të kopjeve të të dhënave në mjedis rezervë, të shkëputur dhe të pavarur nga sistemi kryesor;

iii. sigurimin e një alternative funksionale edhe në rastin kur sistemi kryesor nuk mund të përdoret për arsye objektive;

iv. analizimin e nevojave për ndryshime në bazën e të dhënave, me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e të gjitha elementeve përbërëse të saj;

v. Krijimin dhe administrimin për nivelet e aksesit në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë;

vi. Krijimin e përdoruesve me privilegjet përkatëse për të punuar në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë;

vii. Shpërndarjen e privilegjeve për përdoruesit dhe heqjen e së drejtës për të punuar në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, në rast të largimit të tyre nga funksioni;

viii. Mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimeve që kryhen në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, në përgjithësi;

ix. Ndryshimin apo anulimin në nivelin e aksesit të një përdoruesi pa njoftim, kur vëren se ai nuk

zbaton rregullat e përdorimit, dyshohet se po i shkakton dëm Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë në përgjithësi ose nuk përdor Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë për realizimin e detyrave, brenda një afati të përcaktuar nga AKMC-ja;

x. Hedhjen e të dhënave parësore të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, për institucionet e tjera publike dhe subjektet private, në përputhje me informacionin e marrë prej tyre, sipas përcaktimit të pikave 7 e 8, të këtij vendimi;

xi. Hartimin e udhëzimeve për funksionet e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë në ndihmë të përdoruesve të tij;

xii. Trajnimin e përdoruesve të Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë.

b) Ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, sipas fushës së përgjegjësisë, kanë detyrim hedhjen dhe përditësimin e të dhënave parësore në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

c) Bashkitë, brenda territorit të tyre administrativ, kanë detyrim hedhjen dhe përditësimin e të dhënave parësore në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

ç) Prefekti i qarkut ka detyrimin të sigurojë që bashkitë në juridiksionin e vet të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, për fatkeqësitë e ndodhura.

12. Nivelet e aksesit për subjektet e interesuara:

a) AKMC-ja, si administrator i sistemit, ka të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të dhënave në sistem;

b) Bashkitë kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi për të dhënat që lidhen me territorin e juridiksionit të tyre;

c) Prefekti i qarkut ka të drejtë leximi për të dhënat e administruara nga bashkitë në territorin e juridiksionit të tij;

ç) Ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi për të dhënat që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë.

13. Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë janë:

a) të ruajnë konfidencialitetin e privilegjeve të aksesit në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, si dhe të mbajnë përgjegjësi personale të drejtpërdrejtë, në rast të shkeljes së rregullave, të



pakujdesisë apo të keqpërdorimit të nivelit të tyre të aksesit;

b) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave personale të personave të dëmtuar, si pasojë e një fatkeqësie, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;

c) të përdorin Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë vetëm për realizimin e detyrave të tyre;

ç) të përditësojnë të dhënat sipas fushës së përgjegjësisë.

14. Ministrinë e linjës, institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet që kanë për Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, nëpërmjet të paktën një përdoruesi me privilegjet përkatëse.

15. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të sistemit “Baza e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë”, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Efektet financiare të këtij vendimi do të mbulohen nga fondi i dedikuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

17. Ngarkohen bashkitë për territorin e tyre administrativ - territorial, prefekti i qarkut për bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku, ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, institucionet e tjera publike dhe subjekte private, në bazë të kërkesës së AKMC-së dhe në veçanti AKMC-ja, si administrator i Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Njësia e dedikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 346, datë 26.5.2022

PËR SIGURIMIN E JETËS SË PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË DËRGOHET NË MISIONE USHTARAKE DHE STËRVITJE JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes siguron jetën e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohet në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, për vitet 2022 dhe 2023.

2. Sigurimi i jetës së personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohet në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, për vitet 2022 dhe 2023, bëhet sipas kontratës që lidhet me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon ngjarjet në rastet e:

a) humbjes së jetës për shkak të detyrës apo si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të saj;

b) zhdukjes;

c) paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së misionit ushtarak dhe/ose stërvitjes jashtë vendit;

ç) paaftësisë së përkohshme, të plotë ose të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së misionit ushtarak dhe/ose stërvitjes jashtë vendit;

d) shërbimeve mjekësore në spitalet publike ose private brenda dhe/apo jashtë shtetit, kur mbulimet shëndetësore nuk ofrohen në spitalet publike.



3. Shuma e përcaktuar në kontratën e sigurimit, për çdo person të siguruar, nuk mund të jetë më e ulët se:

a) 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për rastet e humbjes së jetës për shkak të detyrës a zhdokjes së personit;

b) 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për rastet e dëmtimit të rëndë fizik;

c) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për rastet e dëmtimit të lehtë fizik;

ç) 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për rastet e humbjes së jetës, si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të detyrës.

4. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficientëve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, për secilin vit.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 347, datë 26.5.2022

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Zenel Kuçana, prefekt i qarkut të Kukësit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Ali Hallaçi emërohet prefekt i qarkut të Kukësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 348, datë 26.5.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE DHE TEKNIKAVE TË ÇAKTIVIZIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT DHE PJESËVE KRYESORE TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 18/1, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE DHE TEKNIKAVE TË ÇAKTIVIZIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT DHE PJESËVE KRYESORE TË TYRE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i standardeve dhe i teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë, që do të mundësonte riaktivizimin e tyre.



Neni 2 Objekti

Rregullorja “Për përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre” përcakton:

1. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.
2. Kategoritë e armëve të zjarrit dhe e pjesëve kryesore, tek të cilat aplikohen standardet dhe teknikat e përcaktuara në këtë Rregullore.
3. Personat fizikë dhe juridikë të autorizuar për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre.
4. Autoritetin dhe procedurat e verifikimit e certifikimit të armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre, të çaktivizuara.
5. Standardet e markimit dhe të administrimit të dokumentacionit të armëve të zjarrit, pjesëve dhe mekanizmave kryesore të tyre, të çaktivizuara.
6. Transferrat ndërkombëtare dhe kontrolli i armëve të zjarrit, pjesëve dhe mekanizmave kryesore të tyre, të çaktivizuara.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj Rregulloreje janë:

1. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, janë pajisur me armë zjarri dhe të licencuar për veprimtari të lejuara me armët, përfshi koleksionistët e armëve të zjarrit dhe muzetë.
2. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, janë pajisur me licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.
3. Policia e Shtetit.

Neni 5 Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore do të zbatohet për armët e zjarrit në pronësi të personave fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar, janë pajisur me armë zjarri dhe të licencuar për veprimtari të lejuara me armët.

2. Kjo Rregullore do të zbatohet për personat fizikë dhe juridikë të autorizuar për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.

3. Kjo Rregullore do të zbatohet për autoritetin e ngarkuar për verifikimin dhe certifikimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, të çaktivizuara.

4. Kjo Rregullore nuk do të zbatohet për armët e zjarrit të çaktivizuara para datës së zbatimit të saj, përveç nëse ato armë zjarri transferohen në një shtet tjetër ose vendosen në treg, si dhe për armët e zjarrit të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore (armë zjarri antike).

KREU II STANDARDET DHE TEKNIKAT E ÇAKTIVIZIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT DHE PJESËVE KRYESORE TË TYRE

Neni 6 Kategoritë e armëve

Standardet dhe teknikat e çaktivizimit, sipas kësaj Rregulloreje zbatohen për armët e kategorive “A”, “B” dhe “C”, si më poshtë:

1. Armë zjarri automatike (A2), (A3), (A6), (A7).
2. Armë zjarri të gjata që shkrepin më shumë se 11 fishekë pa rimbushje, nëse:
 - a) krehri me kapacitet mbi 10 fishekë është pjesë e kësaj arme (A16);
 - b) krehri i çmontueshëm me kapacitet mbi 10 fishekë futet në këtë armë (A17).
3. Armë zjarri të shkurtra me përsëritje (B1).
4. Armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje qendrore (B2).
5. Armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme nën 28 cm (B3).
6. Armë zjarri të gjata gjysmautomatike me krehër dhe fole, që mund të mbajnë së bashku më shumë se 3 fishekë, në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më shumë se tre, por më pak se dymbëdhjetë fishekë, në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore (B4).
7. Armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmautomatike me tytë të pavjaskuar, me gjatësi deri në 60 cm (B7).
8. Armë zjarri gjysmautomatike për përdorim civil, të cilat u ngjajnë armëve me mekanizma automatikë (B9).



9. Armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmautomatike me tytë të pavjaskuar (C1).

10. Armë zjarri të gjata me tytë të vjaskuar (C2).

11. Armë zjarri e gjatë gjysmautomatike, që nuk përfshihet në kategorinë “A” ose “B” (C3).

12. Armë zjarri të shkurtra me një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme, jo më pak se 28 cm (C4).

13. Armë zjarri të gjata me një qitje me tytë të pavjaskuar (C7).

14. Pjesët kryesore të armëve të zjarrit.

Neni 7

Subjektet e licencuara

1. Çaktivizimi i armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre kryhet nga njësi publike ose private, ose nga individë të licencuar nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.

2. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të plotësojnë kushtet dhe rregullat e përcaktuara sipas nenit 19, të ligjit 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar dhe rregullores “Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve”, të miratuar me vendimin nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të kenë ambiente të sigurta për ruajtje të përshtatshme të armëve, deri në momentin e çaktivizimit.

4. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të kenë pajisjet dhe mjetet e duhura për kryerjen e operacioneve specifike të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, të miratuara në këtë Rregullore.

5. Subjektet e licencuara për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre duhet të jenë të kompletuara me personel të kualifikuar, të cilët duhet të njohin kategoritë e ndryshme të armëve të zjarrit dhe proceset ekzakte, që do të zbatohen te komponentët esencialë dhe pjesët kryesore, në rastet kur është e mundur, me qëllim çaktivizimin e përhershëm të armëve të zjarrit.

Neni 8

Standardet dhe teknikat e çaktivizimit

1. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre, për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve, të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë, që do të mundësonte riaktivizimin e tyre, janë në përputhje me aneksin I, bashkëlidhur.

2. Procesit të çaktivizimit u nënshtrohen armët në pronësi të shtetasve, personave fizikë ose juridikë, me kërkesën e tyre për t’i mbajtur në pronësi si relike.

3. Kërkesa për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre paraqitet pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.

4. Shpenzimet për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre mbulohen nga kërkuesi.

5. Masa, kriteret dhe procedura për tarifat financiare përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Neni 9

Kontrolli dhe certifikimi i çaktivizimit të armëve të zjarrit

1. Për kontrollin e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, për të garantuar që modifikimet e kryera në armët e zjarrit i bëjnë të gjitha pjesët kryesore të tyre përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar. Ky komision lëshon certifikatat e çaktivizimit për armët e zjarrit, të cilat janë çaktivizuar dhe markuar.

2. Kur subjekti verifikues është, gjithashtu, i autorizuar të çaktivizojë armët e zjarrit, atëherë sigurohet një ndarje e qartë e detyrave dhe e personave që i kryejnë ato brenda subjektit.

3. Kur çaktivizimi i armës së zjarrit është kryer në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në aneksin e I, Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta i lëshon pronarit të armës së



zjarrit një certifikatë çaktivizimi, në përputhje me formatin e përcaktuar në aneksin III.

4. Autoriteti i licencimit dhe Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta mund të kryejnë inspektime monitoruese, duke përfshirë këtu edhe kontrollime të palajmëruara, që të sigurojnë se të gjitha standardet janë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje. Mospajtimi i specifikimeve teknike me kërkesat ligjore për çaktivizimin ose ruajtjen e sigurt të armëve, në raste kur puna akoma nuk ka filluar, apo është e papërfunduar, përbën shkak për shfuqizimin e licencës dhe në disa raste, procedimin penal.

Neni 10

Markimi i armëve të zjarrit të çaktivizuara

1. Armët e zjarrit të çaktivizuara markohen në përputhje me formatin standard të përcaktuar në aneksin II, për të treguar që ato janë çaktivizuar, në përputhje me standardet dhe teknikat e përcaktuara në aneksin I.

2. Markimi vendoset nga Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta për të gjithë përbërësit e modifikuar për çaktivizimin e armës së zjarrit dhe duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- është qartësisht i dukshëm dhe i palëvizshëm;
- ka informacion për shtetin ku është kryer çaktivizimi dhe entitetin verifikues që ka certifikuar çaktivizimin;
- ruhet numri serial origjinal i armës së zjarrit.

Neni 11

E drejta e mbajtjes së armëve të zjarrit të çaktivizuara

1. Armët e zjarrit të çaktivizuara, në përputhje me standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, të përcaktuara në këtë Rregullore, lejohen të mbahen nga pronarët e tyre, përfshi këtu koleksionistët dhe muzetë, pa nevojën e autorizimit/lejes ose një dokumenti të ngjashëm.

2. Pronari i armës së zjarri të çaktivizuar duhet të mbajë certifikatën e çaktivizimit në çdo kohë.

3. Nëse arma e zjarrit e çaktivizuar vendoset në treg, ajo shoqërohet me certifikatën e çaktivizimit.

4. Armët e zjarrit të çaktivizuara, jo në përputhje me standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve

të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre të përcaktuara në këtë Rregullore, sekuestrohen.

5. Prezantimi i rremë i armës së zjarrit të çaktivizuar, falsifikimi i certifikatës së çaktivizimit, tentimi për riaktivizim apo riaktivizimi i armës së çaktivizuar përbëjnë shkelje dhe ndëshkohen penalisht.

Neni 12

Transferimi ndërkombëtar i armëve të zjarrit të çaktivizuara

1. Armët e zjarrit të çaktivizuara mund të transferohen në një shtet tjetër vetëm, atëherë kur ato të kenë markimin unik dhe të shoqërohen nga një certifikatë çaktivizimi, në përputhje me këtë Rregullore, sipas autorizimit/licencës përkatëse nga organi përgjegjës.

2. Republika e Shqipërisë do të njohë certifikatat e çaktivizimit të lëshuara nga çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian, nëse certifikata përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.

3. Kontrolli fizik dhe verifikimi i certifikatës së çaktivizimit në pikat e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë kryhet nga shërbimi doganor dhe Policia e Shtetit.

4. Në rastet kur në pikat e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë konstatohet se arma/armët dhe pjesët kryesore të tyre nuk janë pajisur me certifikatën e çaktivizimit, armët sekuestrohen.

Neni 13

Evidentimi i armëve të zjarrit të çaktivizuara

1. Policia e Shtetit mban evidencë për certifikatat e lëshuara për armët e zjarrit të çaktivizuara. Evidenca mbahet për një periudhë prej të paktën 20 vjetësh nga data e çaktivizimit të armës së zjarrit.

2. Evidenca e armëve e zjarrit të çaktivizuara është element i regjistrit kombëtar elektronik të armëve të zjarrit, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë.

3. Evidenca e armëve të zjarrit të çaktivizuara duhet të përmbajë të dhëna për pronarin e armës në momentin e çaktivizimit, të dhëna për armën e çaktivizuar dhe të dhëna për certifikatën e çaktivizimit.



4. Evidenca e armëve e zjarrit të çaktivizuara është në përputhje me formatin e përcaktuar në aneksin e IV.

KREU III DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 14 Dispozitat e fundit

Kjo Rregullore është e detyrueshme të zbatohet nga:

1. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, janë pajisur me armë zjarri dhe të licencuar për veprimtari të lejuara me armët, përfshi koleksionistët e armëve të zjarrit dhe muzetë.

2. Personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, janë pajisur me licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të kërkojë e të mbikëqyrë zbatimin e rregullave, procedurave, standardeve, të përcaktuara në këtë Rregullore.

ANEKSI I SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR ÇAKTIVIZIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT

Operacionet e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre do të kryhen në mënyrë që të garantojnë, që të gjitha pjesët kryesore

të këtyre armëve, të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë, që do të mundësonte riaktivizimin e tyre.

Operacionet e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre përcaktohen në bazë të tri tabelave:

- Tabela I rendit llojet e ndryshme të armëve të zjarrit;

- Tabela II përcakton parimet e përgjithshme, që duhen ndjekur për çaktivizimin e armëve të zjarrit;

- Tabela III përshkruan operacionet specifike, që duhen kryer për çaktivizimin e armëve të zjarrit.

Specifikimet teknike për çaktivizimin e armëve të zjarrit duhet të parandalojnë riaktivizimin e armëve të zjarrit me përdorimin e mjeteve të zakonshme.

Specifikimet teknike për çaktivizimin e armëve të zjarrit duhet të fokusohen në çaktivizimin e pjesëve kryesore të armës, përfshi edhe ato që janë në rezervë për çdo armë.

Specifikimet teknike për çaktivizim e armëve të zjarrit duhet të rishqyrtohen periodikisht, që të përfshijnë zhvillimet teknologjike të armëve dhe operacioneve të çaktivizimit.

Miratimi i standardeve të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare të BE, do ta ulte rrezikun për të gjithë. Zhvillimi i specifikimeve teknike për çaktivizim duhet të jenë të bazuara te vlerësimi i rrezikut dhe nivelit të kërcënimit, bashkë me vlerësimin e nivelit të zhvillimit të teknikave dhe kapaciteteve të inxhinierisë, të cilat duhet të tejkalohen, që të sigurohet çaktivizimi i përhershëm.

Tabela I. Lista e llojeve të armëve të zjarrit

Nr.	LLOJET E ARMËVE TË ZJARRIT
1	Armë zjarri të shkurtra (pistoletat me një shkrepje të vetme, gjysmautomatike)
2	Armë zjarri të shkurtra (revolverët, duke përfshirë ato me mulli/cilindër)
3	Armë zjarri të gjata me një shkrepje të vetme
4	Armë zjarri të gjata e të shkurtra me veprim me ndërprerje (me ose pa vjaska, me mekanizëm të mbylljes së fishekut me ulje poshtë ose me rrotullim)
5	Armë zjarri të gjata me përsëritje (me ose pa vjaska)
6	Armë zjarri të gjata gjysmautomatike (me ose pa vjaska)
7	Armë zjarri automatike (automatik të ndryshëm, mitraloza, pistoleta automatike)
8	Armë zjarri që mbushen nga gryka



Tabela II. Parimet e përgjithshme për çaktivizimin e armëve të zjarrit

Nr.	PARIME TË PËRGJITHSHME
1	Njësia çaktivizuese duhet të parandalojë çmontimin e përbërësve thelbësorë të armëve të zjarrit, duke salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
2	Procesi i çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre do të kryhet pas kontrollit të ushtruar nga Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta.
3	Njësia çaktivizuese duhet të sigurojë që materialet, që do të përdoren për ngjitje/fiksime të pjesëve dhe mekanizmave të armëve të zjarrit që çaktivizohen (perçinat/kunjat/bulonat), duhet të jenë të paktën 40 HRC, ndërsa materiali që përdoret për saldim duhet të sigurojë një ngjitje të qëndrueshme.

Tabela III. Operacionet specifike për çaktivizimin e armëve të zjarrit

1. Armë zjarri të shkurtra (pistoletat me një shkrepje të vetme, gjysmautomatike)	
1.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë, duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut).
1.2	Tyta: Për të gjitha pistoletat, përveç atyre me një qitje të vetme, duhet të shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut, përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.
1.3	Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
1.4	Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 1.2 mund të përdoret për këtë qëllim.
1.5	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 1.1–1.4 dhe 1.19. Tytat duhet të parandalohen që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
1.6	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.
1.7	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet me makinë metalprerëse faqja e përparme, në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
1.8	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.
1.9	Rrëshqitësi/djepi: Pritet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë, në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen.
1.10	Rrëshqitësi/djepi: Hiqet susta e gjilpërës.
1.11	Rrëshqitësi/djepi: Hiqen kanalet e mbylljes me rrëshqitje.
1.12	Rrëshqitësi/djepi: Kur është e zbatueshme pritset me makinë metalprerëse pjesa e brendshme fundore, në një kënd 45 deri 75 gradë.
1.13	Rrëshqitësi/djepi: Kur bllokuesi është i heqshëm nga trupi i rrëshqitësit/djepit, bllokuesi duhet të fiksohet përgjithmonë me trupin e rrëshqitësit/djepit.
1.14	Trupi dhe doreza: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
1.15	Trupi dhe doreza: Pritet me makinë metalprerëse, të paktën 2/3 e pjesës fundore të shinave rrëshqitëse në të dy anët.
1.16	Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin, nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjites që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
1.17	Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
1.18	Sistemi automatik: Shkatërrohet pistoni i gazit, tubi i gazit dhe rruga e gazit duke i prerë ose salduar.
1.19	Sistemi automatik: Nëse nuk ka piston gazi, hiqet tubi i gazit. Nëse tyta përdoret si piston gazi, ajo saldohet me trupin e armës. Në të gjitha rastet kur është e pranishme, mbyllet rruga e daljes së gazit nga tyta me saldim.
1.20	Magazina/krehri: Saldohet magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose, në varësi të llojit të armës dhe materialit, përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.
1.21	Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.
1.22	Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmezbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje, ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmezbutësi është pjesë e armës.



1.23	Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohet vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.
2. Armë zjarri të shkurtra (revolverët, duke përfshirë ato me mulli cilindër)	
2.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore (gjerësia: $1/2 >$ kalibër; gjatësia: minimumi i gjatësisë së tytës nga pjesa fundore).
2.2	Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri $>$ 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali (gjatësia: minimumi gjysma e gjatësisë së folesë së fishekut) në tytë dhe të ngjitet në mënyrë solide.
2.3	Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 2.2 mund të përdoret për këtë qëllim.
2.4	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 2.1–2.3. Tytat duhet të parandalohen që të mos vendosen në një armë zjarri, duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
2.5	Cilindri/mulliri: Hiqen me makinë metalprerëse të gjitha muret e brendshme nga cilindri për një minimum prej $2/3$ të gjatësisë së tij. Hiqen sa më shumë të jetë e mundur e mureve të brendshme të cilindrit/mullirit, sa më afër diametrit, pa prishur muret e jashtme.
2.6	Cilindri/mulliri: Kur është e mundur saldohet cilindri me kornizën ose përdoren masat e duhura, si vendosja e kunjit, me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë për të parandaluar heqjen.
2.7	Cilindri/mulliri: Për cilindrata rezervë, që nuk janë montuar në armë zjarri, zbatohet operacioni 2.5. Përveç kësaj, cilindri duhet të parandalohet që të vendoset përgjithmonë në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
2.8	Trupi dhe doreza: Zgjerohet vrima e gjilpërës tre herë në raport me origjinalin.
2.9	Trupi dhe doreza: Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.
2.10	Mekanizmi i shkrepijes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit, midis këmbëzës së shkrepijes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepijes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjitës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
2.11	Mekanizmi i shkrepijes: Saldohet në trupin e armës kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
2.12	Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.
2.13	Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme, ku është e mundur dhe pikat e lidhjes, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohet vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.
3. Armë zjarri të gjata me një shkrepije të vetme (me veprim pa ndërprerje)	
3.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë, duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: $>$ $1/2$ kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut).
3.2	Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut, përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri $>$ 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.
3.3	Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
3.4	Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 3.2 mund të përdoret për këtë qëllim.
3.5	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 3.1–3.4. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme, që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
3.6	Blllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.
3.7	Blllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e blllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
3.8	Blllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.



3.9	Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin, nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjites që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
3.10	Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjites rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
3.11	Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmezbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmezbutësi është pjesë e armës.
3.12	Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohet vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë së gazeve.
4. Armë zjarri të gjata e të shkurtra me veprim me ndërprerje (me ose pa vjaska, me mekanizëm të mbylljes së fishekut me ulje poshtë ose me rrotullim)	
4.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut). Për armët e zjarrit pa dhomë të përfshirë në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia > 1/2 kalibër; gjatësia: minimumi 1/2 gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).
4.2	Tyta: Një prizë e shtrënguar e të paktën 2/3 e gjatësisë së dhomës duhet të ngjitet mirë në dhomë dhe duhet të vendoset sa më afër këllëfit.
4.3	Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
4.4	Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
4.5	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 4.1–4.4. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
4.6	Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjites, që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
4.7	Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjites rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
4.8	Sistemi automatik: Përpunoni një kon prej minimumi 60 gradë (këndi i majës), në mënyrë që të merrni një diametër bazë të barabartë me të paktën 10 mm ose diametrin e faqes së këllëfit.
4.9	Sistemi automatik: Hiqni kunjin e shkrepjes, zmadhoni vrimën e kunjit të shkrepjes në një diametër minimal prej 5 mm dhe bashkoni vrimën e kunjit të shkrepjes.
4.10	Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmezbutësit nga tyta duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmezbutësi është pjesë e armës.
4.11	Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohet vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.
5. Armë zjarri të gjata me përsëritje (me rimbushje, me ose pa vjaska)	
5.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut). Për armët e zjarrit pa dhomë të përfshirë në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia > 1/2 kalibër; gjatësia: minimumi 1/2 gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).
5.2	Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.
5.3	Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
5.4	Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 5.2 mund të përdoret për këtë qëllim.
5.5	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 5.1–5.4. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke



	përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
5.6	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.
5.7	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
5.8	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.
5.9	Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjitës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
5.10	Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
5.11	Magazina/krehri: Saldohet magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.
5.12	Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.
5.13	Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri është në formë tubi, kalohet një ose disa shufra, që lidhin në mënyrë të përhershme dhomën me kornizën dhe sigurohen me saldim.
5.14	Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmezbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmezbutësi është pjesë e armës.
5.15	Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë së gazeve.
6. Armë zjarri të gjata gjysmautomatike (me ose pa vjaska)	
6.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë, duke përfshirë folenë e fishekut, kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut). Për armët e zjarrit pa dhomë të përfshirë në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia > 1/2 kalibër; gjatësia: minimumi 1/2 gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).
6.2	Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.
6.3	Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
6.4	Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 6.2 mund të përdoret për këtë qëllim.
6.5	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 6.1–6.4 dhe 6.12. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri, duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
6.6	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.
6.7	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet me makinë metalprerëse ose hiqet faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
6.8	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.
6.9	Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjitës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
6.10	Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
6.11	Sistemi automatik: Shkatërrohet pistoni i gazit, tubi i gazit dhe rruga e gazit, duke i prerë ose salduar.
6.12	Sistemi automatik: Nëse nuk ka piston gazi, hiqet tubi i gazit. Nëse tyta përdoret si piston gazi, saldohet tyta e çaktivizuar me trupin e armës. Në të gjitha rastet kur është e pranishme, mbyllet rruga e daljes së gazit nga tyta me saldim.
6.13	Sistemi automatik: Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme e pistonit të gazit në një kënd 45 deri në 75 gradë në raport me origjinalin. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen e pistonit në mënyrë që të reduktohet në minimumin prej 50% të masës origjinale. Fiksohet pistoni në mënyrë të përhershme me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.



6.14	Sistemi automatik: Në rastet kur pistoni i gazeve/bllokuesi i gazeve është i vendosur brenda gypit të gazeve, gypi duhet të zvogëlohet në një minimum 50%. Fiksohet pistoni në mënyrë të përhershme të mbajtësi dhe mbajtësi duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme tek arma e zjarrit, me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
6.15	Magazina/krehri: Saldohet magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.
6.16	Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.
6.17	Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri është në formë tubi, kalohet një ose disa shufra që lidhin në mënyrë të përhershme dhomën me kornizën dhe sigurohen me saldim.
6.18	Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmezbutësit nga tyta, duke përdorur kunj çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmezbutësi është pjesë e armës.
6.19	Zhurmezbutësi: Hiqet të gjitha pjesët e brendshme ku është e mundur dhe pikat e lidhjes së tyre në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohet vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.
7. Armë zjarri automatike (automatik të ndryshëm, mitraloza, pistoletat automatike)	
7.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibër; gjatësia: për tytat e me vjaska sa trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut, për tytat pa vjaska dy herë më të gjatë se foleja e fishekut).
7.2	Tyta: Shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Përndryshe, foleja e fishekut mund të mbushet me një copë metali në madhësinë e fishekut dhe të ngjitet në mënyrë solide.
7.3	Tyta: Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
7.4	Tyta: Duhet të bëhet përgjithmonë e sigurt, duke përdorur saldimin, duke u bashkuar me pjesën kryesore të armës ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë. Kunji i përdorur në operacionin 7.2 mund të përdoret për këtë qëllim.
7.5	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 7.1–7.3. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
7.6	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Hiqet ose shkurtohet gjilpëra.
7.7	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë faqen e bllokuesit. Të gjithë kapakët e mbylljes duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
7.8	Bllokuesi i folesë së fishekut (pjesët e lëvizshme/shuli): Saldohet vrima e daljes së gjilpërës.
7.9	Rrëshqitësi/djepi: Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme në një kënd 45 deri 75 gradë në raport me këndin e faqes origjinale. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen.
7.10	Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Hiqet susta e gjilpërës.
7.11	Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Hiqen kanalet e mbylljes me rrëshqitje.
7.12	Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Kur është e zbatueshme pritit me makinë metalprerëse pjesa e brendshme e skajit të portës së nxjerrjes në një kënd 45 deri 75 gradë.
7.13	Rrëshqitësi/djepi (për pistoletat automatike): Kur bllokuesi është i heqshëm nga trupi i rrëshqitësit/djepit, bllokuesi i çaktivizuar duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme me trupin e rrëshqitësit/djepit.
7.14	Trupi dhe doreza (për pistoletat automatike): Hiqet devijuesi i furnizimit me fishekë aty ku është i pranishëm.
7.15	Trupi dhe doreza (për pistoletat automatike): Pritet me makinë metalprerëse të paktën 2/3 e pjesës fundore të shinave rrëshqitëse në të dy anët.
7.16	Mekanizmi i shkrepijes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit midis këmbëzës së shkrepijes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepijes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjitës që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
7.17	Mekanizmi i shkrepijes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
7.18	Sistemi automatik: Shkatërrohet pistoni i gazit, tubi i gazit dhe rruga e gazit, duke i prerë ose salduar.
7.19	Sistemi automatik: Nëse nuk ka piston gazi, hiqet tubi i gazit. Nëse tyta përdoret si piston gazi, tyta e çaktivizuar saldohet ose ngjitet me trupin e armës. Në të gjitha rastet kur është e pranishme, mbyllet rruga e daljes së gazit nga tyta me saldim.



7.20	Sistemi automatik: Pritet ose hiqet me makinë metalprerëse faqja e përparme e pistonit të gazit/bllokuesit të folesë në një kënd 45 deri në 75 gradë në raport me originalin. Materiali duhet të hiqet në të gjithë sipërfaqen e pistonit, në mënyrë që të reduktohet në minimumin prej 50% të masës origjinale. Fiksohet pistoni me armën e zjarrit, në mënyrë të përhershme me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
7.21	Sistemi automatik: Në rastet kur pistoni i gazeve/bllokuesi i gazeve është i vendosur brenda gypit të gazeve, gypi duhet të zvogëlohet në një minimum 50%. Fiksohet pistoni në mënyrë të përhershme të mbajtësi dhe mbajtësi, duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme tek arma e zjarrit, me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
7.22	Magazina/krehri: Saldohet magazina/krehri me pika saldimi me dorezën e armës ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, për të parandaluar heqjen e magazinës nga arma.
7.23	Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri mungon, vendosen pika saldimi ose përdoren masat e duhura për të siguruar shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë ose fiksohet një kyç, për të parandaluar futjen e magazinës në armë.
7.24	Magazina/krehri: Nëse magazina/krehri është në formë tubi, kalohet një ose disa shufra që lidhin në mënyrë të përhershme dhomën me kornizën dhe sigurohen me saldim.
7.25	Zhurmezbutësi: Parandalohet në mënyrë të përhershme heqja e zhurmëzbutësit nga tyta, duke përdorur shufër çeliku të ngurtësuar ose me saldim, ngjitje ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë, nëse zhurmëzbutësi është pjesë e armës.
7.26	Zhurmezbutësi: Hiqen të gjitha pjesët e brendshme dhe pikat e lidhjes ku është e mundur, në mënyrë që të mbetet vetëm një tub. Shpohen vrima me një diametër më të madh se kalibri i armës së zjarrit dhe në një interval gjatësor prej 3 cm (armë të shkurtra zjarri) ose 5 cm (armë të gjata zjarri) përmes këllëfit dhe depërtimit në dhomën e zgjerimit. Ose përndryshe, bëhet një prerje gjatësore prej minimumi 6 mm në pjesën fundore drejt dhomës shtesë të gazeve.
8. Armë zjarri që mbushen nga gryka, me një shkrepje (përfshijë ato me mbushje me cilindër)	
8.1	Tyta: Kryhet një prerje gjatësore nëpër tytë duke përfshirë folenë e fishekut kur është e pranishme (gjerësia: > 1/2 kalibr; gjatësia: trefishi i gjatësisë së folesë së fishekut. Për armët e zjarrit pa dhomë djegie në tytë, prisni një vrimë gjatësore (gjerësia > 1/2 e kalibr; gjatësia: minimumi 1/2 gjatësisë së tytës nga koni i shtytjes).
8.2	Tyta: Për armët e zjarrit me dhomën e djegies të përfshirë në tytë shpohet një vrimë nëpër folenë e fishekut përmes të dy mureve dhe përmes së cilës duhet të futet një kunj çeliku i temperuar dhe i salduar në mënyrë të sigurt (diametri > 50% e folesë së fishekut, min 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të siguruar tytën të mos lëvizë. Për armët e zjarrit pa dhomën e djegies të përfshirë në tytë, duhet të futet në tytë në mënyrë të sigurt një kunj çeliku i temperuar (gjatësia: minimum dyfishi i kalibr), në tytë nga koni i detyruar.
8.3	Tyta: Për tytat rezervë (që nuk janë të montuara në armë), zbatohen operacionet specifike 8.1–8.2. Tytat duhet të parandalohen në mënyrë të përhershme që të mos vendosen në një armë zjarri, duke prerë, salduar, bashkuar ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
8.4	Në rastin e veprimit me ndërprerje: Pritet me makinë metalprerëse një kon minimumi 60 gradë, në mënyrë që të rritet kalibri me të paktën 10 mm e faqes së përparme.
8.5	Në rastin e veprimit me ndërprerje: Hiqet gjilpëra, zmadhohet vrima e daljes së gjilpërës minimumi 5 mm dhe saldohet vrima e daljes së gjilpërës.
8.6	Mekanizmi i shkrepjes: Duhet të sigurohet shkatërrimi i lidhjes fizike të funksionimit, midis këmbëzës së shkrepjes dhe rrahësit. Bashkohet/saldohet këmbëza e shkrepjes me trupin nëse është e zbatueshme. Nëse bashkimi i tillë i këmbëzës nuk është i mundur, hiqet këmbëza dhe hapësira mbushet me saldim ose material tjetër ngjites që siguron shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
8.7	Mekanizmi i shkrepjes: Saldohet në trupin e armës, kur ky i fundit është metalik ose ngjitet me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta, kur trupi është prej metali të butë ose materiali polimer.
8.8	Vrimat. Hiqen ose saldohen.
8.9	Dhomat e ndara (të shumëfishta) të djegies (përveç cilindrit): Për armët e zjarrit me dhoma të ndara ose me shumë djegie, hiqen muret e brendshme nga dhoma/t e djegies për një minimum prej 2/3 të gjatësisë së saj me anë të metalprerjes. Hiqen sa më shumë të jetë e mundur muret e brendshme, në mënyrë ideale të barabartë me diametrin e kalibr.



ANEKSI II
STANDARDI I MARKIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT TË ÇAKTIVIZUARA

Të gjitha armët e çaktivizuara, në përputhje me standardet dhe teknikat e përshkruara në këtë Rregullore, duhet të markohen, sipas këtij standardi:

AA (1) bb (2) cc (3)

1. Shteti ku kryhet çaktivizimi i armëve dhe pjesëve kryesore të tyre – kodi zyrtar ndërkombëtar.

2. Simbol i strukturës/organizmit që kryen certifikimin e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.

3. Viti i çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre.

Markimi i plotë do të vendoset vetëm në kornizën e armës së zjarrit (trupi/kutia e tytës), ndërsa shenja e çaktivizimit 2 dhe shteti i çaktivizimit 3 do të vendosen në të gjitha pjesët kryesore të tyre.

ANEKSI III
CERTIFIKATË MODEL PËR ARMËT E ZJARRIT TË ÇAKTIVIZUARA
(Kjo certifikatë duhet të përgatitet në letër kundër falsifikimit)

Logo kombëtare		Emri i strukturës që verifikon dhe certifikon pajtueshmërinë e çaktivizimit. Logo
CERTIFIKATA E ÇAKTIVIZIMIT		
Numri i certifikatës:		
Masat e çaktivizimit janë në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike për çaktivizimin e armëve të zjarrit, siç përcaktohet në aneksin e I, të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/337, të 5 marsit 2018.		
Emri i subjektit që ka kryer çaktivizimin:		
Shteti:		
Data dhe viti i certifikatës së çaktivizimit:		
Prodhuesi i armës së zjarrit të çaktivizuar:		
Tipi i armës së zjarrit:		
Marka/modeli:		
Kalibri:		
Numri serial:		
Shënime:		
Shenja zyrtare e Republikës së Shqipërisë për çaktivizimin		Emri, titulli dhe nënshkrimi i personit përgjegjës
<p>SHËNIM. Kjo certifikatë përfaqëson një dokument të rëndësishëm. Kjo certifikatë duhet të mbahet në çdo kohë nga pronari i armës së çaktivizuar. Pjesët kryesore të çaktivizuara të cilave u referohet kjo certifikatë, janë të markuara me shenjat zyrtare të inspektimit, këto shenja nuk duhet të preken apo të hiqen.</p>		
<p>KUJDES! Falsifikimi i certifikatës së çaktivizimit konsiderohet vepër penale.</p>		



VENDIM
Nr. 349, datë 26.5.2022

**PËR MIRATIMIN E GARANCISË
 SHTETËRORE TË HUAS ME BANKAT
 TREGTARE PËR GARANTIMIN E
 HUAMARRJES SË SUBJEKTEVE, QË
 TREGTOJNË ME SHUMICË
 PRODUKTE USHQIMORE BAZË PËR
 TË MUNDËSUAR FINANCIMIN E
 NEVOJSHËM PËR MBAJTJEN E
 REZERVAVE, ME QËLLIM
 PËRBALLIMIN E SITUATËS SË
 VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG, SI
 DHE PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE
 DHE KRITEREVE TË MARRËVESHJES
 SË GARANCISË DHE MARRËVESHJES
 SË MIRËKUPTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 8, të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e linjës së garancisë shtetërore në vlerën 3 000 000 000 (tre miliardë) lekë, në favor të bankave tregtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat do të jenë pjesë e skemës së garancisë, që do të mundësojë huadhënien për subjektet, që tregtojnë me shumicë, produkte ushqimore bazë, për të siguruar financimin e nevojshëm për të mbajtur rezerva për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë, të krijuar në treg.

2. Linja e garancisë shtetërore do të lëshohet në favor të bankave tregtare, si më poshtë vijon:

- Banka Kombëtare Tregtare sh.a.;
- Banka *Credins* sh.a.;
- Banka *Raiffeisen* sh.a., *Albania*;
- Banka *OTP Albania* sh.a.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë mundëson përcaktimin e shumave të garancisë shtetërore, që lëshohet në favor të secilës bankë tregtare, nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta të garancisë, që do të lidhen me secilën prej bankave.

3. Marrëveshjet e garancisë janë sipas kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ministri i Financave dhe Ekonomisë mundëson, nëse rezulton e nevojshme, rialokimin e shumës së garancisë nga huadhënësi që nuk e ka ezauruar shumën e garancisë në favor të tij të huadhënësi, që e ka ezauruar atë plotësisht, duke ndryshuar për këtë qëllim edhe marrëveshjet e lidhura/nënshkruara të garancisë.

5. Autorizohet ministri i Financave dhe Ekonomisë për nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë me secilën nga bankat tregtare, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

6. Marrëveshja e mirëkuptimit, e cila nënshkruhet nga huamarrësi, përmban kushtet dhe kriteret sipas marrëveshjes tip të integruar si aneks në marrëveshjen tip të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.

7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë mund të kërkojë këshillim/asistencë nga Banka e Shqipërisë gjatë implementimit të marrëveshjeve të garancisë. Ky bashkëpunim mund të rregullohet edhe nëpërmjet një memorandumi bashkëpunimi.

8. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me urdhër të posaçëm, mund të ngarkojë ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të kësaj skeme garancie, duke përfshirë mbajtjen, përlogaritjen, rakordimin dhe raportimin e të dhënave nga punonjës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive.

9. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

Këshilli i Ministrave
Përfaqësuar nga
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë

[Banka]

Nr. _____ prot. Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____.____.2022 Tiranë, më _____.____.2022

MARRËVESHJE GARANCIE
për GARANTIMIN E HUAMARRJES SË
SUBJEKTEVE QË TREGTOJNË ME
SHUMICË PRODUKTE USHQIMORE BAZË
PËR TË MUNDËSUAR FINANCIMIN E
NEVOJSHËM PËR MBAJTJEN E
REZERVAVE ME QËLLIM PËRBALLIMIN E
SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR NË
TREG
(MARRËVESHJE TIP)
Deri në [XXXXXX] lekë
Datë

PREAMBULË

Qëllimi i skemës së garancisë është që të stimulojë huadhënien nga bankat tregtare që operojnë në Republikën e Shqipërisë, për t'i mundësuar subjekteve që tregtojnë me shumicë, produkte ushqimore bazë, financimin e nevojshëm për të mbajtur rezerva për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg.

Kjo marrëveshje garancie ("Marrëveshja e garancisë") e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ("MFE") dhe Bankës ("Huadhënësi"), bëhet për të përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes së Huadhënësit në këtë skemë garancie të administruar nga MFE-ja (ose çdo strukture tjetër të autorizuar nga MFE-ja).

Marrëveshja e Garancisë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin (në këtë Marrëveshje përfaqësuar nga MFE-ja), por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfituesi i drejtpërdrejtë i huas ("Huamarrësi") nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huan e

garantuar ("Huaja"), në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huas ("Marrëveshja e Huas") dhe janë plotësuar kushtet e parashikuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

Për sa më sipër, si edhe për të mundësuar realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshje, palët bien dakord me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Baza ligjore

Kjo Marrëveshje garancie është hartuar mbështetur, në:

- nenet 34–43 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

- nenin 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

- ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;

- ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar;

- aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 18.3.2022, "Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg", i ndryshuar;

- vendimin e Bordit të Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë, datë 5.4.2022;

- vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____ "Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, si edhe për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit".

Neni 2
Garancia

1. MFE-ja merr përsipër të garantojë Huadhënësin deri në vlerën [.....] (me fjalë)



lekë (“Vlera e garancisë”), sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje. Vlera e garancisë përfaqëson shumën maksimale të pagesave që do të kryhen nga MFE-ja për të shlyer detyrimet e papaguara ndaj Huadhënësit që burojnë nga huat që do t’i nënshtrohen kësaj skeme garancie.

2. MFE-ja merr përsipër të garantojë deri në vlerën e garancisë të cituar në pikën 1 të këtij neni, 60% të kryegjësë të çdo huaje që Huadhënësi do t’u lëvrojë huamarrësve sipas kushteve që pasojnë në këtë Marrëveshje.

3. “Vlera e garantuar e Huas” do të jetë shuma maksimale e garantuar nëpërmjet kësaj Marrëveshje përkatësisht për secilën nga huat e lëvruara nga Huadhënësi, në zbatim të kushteve të kësaj Marrëveshje dhe e cila do të jetë e barabartë me prodhimin e kryegjësë të Huas me përqindjen e kryegjësë të garantuar nga MFE-ja sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Në asnjë rast, MFE-ja nuk merr përsipër garantimin e interesave, kamatëvonesave, penaliteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar, që mund të burojë nga huat që Huadhënësi do t’i lëvrojë Huamarrësve.

5. Shuma maksimale e akumuluar e vlerës së garantuar të Huas që buron nga disbursimet e Huave dhe e përlogaritur sipas pikës 3 të këtij neni, nuk duhet të tejkalojë vlerën e garancisë të cituar në pikën 1 të këtij neni. Çdo disbursim i ri i ndonjë Huaje që tejkalon vlerën e sipërcituar nuk garantohet nga kjo Marrëveshje, me përjashtim të rastit kur shuma totale e vlerës së garantuar të Huas, së bashku me vlerën e garantuar të Huas që buron nga disbursimi i ri nuk tejkalon vlerën e garancisë.

6. Në rastin kur Huadhënësi e ka ezauruar të gjithë vlerën e garancisë në dispozicion të tij sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij neni, Huadhënësi duhet të njoftojë me shkrim MFE-në brenda një afati prej 5 (pesë) ditë pune.

7. Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka të drejtë që, nëse është e nevojshme, të bëjë rialokim të shumës së garancisë nga huadhënësi që nuk e ka ezauruar shumën e garancisë në favor të tij të huadhënësi që e ka ezauruar atë plotësisht.

Neni 3

Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huas

1. Huadhënësi do të japë Hua të garantuar sipas kësaj Marrëveshje, vetëm Huamarrësve, të cilët plotësojnë kriteret si më poshtë:

a) Huamarrësi duhet të jetë subjekt i cili tregton me shumicë produkte ushqimore bazë si mielli masiv, vaj luledielli, sheqer dhe oriz kokërrgjatë;

b) Huamarrësi duhet të jetë subjekt i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, dhe struktura e kapitalit të zotërohet 100% nga subjekte jopublike;

c) Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara për 3 periudhat tatimore njëkohësisht dhjetor 2021, janar–shkurt 2022, përjashtuar tatimpaguesit të cilët kanë lidhur marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore, si dhe tatimpaguesit, detyrimet e papaguara të të cilëve janë në proces apelimi në të gjitha shkallët.

d) Huamarrësi nuk duhet të ketë kredi me probleme në historik dhe në momentin aktual në Regjistër Kredie (këto sipas definicionit të rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 62, datë 14.9.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, të ndryshuar).

2. Qëllimi i përdorimit të fondeve të Huas është për t’i mundësuar Huamarrësit fondet e nevojshme për kapital qarkullues për të mbajtur rezerva të produkteve ushqimore bazë si mielli masiv, vaj luledielli, sheqer dhe oriz kokërrgjatë për një periudhë 3-mujore (e cila do të vlerësohet në masën prej 25% të sasisë së këtyre produkteve të blerë në vitin 2021) ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg. Në asnjë rast fondet e Huas nuk do të financojnë veprimtari të jashtëligjshme, apo të rifinancojnë hua të tjera. Huadhënësi në asnjë rast nuk merr përsipër me anë të kësaj Marrëveshje apo me nënshkrimin e Marrëveshjes së Huas, monitorimin e gjendjes së inventarit të Kredimarrësit të krijuar sipas këtij financimi.



3. Huamarrësi duhet të nënshkruajë Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas formës dhe përmbajtjes të përcaktuar në aneksin 1, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja e Mirëkuptimit duhet të jetë gjithashtu pjesë e Kontratës së Kredisë si Aneks i saj, në momentin e nënshkrimit të Kontratës.

4. Huamarrësi duhet të nënshkruajë formularin e vetëdeklarimit që do t'i vendoset në dispozicion nga Huadhënësi, nëpërmjet të cilit deklaron se Fondet e Huas do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Gjithashtu, në formularin e vetëdeklarimit, Huamarrësi duhet të deklarojë kreditë e aprovuara dhe ato në proces aplikimi/aprovimi në emër të Huamarrësit, të aprovuara apo në proces aprovimi brenda kësaj skeme garancie nga institucionet e tjera huadhënëse.

5. Huamarrësi duhet të dorëzojë kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendrike nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

6. Huamarrësi duhet të përmbushë kriteret financiare dhe ligjore të përcaktuara në aktet rregullative të bankës përkatëse në të cilën aplikohet për kredi.

7. MFE-ja gëzon të drejtën që në çdo moment të rishikojë, shtojë ose heqë çdonjërin prej kriterëve të cituara në pikat e mësipërme të këtij neni, në dakordësi me Huadhënësin, ku ndryshimi do të bëhet efektiv pas nënshkrimit të dokumentit ndryshues ndërmjet MFE-së dhe Huadhënësit. MFE-ja gëzon të drejtën që në çdo moment të zgjatë afatin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, duke vendosur në dijeni paraprakisht Huadhënësin. Ky ndryshim do të bëhet efektiv 10 ditë pune pas marrjes së njoftimit me shkrim të MFE-së nga Huadhënësi. Asnjë ndryshim i bërë në përputhje me këtë pikë nuk do të ndikojë mbi Huamarrësit, Huaja e të cilëve është aprovuar përpara datës së bërjes efektive të këtij ndryshimi.

8. Me përjashtim të rasteve të veçanta, ashtu si përcaktohet në pikën 7 të këtij neni, Huadhënësi në asnjë rast nuk do të aprovojë kërkesat për Hua të Huamarrësve, të cilët nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1–5 të këtij neni.

Neni 4

Detyrimet e Huadhënësit

1. Huadhënësi merr përsipër të përdorë format e aplikimit, të cilat garantojnë sigurimin e të gjithë informacionit të cituar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, sipas praktikave të tij bankare për këto produkte.

2. Huadhënësi mban përgjegjësi për plotësimin e dokumenteve të aplikimit për Hua dhe mban kopje të këtyre dokumenteve në arkivat e veta.

3. Huadhënësi merr masat që stafi i burimeve njerëzore, i cili do të angazhohet me huadhënien të ketë ekspertizën e duhur dhe të jetë familjar me politikat dhe procedurat e kësaj skeme garancie.

4. Huadhënësi do t'i trajtojë huat që do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje me profesionalizëm dhe në përputhje me kriteret dhe procedurat e brendshme që ai aplikon gjatë aktivitetit të tij të zakonshëm të kredidhënies për produkte bankare tregtare të ngjashme, si edhe në përputhje me përmbajtjen e nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Huadhënësi do të bëjë vlerësimin e riskut të kreditit të Huamarrësve në përputhje me standardet dhe legjislacionin bankar, duke iu referuar gjendjes financiare të Huamarrësit jo më vonë se muaji shkurt 2022.

6. Huadhënësi duhet të regjistrojë Huan menjëherë pas lëvrimit në regjistrin e kredive me një emërtim të veçantë “Kredi për kapital qarkullues brenda skemës së garancisë shtetërore për financimin mbajtjes së rezervave të produkteve ushqimore bazë, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg”. Ky emërtim do të konvertohet në një kod specifik i cili do të përdoret për të identifikuar këto kredi në linjë me rastet e ngjashme.

7. Gjithashtu, Huadhënësi në përputhje me nenin 3, pika 4, duhet t'i vendosë në dispozicion Huamarrësit formularin e vetëdeklarimit, sipas formës dhe përmbajtjes që Huadhënësi e gjykon të arsyeshme.

8. Huadhënësi nuk duhet të favorizojë ndonjë prej Huamarrësve, mbi bazën e kriterëve të tij preferencialë.

9. Huadhënësi duhet të vendosë në dispozicion të MFE-së (ose çdo strukture tjetër të autorizuar nga MFE-ja për këtë qëllim), me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, të ekstrakteve, të dokumenteve, të dhënave të regjistruara dhe të



shkresave të të gjitha huave që i nënshtrohen kësaj Marrëveshje garancie.

10. Huadhënësi, shqyrton dokumentacionin e nevojshëm dhe aprovon Huan në përputhje me afatet dhe procedurat e tij të brendshme, si dhe garanton kalimin e fondeve në llogarinë e Huamarrësit, si dhe përdorimin e Huas për qëllimin e mbuluar nga garancia shtetërore.

Neni 5

Termtat dhe kushtet e Huas

1. Afati i Huas duhet të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 3 (tre) vjetësh.

2. Huaja të jetë në formën e një produkti të kreditës bankare që të përmbajë një skedul të qartë të shlyerjes së huas. Në rast të një produkti ku nuk mund të ketë një skedul të qartë të shlyerjes, atëherë si afat shlyerjeje, për efekt të kësaj Marrëveshje garancie, do të konsiderohet afati i maturimit i përcaktuar në marrëveshjen e huas.

3. Huadhënësi, bazuar në vlerësimet e riskut të kreditit për secilin Huamarrës gëzon të drejtën që të kërkojë ose jokolateral shtesë nga Huamarrësi, por në asnjë rast masa e alokuar e kolateralit duke përfshirë edhe vlerën e garantuar të Huas sipas kësaj Marrëveshje nuk duhet të tejkalojë mbulimin e përlogaritur sipas legjislacionit dhe rregullave të brendshme të Huadhënësit.

4. Në rastet e parapagimit të Huas, Huadhënësi nuk duhet të aplikojë komision, penalitet apo çfarëdolloj mase tjetër që lidhet me parapagimin e Huas.

5. Monedha e Huas duhet të jetë në monedhën vendëse (lekë).

6. Huadhënësi duhet të ofrojë Huan me një normë interesi vjetore preferenciale, të barabartë me: i) normën mesatare të interesit të tre bonove të thesarit 12-mujore më të fundit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë (referenca/ indeksi), plus; ii) një marzh deri në 3%, në varësi të afatit të Huas. Norma vjetore e interesit do të jetë e ndryshueshme mbi bazë vjetore.

7. Termtat dhe kushtet e Huas do të përcaktohen në Marrëveshjen e Huas, e cila do të nënshkruhet ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit, në përputhje me përmbajtjen e kësaj Marrëveshje. Termtat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, të cilat bien në kundërshtim

me këtë Marrëveshje do të konsiderohen të pavlefshme për të përfituar nga garancia shtetërore dhe nuk do të prodhojnë asnjë efekt kundrejt MFE-së.

8. Asnjë transferim i të drejtave apo detyrimeve të Huadhënësit që burojnë nga kjo Marrëveshje ose nga Marrëveshja e Huas nuk mund t'i transferohet palëve të treta pa marrë paraprakisht aprovimin me shkrim të MFE-së.

9. Për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huas, që mund të bëhet në marrëveshjen ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk është i nevojshëm miratimi i MFE-së, me kusht që këto ndryshime nuk do të kenë asnjë efekt në të drejtat e Huadhënësit kundrejt MFE-së, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Huadhënësi do të njoftojë me shkrim MFE-në (ose çdo strukturë të autorizuar nga MFE-ja) për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huas.

10. Huadhënësi është përgjegjës që totali i shumës së vlerës së garantuar të huave, të mos tejkalojë vlerën e garancisë të lëshuar nga MFE-ja në favor të tij sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshje. Në asnjë rast, tejkalimi i vlerës së garancisë nuk do të përbëjë detyrim për MFE-në.

11. Huaja do të quhet e përfunduar dhe nuk do të jetë më objekt i kësaj Marrëveshje vetëm pasi të jetë paguar plotësisht nga Huamarrësi në përputhje me termtat dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas. Huadhënësi duhet të njoftojë me shkrim MFE-në për të gjitha huat e përfunduara brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga data e përfundimit të tyre.

Neni 6

Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë

1. Kur Huamarrësi nuk ka mundur të kryejë pagesën e detyrimeve që mbulohen nga garancia (*pagesën e kryejësë*) dhe kur Huadhënësi brenda një periudhë jo më pak se 120 ditë kalendarike, nga dita e parë e lindjes së detyrimit nga Huamarrësi sipas skedulit fillestar të shlyerjes së *kryejësë* të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas, ka ndërmarë të gjitha hapat e përcaktuara në procedurat dhe politikat e tij të brendshme për ndjekjen e huave të papaguara, atëherë Huadhënësi rezervon të drejtën për t'i



dërguar MFE-së kërkesën me shkrim për pagesën (“Kërkesa për pagesë”) e detyrimit të papaguar të Huas që mbulohet nga garancia sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t'i drejtojë MFE-së duhet të përmbajë:

a) vlerën e pagesës të përlogaritur në përputhje me pikën 3 të nenit 2, kopje të Marrëveshjes së Huas, si edhe një përshkrim të detajuar të detyrimeve, duke përcaktuar në mënyrë analitike kryegjënë, interesat e akumuluar, penalitetet, dhe çdo detyrim tjetër në zbatim të Marrëveshjes së Huas dhe që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht se MFE-ja garanton vetëm kryegjënë në masën 60%;

b) një përshkrim të të gjitha procedurave të ndjekura nga Huadhënësi përgjatë periudhës 120 ditore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rikuperuar detyrimet nga Huamarrësi, nga momenti i gjenerimit të detyrimit deri në momentin e dërgimit të kërkesës për pagesë;

c) numrin e llogarisë bankare në të cilin do të kryhet pagesa nga MFE-ja.

3. MFE-ja, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me pikën 2 të këtij neni dhe kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huas, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për Huadhënësin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së kërkesës për pagesë.

4. Nëse MFE-ja e vlerëson të arsyeshme, përpara autorizimit për kryerjen e pagesës dhe brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, mund të kërkojë informacion shtesë ose qartësime nga Huadhënësi.

5. MFE-ja nuk ka asnjë detyrim ndaj kërkesave për pagesë, të cilat mund të burojnë nga vjedhja, materializimi i risqeve operationale të Huadhënësit, ose për çdo arsye tjetër që nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7

Rikuperimi postpagesës së garancisë

1. Me kryerjen e pagesës së garancisë për ndonjë prej huave, MFE-ja merr në dorëzim menjëherë të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, në masën e çdo pagese të kryer nga MFE-ja në kuadër të garancisë për këtë Hua, që zotëronte Huadhënësi ndaj

Huamarrësit, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huas. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë MFE-së, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

2. MFE-ja, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, autorizon Huadhënësin që të ndjekë, në emër dhe për llogari të MFE-së, të gjitha procedurat e rikuperimit dhe ekzekutimit të detyrimeve, në përputhje me procedurat ligjore dhe praktikat e sektorit bankar, për të gjithë shumën e detyrimit të Huamarrësit. Në çdo rast Huadhënësi merr përsipër të kryejë të paktën të njëjtat procedura për rikuperimin e detyrimit, ashtu si për detyrimin e vetë Huadhënësit. Huadhënësi është i detyruar të njoftojë menjëherë MFE-së për çdo veprim procedural të kryer gjatë procedurës së ekzekutimit vullnetar ose të detyrueshëm, me qëllim që të mos cenohen të drejtat materiale apo procedurale të MFE-së. Përfundimisht, palët, me marrëveshje të veçantë, mund të bien dakord që heqin dorë nga ndjekja e procedurave për ekzekutimin e detyrimit, në rastet kur vlerësojnë se kostot e këtyre procedurave tejkalojnë masën e të gjithë detyrimit.

3. Nëse pas 2 (dy) viteve nga data e kryerjes së pagesës së garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, MFE-ja zotëron të drejtën që të ndjekë vetë procedurat ligjore për rikuperimin e detyrimeve në masën e çdo pagese të kryer nga MFE-ja në kuadër të garancisë për këtë Hua, në përputhje me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

4. Nëse pas pagesës së garancisë nga MFE-ja për ndonjë prej huave, Huadhënësi brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni rikuperon një pjesë ose të gjithë detyrimin e Huas (duke përfshirë edhe rikuperimin nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit, nëse ka një të tillë) që paraprakisht është paguar nga garancia, Huadhënësi brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune duhet të njoftojë me shkrim MFE-në në lidhje me vlerën e rikuperuar, procedurat e rikuperimit, shpenzimet e rikuperimit dhe çdo detaj tjetër që gjykon të arsyeshëm në lidhje me rikuperimin.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit, MFE-ja udhëzon me shkrim Huadhënësin në lidhje me detajet e pagesës. Afati për kryerjen e pagesës nga Huadhënësi në favor të MFE-së do të jetë si më poshtë:



a) në rastin kur rikuperimi është në formën e mjeteve monetare (*cash*), pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së instruksioneve me detajet e pagesës nga MFE-ja;

b) në rastin kur rikuperimi nuk është në formën e mjeteve monetare, pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e konvertimit të rikuperimit në mjete monetare (*cash*). Konvertimi i rikuperimit në mjete monetare (*cash*) do të kryhet në përputhje me procedurat dhe politikat e Huadhënësit për këtë qëllim.

5. Vlera që Huadhënësi paguan në favor të MFE-së, në rast të rikuperimit të detyrimit të Huamarrësit nga Huadhënësi pas pagesës së garancisë, është e barabartë me vlerën e rikuperuar pasi t'i jenë zbritur shpenzimet për rikuperimin e Huas, dhe ku vlera e mbetur pasi janë zbritur shpenzimet, të ndahet ndërmjet Huadhënësit dhe MFE-së në raportet përkatësisht prej 40% për huadhënësin dhe 60% për MFE-në.

6. Në rast se Huamarrësi, përveç detyrimit që buron nga Huaja nën këtë Marrëveshje garancie ka edhe detyrime të tjera ndaj Huadhënësit, atëherë ndjekja e detyrimit që buron nga kjo Hua ndiqet njëkohësisht me ndjekjen e detyrimeve të tjera, pa asnjë lloj diskriminimi nga Huadhënësi, pa cenuar rankimin e kredive dhe kushtet e huave dhe garancive respektive, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Raportimi dhe monitorimi

1. Huadhënësi çdo të hënë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE-së (ose strukturës që do të autorizojë MFE-në për këtë qëllim) për huat e aprovuara prej tij në javën paraardhëse, duke përcjellë shumën e disbursuar, skedulën e amortizimit të huave, Marrëveshjen e Mirëkuptimit origjinale, si edhe kopje të dokumenteve shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huas sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huadhënësi gjithashtu do të raportojë në formë elektronike në bazë mujore pranë MFE-së (ose strukturës që do të autorizojë MFE-në për këtë qëllim), jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga mbyllja e secilit muaj, ecurinë e shlyerjes së Huas, duke përfshirë në raportim

informacion në lidhje me pagesat e kryera të Huas nga Huamarrësi dhe vlerën e mbetur të Huas.

3. Raportimet në lidhje me këtë nen, si dhe për nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen në formë elektronike ose me shkrim sipas rasteve të përcaktuara në nenet përkatëse. Ato duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

[Adresa]

Në vëmendje të:

E-mail:

Faks:

Për Bankën XYZ:

[Adresa]

Në vëmendje të:

E-mail:

Faks:

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkelja, zgjidhja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët. Nëse palët nuk arrijnë t'i zgjidhin ato me mirëkuptim, zgjidhja e tyre do t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatës administrative shqiptare.

Neni 10

Vlefshmëria e dispozitave

Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose në rast se ka ndonjë boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe efektiviteti

Kjo Marrëveshje garancie do të hyjë në fuqi, pas nënshkrimit nga palët dhe do të bëhet efektive pas disbursimit të Huas ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit.



Neni 12
Nënshkrimi

Palët kontraktuese nënshkruajnë këtë Marrëveshje në 2 kopje origjinale të barasvlershme në gjuhën shqipe (një kopje për MFE-në dhe një kopje për Huadhënësin), në Tiranë, Shqipëri, në datat e përcaktuara në krye të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
Përfundimi dhe pezullimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje garancie do të quhet e përfunduar kur të gjitha detyrimet ndërmjet palëve, të cilat burojnë nga Marrëveshja e Huas dhe kjo Marrëveshje të jenë përmbushur plotësisht, në rast se nuk do të kërkohet përfundimi përpara kohe i saj nga ana e MFE-së ose Huadhënësit. Në rast se do të kërkohet përfundimi i kësaj Marrëveshjeje përpara kohe, ky proces nuk do të ndikojë në detyrimet e lindura deri në atë moment.

2. MFE-ja mund të pezullojë Marrëveshjen e garancisë në çdo kohë, duke e njoftuar me shkrim Huadhënësin, në rast se MFE-ja vërteton se Huadhënësi ka kryer një shkelje të kësaj Marrëveshjeje, ose është përfshirë në një mashtrim, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë të MFE-ja.

KËSHILLI I MINISTRAVE
PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
MINISTËR
DELINA IBRAHIMAJ

BANKA

ADMINISTRATOR
[EMËR MBIEMËR]

ANEKS 1
MARRËVESHJE MIRËKUPITIMI
(FORMAT TIP)

Bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 676, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:

[Emërtimi i Huamarrësit] bie dakord të nënshkruaj këtë Marrëveshje Mirëkuptimi në datën ____/____/2022, për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga lëshimi garancisë shtetërore të Huas, sipas Marrëveshjes së garancisë nr. _____, datë _____.2022.

- në nenin 38 të ligjit nr. 181/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, ‘Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të Huas në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.

Huamarrësi X bie dakort të nënshkruajë Marrëveshjen e Mirëkuptimit datë ____/____/2020 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga lëshimi i Linjës së Garancisë Qeveritare, sipas Linjës së Garancisë Nr._____, datë____/____/2020.

Në rast të aktivizimit të kësaj Linje Garancie, Huamarrësi X, do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ti kthyer Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shumë/shumat që kjo e fundit i ka paguar Huadhënësit Y, në kuadër të Linjës së Garancisë, përfshirë edhe të gjitha kostot që lidhen me to.

Në rast të kundër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligje të tjera në fuqi për të përfituar nga Huamarrësi X çdo pagesë të bërë sipas garancisë, përfshirë edhe kostot që lidhen me të.

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi do të firmoset nga Huamarrësi X dhe nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë një ndër kushtet e përfitimit të huasë së garantuar.

HUAMARRËSI X

XXXXXXXXXX

ADMINISTRATOR

Në rast të aktivizimit të kësaj Linje Garancie, Huamarrësi X, do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ti kthyer Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shumë/shumat që kjo e fundit i ka paguar Huadhënësit Y, në kuadër të Linjës së Garancisë, përfshirë edhe të gjitha kostot që lidhen me to.

Në rast të aktivizimit të kësaj Linje Garancie, Huamarrësi X, do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ti kthyer Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shumë/shumat që kjo e fundit i ka paguar Huadhënësit Y, në kuadër të Linjës së



Garancisë, përfshirë edhe të gjitha kostot që lidhen me to.

Në rast kompensimi të humbjeve nga MFE-ja për pagesa që burojnë nga Marrëveshja e Huas sipas Marrëveshjes së garancisë cituar në paragrafin e mësipërm, [Emërtimi i Huamarrësisë] në zbatim të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, është i detyruar t’i kthejë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huas, përfshirë dhe të gjitha kostot që mund të lidhen me të.

Në rast të kundërt, [Emërtimi i Huamarrësisë] është në dijeni dhe pranon shprehimisht se MFE-ja ka të drejtën për të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe në ligje të tjera në fuqi, dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfituar nga [Emërtimi i Huamarrësisë] çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të, si dhe kthimin e çdo kompensimi të kryer sipas Marrëveshjes së garancisë; si dhe që Marrëveshja e Mirëkuptimit përbën akt në kuptimin e nenit 510, pika “d”, të Kodit të Procedurës Civile, duke u siguruar që të përmbushë elementet e kërkuara nga dispozita e sipërcituar.

[Emërtimi i Huamarrësisë]
Nënshkrimi

VENDIM
Nr. 351, datë 26.5.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 71, DATË 2.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA PUNONJËSIT DHE ISH-PUNONJËSIT E RAFINERISË SË NAFTAËS, BALLSH”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e

vitet 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 71, datë 2.2.2022, të Këshillit të Ministrave, në shkronjën “b”, të pikës 3, të kreut II, “Kriteret dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës financiare”, pas fjalës “... invaliditeti ...” shtohet “... të plotë ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 352, datë 26.5.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1090, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË PRONARËVE PËRFITUES, PËR MËNYRËN E KOMUNIKIMIT NË FORMË ELEKTRONIKE DHE SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE NDËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT DHE ORGANEVE PËRGJEGJËSE SHTETËRORE, SI DHE PËR MËNYRËN E AFATET E KOMUNIKIMIT MES REGJISTRIT TË PRONARËVE PËRFITUES, REGJISTRIT TREGTAR DHE REGJISTRIT TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7; 7, pika 9; 13, pika 7; e 14, pika 3, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1090, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Kreu II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“II. RREGULLAT PËR MËNYRËN E TRANSFERIMIT TË TË DHËNAVE NGA



REGJISTRI TREGTAR DHE REGJISTRI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

1. Të dhënat e përgjithshme për subjektin raportues, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse transferohen automatikisht në mënyrë elektronike, nëpërmjet ndërveprimit të këtyre bazave të të dhënave shtetërore, si të dhëna dytësore në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

2. Në përputhje me pikën 1, të nenit 15/1, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, regjistrimi fillestar i të dhënave për pronarët përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi direkte, kryhet sipas parashikimeve vijuese të këtij kreu.

3. QKB-ja identifikon subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi direkte, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 6/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, ‘Për regjistrin e pronarëve përfitues’, të ndryshuar”, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues.

4. QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, brenda datës 30.6.2022, nga baza e të dhënave ekzistuese në Regjistrin Tregtar transferon në Regjistrin e Pronarëve Përfitues të dhënat e pronarëve përfitues që identifikohen sipas përcaktimeve ligjore, në lidhje me subjektet e përcaktuara sipas pikës 3, të këtij kreu.”.

b) Pika 3, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Me marrjen e njoftimit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, e deri në pagimin e saj dhe kryerjen e regjistrimit të detyrueshëm, QKB-ja ose autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse zbaton masat e parashikuara nga neni 13, i ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.”.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 353, datë 26.5.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT ‘PËR AKCIZAT’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 108 e 109, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pas pikës 5, të nenit 24 “Humbjet e pakthyeshme”, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Në zbatim të nenit 11 të ligjit, pullat fiskale, që shkatërrohen plotësisht gjatë procesit të vendosjes nga makineritë e prodhimit ose ambalazhimit të produkteve të akcizës, konsiderohen si humbje të pranuar, në rast se konfirmohen me deklaratë vjetore të lëshuar nga fabrikat prodhuese ose ambalazhuese, por, në çdo rast, jo më shumë se niveli mesatar vjetor që nuk kalon 0,5% për artikujt e kapitullit 24 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe deri në 1% për rastet e tjera, të totalit të pullave të përdorura nga operatori gjatë vitit. Për këtë sasi pullash, që shkatërrohen plotësisht nga makineritë, nuk përlogariten detyrime akcize apo penalitete.

6.1 Pullat e akcizës të shkatërruara plotësisht nga makineritë llogariten si vijon: gjendja e pullave në fillim të vitit plus furnizimet gjatë vitit minus totalin e pullave të vendosura në produktet e akcizës gjatë vitit, pullave të kthyer gjatë vitit për t'u asgjësuar me prezencën e organeve doganore dhe gjendjen në fund të vitit.

6.2 Deklarata faktike për humbjet e pranuar të pullave, që shkatërrohen plotësisht nga makineritë dhe nuk mund t'i kthehen fizikisht organeve doganore, hartohet nga prodhuesit e mallrave që bëjnë vendosjen e pullave dhe depozitohet në



Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave brenda datës 31 mars të çdo viti, për vitin e mëparshëm kalendarik. Operatorët, që furnizohen nga disa fabrika prodhuese jashtë vendit, bëjnë një deklaratë përmbledhëse vjetore, e cila paraqitet nga operatori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave brenda datës 31 mars të çdo viti, për vitin e mëparshëm kalendarik.”.

Neni 2

Në nenin 48/1, “Produktet e akcizës pa pullë fiskale, që pranohen në një magazinë fiskale stokimi/magazinë doganore”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Vendosja e pullave të akcizës në ambientet e magazinave fiskale të stokimit/magazinave doganore kryhet sipas përcaktimeve të nenit 41, të ligjit.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Në përfundim të procesit të vendosjes së pullave të akcizës në produktet e akcizës hartohet procesverbali përkatës, në të cilin pasqyrohen të gjitha të dhënat në lidhje me sasinë e pullave të akcizës të vendosura dhe sasinë e produkteve të akcizës sipas llojeve tek të cilat u aplikuan pullat e akcizës. Në rastet kur autoritetet doganore mbikëqyrëse sigurojnë prezencën gjatë procesit të vendosjes së pullave, procesverbali nënshkruhet nga përfaqësuesi i autoriteteve doganore dhe depozituesi i miratuar/importuesi.”.

Neni 3

Dispozitë tranzitore

Për periudhat e mëparshme përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, operatorët kanë afat deri më 31 korrik 2022, për dorëzimin e deklaratave faktike për humbjet e pranuar, sipas parashikimeve të nenit 1, të këtij vendimi.

Neni 4

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 354, datë 26.5.2022

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DEGËVE TË THESARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e degëve të thesarit, si degë territoriale të ministrisë përgjegjëse për financat.

2. Numri i degëve të thesarit është 36 (tridhjetë e gjashtë), sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Degët e thesarit financohen nga buxheti i shtetit. Buxheti i tyre është pjesë e buxhetit të sistemit të ministrisë përgjegjëse për financat.

4. Misioni i degëve të thesarit është kontrolli financiar dhe kontabël për miratimin e transaksioneve të njëjësive shpenzuese dhe arkëtuese buxhetore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe raportimi i të dhënave të realizimit të buxhetit.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DEGËVE TË THESARIT

1. Secila degë thesari e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit për të cilën ajo është krijuar.

2. Detyrat kryesore të degëve të thesarit janë, si më poshtë vijon:

a) ushtron kontroll formal e dokumentar, si dhe kontroll të destinacionit dhe të shumës së fondeve në dispozicion për transaksionet e shpenzimeve buxhetore;

b) rakordon e raporton të ardhurat e njëjësive buxhetore të ngarkuara në sistemin informatik financiar të qeverisë nga sistemi bankar;

c) regjistron, dokumenton, rakordon e raporton realizimin e treguesve buxhetorë dhe pasqyrat financiare të njëjësive buxhetore, në përputhje me metodologjinë e miratuar;

ç) konfirmon pagesat e njëjësive shpenzuese buxhetore, duke respektuar limitet e arkës, të



përcaktuara nga njësi përgjegjëse për thesarin në ministri, në sistemin informatik financiar;

d) harton treguesit e performancës së njësi buxhetore.

3. Drejtuesi i degës territoriale drejton degën përkatëse territoriale dhe i raporton e i jep llogari drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për financat. Në përditshmërinë e punës së tyre, degët e thesarit komunikojnë dhe raportojnë pranë drejtuesit të njësisë përgjegjëse për thesarin në ministrinë përgjegjëse për financat.

4. Struktura dhe organika e degëve të thesarit miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Marrëdhëniet e punës së titullarëve të degëve të thesarit dhe nëpunësve të tyre rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

6. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të çdo dege të thesarit miratohet nga ministri përgjegjës për financat, me propozimin e titullarit përkatës të degës, nëpërmjet njësisë përgjegjëse për thesarin në ministri.

7. Degët e thesarit kanë stemat, logot dhe vulat e tyre zyrtare. Stema e secilës degë thesari ka shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Dega e Thesarit ...”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës.

8. Vula e secilës degë thesari ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Për nëpunësit civilë aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe degëve të saj zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

2. Deri në miratimin e strukturës e të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të degëve të thesarit, sipas këtij vendimi, struktura ekzistuese vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

3. Ministri përgjegjës për financat, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përgatit e ndjek zbatimin e procedurave për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfshirë si pjesë përbërëse të saj njësinë përgjegjëse për thesarin, si dhe strukturën e organikën e degëve të thesarit.

4. Numri i punonjësve dhe fondet e miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit kalojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërsa numri i punonjësve dhe fondet e miratuara për degët e thesarit kalojnë pranë këtyre të fundit, si degë territoriale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

5. Vendimi nr. 298, datë 23.5.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, degët e thesarit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



ANEKS 1

Nr.	Degët e thesarit	Bashkitë
1	Berat	Bashkia Berat
		Bashkia Dimal
2	Kuçovë	Bashkia Kuçovë
3	Skrapar	Bashkia Çorovodë
		Bashkia Poliçan
4	Bulqizë	Bashkia Bulqizë
5	Dibër	Bashkia Peshkopi
6	Mat	Bashkia Mat
		Bashkia Klos
7	Durrës	Bashkia Durrës
		Bashkia Shijak
8	Krujë	Bashkia Krujë
9	Elbasan	Bashkia Elbasan
		Bashkia Cërrik
		Bashkia Belsh
10	Gramsh	Bashkia Gramsh
11	Peqin	Bashkia Peqin
12	Librazhd	Bashkia Librazhd
		Bashkia Përrenjas
13	Fier	Bashkia Fier
		Bashkia Patos
		Bashkia Roskovec
14	Mallakastër	Bashkia Mallakastër
15	Lushnjë	Bashkia Lushnjë
		Bashkia Divjakë
16	Gjirokastrë	Bashkia Gjirokastrë
		Bashkia Libohovë
		Bashkia Dropull
17	Përmet	Bashkia Përmet
		Bashkia Këlcyrë
18	Tepelenë	Bashkia Tepelenë
		Bashkia Memaliaj
19	Korçë	Bashkia Korçë
		Bashkia Maliq
		Bashkia Pustec
20	Ersekë	Bashkia Ersekë
21	Devoll	Bashkia Bilisht
22	Pogradec	Bashkia Pogradec
23	Kukës	Bashkia Kukës



24	Has	Bashkia Krumë
25	Tropojë	Bashkia Bajram Curri
26	Lezhë	Bashkia Lezhë
27	Laç	Bashkia Laç
28	Mirditë	Bashkia Rrëshen
29	Shkodër	Bashkia Shkodër
		Bashkia Vau i Dejës
30	Pukë	Bashkia Pukë
		Bashkia Fushë-Arrëz
31	Malësi e Madhe	Bashkia Koplik
32	Tiranë	Bashkia Tiranë
		Bashkia Vorë
		Bashkia Kamzë
33	Kavajë	Bashkia Kavajë
		Bashkia Rrogozhinë
34	Sarandë	Bashkia Sarandë
		Bashkia Konispol
35	Vlorë	Bashkia Vlorë
		Bashkia Selenicë
		Bashkia Himarë
36	Delvinë	Bashkia Delvinë
		Bashkia Finiq

VENDIM

Nr. 355, datë 26.5.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 921, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 3, 8, 14, 15, pika 12, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në bazën ligjore, referenca ligjore “... neneve 7, pika 3, e 15, pika 3, shkronja “dh”, pika 4, shkronja “ç”, pika 5, shkronja “dh”, pika 6,

shkronja “d”, pika 7, shkronja “dh”, pikat 9, 11 e 12, të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 ...” zëvendësohet me “... neneve 7, pika 3, 8, 14, 15, pika 3, shkronja “dh”, pika 4, shkronja “ç”, pika 5, shkronja “dh”, pika 6, shkronja “d”, pika 7, shkronja “dh”, pikat 9, 11 e 12, të ligjit nr. 102/2014 ...”.

2. Në pjesën VIII/1 bëhen këto ndryshime:

2.1 Në pikën 1 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është 1 074 (një mijë e shtatëdhjetë e katër) punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor. Struktura organike dhe analitike e administratës doganore është sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”;

b) Në shkronjën “a”, nënndarja “ii/1”, emërtesa “Koordinator i Rrjetit Antikorrupsion” zëvendësohet me “Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”;



c) Në shkronjën “b”, nëndarja “ii/1” zëvendësohet me nëndarjen me të njëjtin numër, me këtë përmbajtje:

“ii/1. Krijimi, misioni, organizimi dhe funksionimi, përgjegjësitë funksionale, marrëdhëniet e punës së pozicionit Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit përcaktohen në aktet nënligjore përkatëse në fuqi.”

2.2 Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përbëhet nga Departamenti Administrativ, Departamenti Teknik, Departamenti i Akcizës, Departamenti Operativ Hetimor, struktura që varen drejtpërdrejt nga drejtori i përgjithshëm i Doganave (niveli qendror) dhe degët doganore (niveli vendor).

a) Strukturat që varen drejtpërdrejt nga drejtori i përgjithshëm i Doganave janë, si më poshtë vijon:

i. Zyra e drejtorit të përgjithshëm të Doganave

Kjo zyrë koordinon, mbështet, ndihmon e këshillon drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, lidhur me:

- prioritetet që ndikojnë në funksionet e drejtorit të përgjithshëm;

- analizimin e kërkesave të marra dhe kontrollin e përgjigjeve që u dërgohen grupeve kryesore të interesit, të iniciuara nga drejtori i përgjithshëm;

- hartimin e planeve të punës dhe të strategjisë institucionale;

- orientimin, organizimin dhe harmonizimin e veprimtarisë në zyrën e drejtorit të përgjithshëm;

- çështjet që lidhen me elementet teknike dhe procedurale, zbatimin e projekteve, në të cilat përfituese është administrata doganore dhe stimulimin e shtimit të nivelit të asistencës, vlerësimin e përmirësimin e elementeve të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe kryesisht komunitetin e biznesit lidhur me risitë, nismat dhe zhvillimet e administratës doganore;

- ndjekjen e problemeve të përditshme, sipas detyrave të përcaktuara nga drejtori i përgjithshëm;

- formulimin dhe zbatimin e planeve të veprimit, strategjive, sipas detyrave të institucionit, si dhe sigurimin e lidhjeve organike me strukturat organizative, komunitetin e biznesit dhe institucionet e tjera, qendrore dhe vendore.

ii. Koordinatori i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit emërohet dhe kryen veprimtarinë e vet, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore përkatëse në fuqi.

Koordinatori, sipas nevojave të tij, në ushtrimin e detyrave, mbështetet nga strukturat e tjera brenda dhe jashtë institucionit.

iii. Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë përbëhet nga sektori i koordinimeve dhe projekteve dhe nga sektori i integritimit evropian.

Kjo drejtori kryen këto detyra:

- Ndjek e menaxhon marrëdhëniet me administratat doganore të vendeve të tjera e me partnerët e huaj brenda dhe jashtë vendit;

- Përgatit, në bashkëpunim me strukturat e tjera, marrëveshjet e asistencës administrative dypalëshe për çështje doganore, si dhe protokollet e bashkëpunimit me këto administrata;

- Përgatit, në bashkëpunim me strukturat e tjera, sipas rastit, dokumentacionin e nevojshëm, si dhe aplikon për t'u bërë pjesë dhe/ose për të përfituar nga programe a projekte asistence, të ofruara nga organizmat e Bashkimit Evropian apo nga institucionet, organizmat dhe struktura të tjera, bazuar në nevojat e kërkesat e administratës doganore;

- Menaxhon projektet e ndryshme të financuara plotësisht a pjesërisht nga Bashkimi Evropian ose nga organizma/struktura të tjera, përfituese e të cilave është administrata doganore;

- Ndjek e menaxhon marrëdhëniet me masmedian dhe me komunitetin e biznesit, si dhe përgatit e ndjek zbatimin e programeve të publikimit të çdo risie në sistemin doganor;

- Bashkërendon punën me strukturat respektive dhe, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të DPD-së, përgatit, sipas rastit, raportet periodike dhe informacionet e nevojshme, në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian;

- Organizon vizita të delegacioneve doganore të huaja në Republikën e Shqipërisë dhe të delegacioneve të doganës shqiptare jashtë;

- Administron pjesëmarrjen e personelit të administratës doganore në veprimtari të ndryshme jashtë vendit;

- Kryen shërbime përkthimi për nevojat e administratës doganore.

iv. Drejtoria e Auditit të Brendshëm

Kjo drejtori ushtron auditimin e përgjithshëm të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në mënyrë të pavarur dhe objektive, verifikon saktësinë e zbatimit të procedurave administrative të kryera nga personeli doganor dhe



përgatit raporte për drejtorin e përgjithshëm ose, kur është e nevojshme, për komisionin disiplinor.

Në rastet e trajtimit të çështjeve të njëjta nga kjo drejtori, si dhe nga Koordinatorin i Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale vihet në dispozicion të Koordinatorit dhe e asiston atë gjatë kryerjes së hetimeve.

v. Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale

Kjo drejtori heton shkeljet për raste të mundshme korrupsioni të denoncuar nga qytetarë, operatorë ekonomikë apo bazuar në informacione të ardhura nga sektorë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit. Gjithashtu, kjo drejtori nxjerr përgjegjësitë për rastet konkrete dhe marrjen e masave të nevojshme, jep kontribut për përmirësimin e disiplinës në punë dhe të rregullave të etikës në përgjithësi. Me qëllim rritjen e standardeve profesionale, implementon testin e integritetit dhe metodën e dokumentimit të standardizuar.

vi. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, që përbëhet nga:

- Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit të Buxhetit;

- Sektori i Financës dhe Kontabilitetit;

- Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave.

Kjo drejtori është përgjegjëse, për:

- zbatimin e legjislacionit e të procedurave që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe buxhetin e financave publike, organizimin e punës në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm të institucionit, hartimin e pasqyrave përmbledhëse të projektbuxhetit, si dhe për detajimin e planit të buxhetit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për aparatin e drejtorisë dhe degët doganore;

- hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit dhe raportimin e tyre pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda afateve të përcaktuara;

- rakordimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të fondeve buxhetore të planifikuara e të realizuara;

- monitorimin rregullisht të transfertave nga gjocat në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përdorimin e tyre për pjesën e shpenzimeve operative dhe investime, si dhe fondin për shpërblimin nga gjocat në përputhje me

Kodin Doganor e udhëzimet përkatëse për këtë qëllim;

- kryerjen e analizave financiare dhe të bilancit, mbajtjen e kontabilitetit, shpërndarjen e dhënien e fondeve të nevojshme për funksionimin e zyrave qendrore e vendore, pagimin e personelit doganor dhe administrimin e pagave e të shpërblimeve të tjera shtesë të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

- ndjekjen, kontrollin dhe monitorimin e të gjitha pagesave në sistem, përgatitjen e procedurave të kreditimit të pagesave dhe të kontrollit të tyre me bankat e thesarit;

- Ndjekjen e përgatitjes së raportimeve periodike për kreditë dhe debitë e trashëguara;

- monitorimin e pagesave hyrëse në sistemin *Asycuda World*, që të bëhen në mënyrë standarde;

- sigurimin që pagesat të bëhen në numrin e llogarisë që i përket shoqërisë;

- ndjekjen dhe evidentimin e të gjitha pasaktësive të arkëtarëve të degëve doganore lidhur me pagesat hyrëse në sistem;

- administrimin e rregullave e të procedurave të dhënies së garancive doganore dhe të akcizës, të monitorimit e të zhbllokimit të tyre;

- përgatitjen e raporteve përkatëse lidhur me shumat e kredituara në sistemin *Asycuda World* gjatë periudhës dhe bërjen e përpunimit të këtyre raporteve;

- përgatitjen e informacionit përfundimtar lidhur me krahasimin e shumave të kredituara në sistem me ato të marra nga thesari dhe të dhënat e dërguara nga çdo degë doganore;

- sigurimin që të marrë periodikisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në format elektronik, dhe në periudha njëmuajore informacion të detajuar nga thesari lidhur me pagesat e bëra, për shkak të veprimtarisë doganore.

vii. Drejtoria e Statistikës, Analizës së të Ardhurave dhe Administrimit të Borxhit, që përbëhet nga:

- Sektori i Statistikës dhe Analizës së të Ardhurave;

- Sektori i Monitorimit të Borxhit dhe Ndërveprimit me Tatimet.

Kjo drejtori ka këto detyra:

- Mbledh të dhëna për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe joshqiptare, që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, monitoron e detajon planin e të ardhurave,



analizon të dhënat, objekt të vlerësimit nga zyrat e interesuara dhe autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke e zgjeruar fushën e përgjegjësive edhe me studime e analiza të realizimit të të ardhurave dhe mallrave kryesore;

- Administron procedurat për regjistrimin e operatorëve në sistemin doganor, lindjen dhe rikuperimin e borxhit, përgatitjen dhe administrimin e udhëzimeve për kontabilizimin e të ardhurave nga detyrimet e importit, eksportit ose akcizës, për vjeljen e detyrimeve dhe rimbursimin ose shlyerjen e borxhit, si dhe monitoron procedurat për vjeljen e borxhit e rikuperimin me forcë;

- koordinon veprimet me strukturat tatimore, me synim forcimin e luftës kundër informalitetit në fushën fiskale;

- përgatit raporte, analiza, studime, analizon dhe vlerëson informacionet e ndryshme, që merr nga strukturat tatimore dhe/ose doganore, dhe propozon ndërtimin e profileve të reja të riskut etj.

b) Departamenti Administrativ përbëhet nga këto drejtori:

i. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, që përbëhet nga:

- sektori i menaxhimit të burimeve njerëzore;
- sektori i trajnimeve dhe i etikës;
- zyra e sekretarit/protokollit dhe arkivit.

Kjo drejtori bashkëpunon me DAP-in, administron procedurat e rekrutimit të personelit doganor, emërimet, ngritjen në detyrë, zbatimin e masave disiplinore, shkarkimet nga detyra, administron transferimin e personelit brenda zyrave të administratës doganore, ngritjen e përkohshme në detyrë, lëshon kartat e shërbimit dhe të identitetit për personelin doganor dhe administron arkivin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

Gjithashtu, kjo drejtori harton programe bazë për trajnimin e personelit, organizon kurse, seminare dhe veprimtari të tjera trajnuese për personelin doganor nga fushat kryesore, organizimin dhe zbatimin e trajnimit, duke përfshirë caktimin e trajnimit të personelit, bashkërendon veprimtaritë trajnuese e të ndihmës teknike, që jepen nga administratat e huaja doganore dhe organizatat ndërkombëtare, kontrollon në vijimësi zbatimin e Kodit të Etikës në administratën doganore, duke mos krijuar mbivendosje/pa rënë ndesh me detyrat funksionale

të Drejtorisë së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale, si dhe transparencën në deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesave.

ii. Drejtoria e Burimeve Mbështetëse, që përbëhet nga:

- Sektori i Investimeve dhe Logjistikës;
- Sektori i Prokurimit;
- Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (*help desk*).

Kjo drejtori planifikon, në bashkëpunim me të gjitha departamentet, blerjet, ndërtimet e rindërtimet e mjediseve dhe blerjen e makinerive dhe të pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë doganore, duke përfshirë kompjutera, mjete transporti, pajisje për laboratorin e doganës, uniformat e personelit dhe orenditë e zyrave.

Gjithashtu, kjo drejtori realizon procedurat e blerjes, të qirave, në bashkëpunim me degët doganore dhe zyrat e tjera të interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe administron e mirëmban mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Sektori i zgjidhjeve dhe suportit (*help desk*) ofron angazhimin për biznesin, asistencë projektesh dhe shqyrtimin e propozimeve lidhur me teknologjinë e informacionit, shërbimin *help desk* me anë të aplikacioneve elektronike ose telefonit për probleme të ndryshme që lindin gjatë përdorimit të sistemeve informatike doganore dhe delegon problemin në sektorët apo drejtoritë përkatëse, kur për zgjidhjen e tij kërkohet ndërhyrje më e specializuar, si dhe bashkërendon punën ndërmjet strukturave të përfshira në këto zgjidhje dhe AKSHI-t.

iii. Drejtoria Juridike, që përbëhet nga:

- Sektori i Legjislacionit dhe Përafrimit me Bashkimin Evropian;
- Sektori i Ankimimit.

Sektori i legjislacionit dhe përafrimit me Bashkimin Evropian mbështet propozimet ligjore për çështje që kanë të bëjnë me fushën doganore apo të akcizës, ndjek planin e përafrimit të legjislacionit doganor/akcizës me atë të Bashkimit Evropian dhe jep asistencë ligjore në bashkëpunim me strukturat përkatëse teknike në DPD, për raste specifike dhe kur kërkohet.

Sektori i ankimimit shqyrton ankimet administrative ndaj vendimeve të degëve doganore për pagesën e detyrimeve dhe/ose gjobave, të cilat ia paraqet për vendimmarrje drejtorit të



Përgjithshëm të Doganave, administron proceset gjyqësore, ku palë është DPD-ja, si dhe, në bashkëpunim me strukturat përkatëse teknike në DPD, jep ndihmë ligjore për proceset gjyqësore, ku palë janë degët doganore, në rastet kur kërkohet prej tyre.

c) Departamenti Teknik përbëhet nga drejtoritë, si më poshtë vijon:

i. Drejtoria e Procedurave Doganore, që përbëhet nga:

- Sektori i Procedurave dhe Regjimeve Doganore;

- Sektori i Lehtësirave Doganore.

Kjo drejtori, në përputhje me dispozitat në fuqi:

- administron dokumentacionin për lëvizjen e mallrave dhe të bagazheve brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, deklaratat përmbledhëse, dokumentet për magazinimin e përkohshëm të mallrave dhe për deklarimin doganor, lehtësimin e thjeshtimit të procedurave doganore;

- administron procedurat dhe regjimet doganore dhe harton autorizimet përkatëse;

- harton licencat për agjentët doganorë;

- administron dokumentet për turizmin ndërkombëtar, regjimet doganore të çlirimit për qarkullim të lirë, të eksportit dhe regjimet e posaçme, e, më konkretisht, tranzitin, i cili përfshin transitin e jashtëm e të brendshëm; magazinimin, i cili përfshin magazinimin doganor dhe zonat e lira; përdorimin e veçantë, i cili përfshin lejimin e përkohshëm dhe përdorimin e veçantë përfundimtar (*end-use*); përpunimin, i cili përfshin përpunimin aktiv dhe pasiv;

- administron dokumentet për magazinat e furnizimit dhe *duty free shops*, furnizimet dhe pajisjet për përdorim në bord të mjeteve të transportit, për ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin e mallrave me karakter fitosanitar;

- administron rregullat, si dhe procedurat e lehtësimit të thjeshtimit, si zhdoganimin lokal, operatorët ekonomikë të autorizuar, kompetencat territoriale etj.;

- jep udhëzimet e nevojshme për përdoruesit në lidhje me sistemet e të dhënave, të formularëve, të regjistrave dhe të blloqeve përkatëse, të nevojshme në lidhje me procedurat doganore;

- informon operatorët ekonomikë për procedurat doganore, lehtësitë dhe thjeshtimet, që ofron legjislacioni doganor;

- harmonizon udhëzimet apo aktet e tjera të nivelit të tretë me Kodin Doganor.

ii. Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, që përbëhet nga:

- Sektori i Tarifës dhe i Klasifikimit Tarifor;

- Sektori i Origjinës.

Kjo drejtori:

- harton e përditëson nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore, si dhe administron shënimet (notat) shpjeguese, jep informacion të detyrueshëm tarifor (IDT);

- administron operacionet e privileguara, mbikëqyr rregullat për taksat e tjera në import dhe mbikëqyr rregullat për TVSH-në në import;

- ndjek zbatimin e masave tarifore preferenciale, masat autonome, trajtimet tarifore favorizuese, kuotat e tavanet tarifore, si dhe masat e tjera tarifore;

- harton certifikatat përkatëse për verifikimin e llojit të mallrave, emërtimit të tyre dhe bën klasifikimin tarifor;

- administron rregullat për përcaktimin e origjinës jopreferenciale të mallrave dhe rregullat që përcaktojnë origjinën preferenciale të mallrave, sipas marrëveshjeve në fuqi, si dhe procedurat e lëshimit të certifikatave të origjinës së mallrave;

- ndjek bashkëpunimin administrativ në fushën e origjinës së mallrave dhe jep informacion të detyrueshëm të origjinës (IDO).

iii. Drejtoria e Labororit Doganor, që përbëhet nga:

- Sektori i Standardeve, Metodikave dhe Administrimit;

- Sektori i Analizave;

Kjo drejtori:

- kryen studime për metodat e teknikat për analizën kimike, teknologjike dhe merceologjike të mallrave;

- analizon mostrat e marra nga zyrat vendore;

- administron dhe mirëmban pajisjet e Labororit Doganor.

iv. Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, që përbëhet nga:

- sektori vlerës në qendër;

- sektori i vlerësimit doganor dhe i të dhënave të disponueshme.

Kjo drejtori:

- unifikon në një masë më të madhe zbatimin e metodologjisë së vlerësimit doganor;



- administron dispozitat, që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit doganor të mallrave dhe shërbimeve, thjeshtësimet e vlerës, si dhe ndjek përditësimin e kursit të këmbimit;

- mbështetur në analizën e riskut, ndërmerr kontrole dokumentare, për të verifikuar të gjithë dokumentacionin tregtar (bashkëlidhur deklarimit doganor) dhe çdo të dhënë tjetër, që lidhet me procedurat doganore të operatorëve ekonomikë. Këto kontrole bëhen nga zyrat qendrore në DPD nëpërmjet sistemit doganor;

- në bashkëpunim me degët doganore dhe strukturat e tjera të administratës doganore, mbështet zhvillimin e planifikimit strategjik lidhur me kontrollet e dedikuara për vlerësimin doganor të mallrave;

- përmirëson procedurat për vendosjen e barazisë, si dhe standardizimin e vlerësimit doganor, me synim rritjen e të ardhurave doganore dhe minimizimin e kostove;

- mbështetur në burime të miratuara, përditëson “dosjen” me të dhënat e disponueshme, si dhe sisteme apo mekanizma të tjerë, për qëllim të vlerësimit doganor të mallrave;

- përgatit dhe përditëson udhëzimet e metodikat për vlerësimin doganor të mallrave.

ç) Departamenti i Akcizës përbëhet nga drejtoritë, si më poshtë vijon:

i. Drejtoria Teknike e Akcizës, që përbëhet nga:

- Sektori i Autorizimeve;

- Sektori i Aplikacioneve.

Kjo drejtori:

- administron procedurat e aplikimeve dhe të autorizimeve për to dhe harton autorizimet për magazinat fiskale dhe depozituesit e miratuar;

- harton autorizimet/licencat për pritësit e regjistruar, dërguesit e regjistruar dhe përfaqësuesit fiskalë;

- administron procedurat e lehtësirave fiskale lidhur me përjashtimet dhe rimbursimet nga detyrimet e akcizës, si dhe harton autorizimet për përjashtimet e rimbursimit;

- administron dhe trajton përditësimet e nevojshme dhe problematikat lidhur me çështjet e klasifikimit fiskal, administron, monitoron dhe bashkërendon të gjitha procedurat e nevojshme lidhur me pullat fiskale dhe kodet e sigurisë, si dhe trajton çështje të garancive;

- përgjigjet për hedhjen e përditësimin e rregullave në sistemin informatik.

ii. Drejtoria e Kontroleve të Akcizës përbëhet nga këta sektorë:

- Sektori i Pijeve Alkoolike;

- Sektori i Duhanit dhe i Produkteve të tjera;

- Sektori i Produkteve Energetike;

- Sektori i Pajisjeve, Matësve dhe i Linjave Teknologjike.

Kjo drejtori:

- kryen mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin, sipas produkteve specifike të magazinave fiskale të prodhimit apo stokimit, kontrollon dhe monitoron lëvizjen e produkteve të akcizës nën pezullim, monitoron zbatimin e kushteve, si dhe respektimin nga operatorët e akcizës të skemës së përjashtimeve dhe rimbursimeve;

- bashkëpunon me strukturat e tjera qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sipas rastit, për trajtimin e operacioneve të parregullta;

- kryen analizime të ndryshme, lidhur me importimin, prodhimin, stokimin dhe lëvizjen e produkteve të akcizës, sipas llojit të tyre;

- harton projekte, përgatit dhe përditëson metodikat për kontrollin e magazinave fiskale/doganore, zonave të lira, depozituesit e miratuar, pritësit dhe dërguesit e regjistruar, si dhe të proceseve të ndryshme të prodhimit të mallrave të akcizës, harton dhe përditëson metodikat lidhur me matjen e produkteve dhe depozitave, rezervuarëve etj., sipas produkteve specifike;

- kontrollon, saktëson apo përditëson normativat teknike në procesin e prodhimit, kontrollon koeficientet e humbjeve dhe të firove;

- kontrollon procedurat e shënjimit fiskal dhe të ngjyimit, si dhe kontrollon pajisjet e instrumentet matëse, linjat teknologjike, depozitat, rezervuarët, kalibrimin e tyre etj.

d) Departamenti Operativ Hetimor përbëhet nga drejtoritë, si më poshtë vijon:

i. Drejtoria e Antikontrabandës, që përbëhet nga:

- Sektori i Antikontrabandës Tokësore;

- Sektori i Koordinimit dhe Operativitetit në Terren;

- Sektori i Antikontrabandës Detare.

Kjo drejtori:

- kryen kontrole fizike dhe dokumentare, në bazë të planeve operacionale, të të dhënave dhe analizës së riskut, në çdo ambient, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke



kontrolluar apo shqyrtuar mallrat, personat dhe mjetet e transportit, me qëllim zbulimin e parandalimin e kontrabandës, prodhimit dhe tregtimit të paligjshëm të mallrave të akcizës e të kundërvajtjeve administrative, brenda territorit doganor shqiptar, dhe nga/apo drejt territorit të vendeve të tjera;

- nëpërmjet kryerjes së kontrolleve, identifikon dhe jep të dhëna rreth veprimtarisë ose personave të dyshimtë për *database*-in e informacionit, jep ndihmë në hetimin e shkeljeve të rënda doganore dhe të akcizës;

- mbështet degët doganore për vjeljen e borxhit dhe rikuperimin me forcë.

ii. Drejtoria e Hetimit, që përbëhet nga:

- Sektori i Hetimit Doganor;

- Sektori i Koordinimit dhe Analizave;

Kjo drejtori:

- ndërmerr hetime referuar legjislacionit në fuqi për shkelje të dyshuara apo të vërejtura nga Drejtoria e Antikontrabandës, Drejtoria e Informacionit, si dhe nga struktura të tjera, brenda dhe jashtë sistemit doganor, me kërkesë të tyre apo me iniciativë;

- mbledh të dhëna, përgatit kallëzime penale për në organin e Prokurorisë, jep dokumentacion, harton raporte dhe praktika në ndihmë të këtij organi;

- koordinon luftën ndaj mashtrimeve fiskale, për çështjet e sigurisë, analizon, raporton e ndërmerr veprime aktive operative edhe në terren për hetimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale në fushën doganore.

iii. Drejtoria e Informacionit, që përbëhet nga:

- Sektori i Inteligjencës Operative;

- Sektori i Shkëmbimit/Përpunimit të Informacionit me Strukturat Homologe.

Kjo drejtori:

- mbledh të dhëna për shkeljet doganore apo të akcizës të dyshuara, faktike apo të mundshme;

- kryen kërkime, duke shfrytëzuar marrëveshjet e asistencës administrative, të nënshkruara me administratat doganore të vendeve të tjera;

- kryen përpunimin e informacionit për përgatitjen e raporteve inteligjente dhe cilësore, duke propozuar veprime të mëtejshme nga struktura brenda institucionit apo dhe jashtë tij;

- përpunon informacionin e grumbulluar nga burime të ndryshme dhe analizon të dhënat për veprimtaritë ose personat e dyshimtë, si dhe

furnizon, periodikisht, me produkte inteligjence, drejtorin e Përgjithshëm të Doganave.

iv. Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, që përbëhet nga:

- Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut;

- Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore.

Kjo drejtori:

- siguron bashkërendimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin 24-orësh të mjedisëve dhe punës në terren në degët doganore të veprimtarisë së strukturave të Departamentit Operativ Hetimor;

- menaxhon mbledhjen e të dhënave për shkeljet doganore të dyshuara, faktike apo të mundshme, përgatitjen, monitorimin e analizën e riskut, me qëllim rritjen e eficiencës së kontrolleve doganore dhe ushtrimin e kontrolleve me bazë indikatorët e riskut;

- bashkëpunon me strukturat e tjera doganore dhe me institucione të tjera, në ushtrimin e funksioneve që kryen;

- administron dispozitat, që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit doganor të mallrave e të shërbimeve;

- përgatit e administron udhëzimet dhe urdhrat, që kanë të bëjnë me metodologjinë e vlerësimit për qëllime doganore, si dhe sisteme apo mekanizma të tjerë për vlerësimin doganor të mallrave;

- në bashkëpunim me degët doganore dhe strukturat e tjera të administratës doganore, kjo drejtori mbështet zhvillimin e planifikimit strategjik lidhur me kontrollet e dedikuara për vlerësimin doganor të mallrave.

v. Drejtoria Antitrafik, që përbëhet nga:

- Sektori i Kontrollit të Deklarimeve *cash*;

- Sektori i Mallrave të Rrezikshme *dual use*, Trafiqueve të Paligjshme;

- Sektori Operativ Antitrafik dhe Njësia e Informacionit të Pasagjerit;

- Koordinatorin për Skanimet.

Kjo drejtori ka si objekt të veprimtarisë së saj zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, veçanërisht në funksion të përmbushjes së misionit mbrojtës për sigurinë kombëtare dhe rendin publik.

Veprimtaria e Drejtorisë Antitrafik lidhet me organizimin e mbikëqyrjes së kufirit shtetëror nga strukturat e shërbimit doganor që operojnë në kufi, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve të mallrave, të mjeteve të transportit dhe të subjekteve, për parandalimin e trafiqueve të paligjshme, përfshirë parandalimin e pastrimit të parave, kontrollit të



transferimit fizik të valutës, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

Drejtoria Antitrafik mund të shkëmbejë të dhëna me struktura të tjera doganore apo shtetërore, me kompetenca në fushën e zbatimit të ligjit, për mallra, mjete apo subjekte, me qëllim parandalimin dhe goditjen e shkeljeve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi kundër trafikëve.

Ajo bashkëpunon me agjenci, institucione dhe aktorë të tjerë, përfshirë ata ndërkombëtarë, të cilët kanë detyrime ligjore ose që janë të angazhuar në luftën kundër trafikëve dhe zbatimin e masave ndaluese, kufizuese.

Njësia e informacionit paraprak të pasagjerit realizon koordinimin e veprimeve të strukturave policore në nivel qendror, transmetimin e pandërprerë të informacionit, drejtimin e veprimeve policore për parandalimin e imigracionit të parregullt, përmirësimin e kontrollit kufitar, parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, në përputhje me legjislacionin specifik, si dhe bazuar në Kodin Doganor.

vi. Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale

Kjo drejtori ka për detyrë administrimin e procedurave për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (pronësinë industriale dhe pronësinë intelektuale) për mallrat që hyjnë ose dalin nga territori shqiptar, me kërkesë të mbajtësve të së drejtës ose me iniciativë dhe administrimin e kërkesave për veprim në kuadër të mbrojtjes së pronësisë intelektuale.

vii. Drejtoria e Kontrollit pas Zhdoganimit/Aposterior, që përbëhet nga:

- Sektori i Kontrollit të Tarifës, Origjinës dhe Vlerës;

- Sektori i Kontrollit të Regjimeve Doganore.

Kjo drejtori:

- ndërmerr kontrole dokumentare apo fizike, në nivel subjekti, pas çlirimit të mallrave, për të verifikuar të gjithë dokumentacionin tregtar dhe çdo të dhënë tjetër, që lidhet me veprimet doganore të operatorëve ekonomikë dhe veprimet e mëtejshme tregtare, që kanë të bëjnë me këto mallra. Këto kontrole bëhen pranë mjediseve të operatorëve ekonomikë, që kanë lidhje të drejtpërdrejta ose të tërthortë me veprimet doganore, si dhe përmes rishqyrtimit të praktikave doganore, brenda sistemit doganor;

- përgatit paraprakisht strategjinë dhe planin e kontroleve pas zhdoganimit në degë doganore ose pranë operatorëve ekonomikë, në lidhje me regjimet e magazinimit doganor, përpunimit aktiv, përpunimin nën kontrollin doganor, lejimin e përkohshëm, regjimet e përpunimit pasiv në bazë të analizave dhe të dhënave konkrete;

- kryen analizime të ndryshme, përfshirë hartimin e metodikave dhe/ose programimin e kontroleve lidhur me importin apo eksportin e mallrave dhe regjimet e posaçme, sipas llojit të tyre;

- në bashkëpunim me degët doganore dhe strukturat e tjera të administratës doganore, kjo drejtori mbikëqyr zbatimin e metodologjisë së kontrollit dhe të vlerësimit doganor të mallrave;

- bazuar në analizën e riskut apo me kërkesë të operatorëve ekonomikë, ndërmerr rishikimin dhe verifikimin e saktësisë së të dhënave të deklaratës doganore, si dhe përpunon e analizon, përmes teknikave të menaxhimit, të dhënat e siguruar nga strukturat e tjera të administratës doganore dhe administratave homologe.

dh) Degët doganore

i. Degët doganore janë të vendosura në: Shkodër, Lezhë (Shëngjin), Kukës (Morinë), Aeroportin e Kukësit, Peshkopi (Bladë), Tiranë (Vorë), Krujë (Rinas), Durrës, Elbasan, Pogradec (Qafëthanë), Korçë, Kapshticë (Devoll), Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë (Kakavijë), Sarandë (Qafëbotë) dhe Përmet (Tri Urat).

Degët doganore përbëhen nga një ose disa zyra doganore sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Drejtori i përgjithshëm i Doganave, me udhëzim, përcakton mbulimin territorial të degëve doganore.

Degët doganore mund të organizohen në varësi të funksioneve që kryejnë dhe të vëllimit të punës, në këta sektorë/zyra:

- Sektori/zyra i/e operacioneve doganore

Kjo strukturë mbulon kryesisht detyrat funksionale lidhur me operacionet doganore, si dhe kontrollet dokumentare dhe/ose fizike, kontrollin në pikat e hyrje-daljeve, kontrole lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen etj.

- Zyra e mbikëqyrjes doganore

Kjo zyrë mbulon kryesisht detyrat funksionale lidhur me kontrollet pas zhdoganimit (aposterior), aplikimet, regjimet, akcizën, origjinën, përjashtimet etj.



- Zyra e kontrollit dhe sigurisë, e cila mbulon kryesisht detyrat funksionale lidhur me kontrollet në pikat e hyrje-daljeve, kontrole lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen etj.

- Zyra e administratës dhe shërbimit

Kjo strukturë mbulon kryesisht detyrat funksionale lidhur me analizën e riskut, çështjet gjyqësore, vendimet, borxhin, financën, kontabilitetin, sekretarinë, arkivin, magazinën, mirëmbajtjen etj.

- Zyra të tjera doganore, të cilat kryejnë detyra të ndryshme sipas specifikave përkatëse.

ii. Degët doganore kanë si detyra kryesore:

- zbatimin e legjislacionit doganor e të akcizës, legjislacionin lidhur me ndalimet dhe kufizimet, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që kanë të bëjnë me veprimtarinë doganore, procedurat e kontrollit dhe të mbikëqyrjes;

- vjeljen e detyrimeve që duhen paguar në doganë;

- parandalimin, konstatimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm;

- parandalimin, konstatimin, verifikimin e kundërvajtjeve të parashikuara nga legjislacioni doganor dhe i akcizës;

- mbikëqyrjen dhe kontrollin në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave, që u nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve doganore;

- mbrojtjen e interesave fiskalë, të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe çdo mbrojtje tjetër të ngarkuar, sipas legjislacionit në fuqi dhe misionit të administratës doganore.”.

II. Aneksi nr. 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave marrin të gjitha masat dhe kryejnë të gjitha procedurat për plotësimin e vendeve të punës, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

IV. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

ANEKSI nr. 1					
Emërtimi i postit		Funksioni	Kategoria	Numri i punonjësve	Kategoria e pagës
Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm		Drejtor i përgjithshëm	II-a	1	II-a
		Koordinator rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit	II-b	1	II-b
		Drejtor kabinetit	A	1	III-a
		Këshilltar	A	4	III-a
		Përpunues Informacioni	C3	1	
Totali Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm				8	
Drejtoritë në varësi të drejtorit të përgjithshëm					
Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Spektori i Koordinimeve dhe Projekteve	Specialist	C1	2	III-b
	Spektori i Integritetit Evropian	Specialist	C1	3	III-b
Totali drejtorisë				6	
Drejtoria Auditit të Brendshëm		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Auditues	C1	7	III-b
Totali Drejtorisë				8	
Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Specialist	C1	4	III-b
Totali Drejtorisë				5	
Drejtoria e Buxhetit		Drejtor drejtorie	A	1	III-a



dhe e Financës	Sektori Planifikim-Monitorim Buxheti	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori Financë/ Kontabilitetit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
		Magaznier	D1	2	
	Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
Specialist		C1	6	III-b	
Totali Drejtorisë				16	
Drejtoria e Statistikës, Analizës së të Ardhurave dhe Administrimit të Borxhit	Sektori i Statistikës dhe Analizës së të Ardhurave	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Specialist	C1	3	III-b	
	Sektori i Monitorimit të Borxhit dhe Ndërveprimit me Tatimet	Përgjegjës SEKTORI	B	1	III-a/1
Specialist		C1	2	III-b	
Totali Drejtorisë				8	
Totali i zyrës dhe drejtorive në varësi të drejtorit të përgjithshëm				51	
Departamenti Administrativ					
Departamenti Administrativ		Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Përpunues informacioni	C3	1	
TOTALI				2	
Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Specialist	C1	4	III-b	
	Sektori i Trajnimeve dhe Etikës	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Zyra e Sekretarit/Protokollit dhe Arkivit	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
Sekretar/protokolli		C3	2		
Arkivist		C3	2		
Totali i Drejtorisë				14	
Drejtoria e Burimeve Mbështetëse	Sektori i Investimeve & Logjistikës	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
		Teknik mirëmbajtjeje	D1	1	
		Teknik Mirëmbajtje (oficina)	D1	2	
		Shofer	D1	8	
	Sektori i Prokurimit	Përgjegjës Sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk)	Përgjegjës Sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	5	III-b
Totali Drejtorisë				30	
Drejtoria Juridike	Sektori i Legjislacionit dhe Përafrimit me BE-në	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përpunues informacioni	C3	1	
	Sektori i Ankimit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i Ankimit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	9	III-b
Totali Drejtorisë				17	
Totali Departamenti Administrativ				63	
Departamenti Teknik					
Departamenti Teknik		Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Përpunues informacioni	C3	1	
Totali				2	



Drejtoria e Procedurave Doganore		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori Procedurave dhe Regjimeve Doganore	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i Lehtësirave Doganore	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	3	III-b
Totali i Drejtorisë				10	
Drejtoria e Tarifës dhe Originës		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori i Tarifës dhe Klasifikimit Tarifor	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	7	III-b
	Sektori i Originës	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
Totali Drejtorisë				14	
Drejtoria e Laboratorit Doganor		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Administratë	Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1	
		Magaziniër	D1	1	
		Përpunues informacioni	C3	1	
	Sektori Standardeve, Metodikave dhe Administrimit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori Analizave	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	6	III-b
		Asistentë	C2	6	IV-a
Totali i Drejtorisë				20	
Drejtoria e Vlerësimit në Qendër		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori Vlerës në Qendër	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Përgjegjës turni	C1	3	III-b
		Doganier	C2	30	IV-a
	Sektori i Vlerësimit Doganor dhe të Dhënave të Disponueshme	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
Specialist		C1	4	III-b	
Totali Drejtorisë				40	
Totali Departamenti Teknik				86	
Departamenti i Akcizës					
Departamenti i Akcizës		Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Përpunues Informacioni	C3	1	
Totali				2	
Drejtoria e Kontrollleve të Akcizës		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori i Pijeve Alkoolike	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i Produkteve Energjetike	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
		Specialist GFI	C2	4	IV-a
	Sektori i Duhanit dhe Produkteve të Tjera	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i Pajisjeve, Matësve dhe Linjave Teknologjike	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
Specialist		C1	4	III-b	
Totali Drejtorisë				25	
Drejtoria Teknike e Akcizës		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
	Sektori i Aplikacioneve	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	3	III-b
	Sektori i Autorizimeve	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
Specialist		C1	2	III-b	
Totali Drejtorisë				8	
Totali Departamenti i Akcizës				35	



Departamenti Operativ Hetimor					
Departamenti Operativ Hetimor		Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	II-b	1	II-b
		Përpunues informacioni	C3	1	
Totali				2	
Drejtoria Antikontrabandës	Sektori i Antikontrabandës Tokësore	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përpunues informacioni	C3	1	
		Komandante grupi	C1	18	III-b
		Inspektor antikontrabande	C2	28	IV-a
		Doganier pike kontrolli	C3	8	
	Sektori i Koordinimit dhe Operativitetit në Terren	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori i Antikontrabandës Detare	Komandant grupi	C1	4	III-b
		Specialist inxhinier	C1	1	III-b
		Specialist i Qendrës Ndërinstitucionale operacionale Detare	C1	6	III-b
		Inspektor antikontrabande	C2	8	IV-a
		Magaznier	D1	1	
		Teknik marine/motorist	D1	4	
Totali Drejtorisë				83	
Drejtoria Antitrafik	Sektori i Kontrollit të Deklarimeve CASH	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b
	Sektori i Mallrave të Rrezikshme, Dual Use, Trafiqueve të Paligjshme	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	3	III-b
	Sektori Operativ Antitrafik	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Komandant grupi	C1	2	III-b
		Inspektor	C2	4	IV-a
Njësia e Pasagjerit	Specialist	C1	4	III-b	
Koordinator për Skanimet		C1	1	III-b	
Totali Drejtorisë				20	
Drejtoria e Hetimit		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përpunues informacioni	C3	1	
	Sektori i Hetimit Doganor	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Specialist me attribute të oficerit të policisë gjyqësore	C1	17	III-b
	Sektori i Koordinimit dhe Analizave	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
Specialist		C1	3	III-b	
Totali Drejtorisë				24	
Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intellektuale		Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Specialist	C1	4	III-b
Totali Drejtorisë				5	
Drejtoria e Kontrollit Paszhdoganimit (Aposterior)	Sektori i Kontrollit të Tarifës, Originës dhe Vlerës	Drejtor drejtorie	A	1	III-a
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Sektori i Kontrollit të Regjimeve Doganore	Specialist	C1	5	III-b
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	Specialist	C1	5	III-b	



		Totali Drejtorisë		13		
Drejtoria e Informacionit		Drejtor Drejtorie	A	1	III-a	
		Përfaqësues në SECI	A	1	III-a	
	Sektori i Inteligjencës Operative	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
		Specialist	C1	10	III-b	
	Sektori i Shkëmbimit/ Përpunimit të Informacionit me strukturat homologe	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
Specialist		C1	7	III-b		
Totali Drejtorisë				21		
Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit	Sektori Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
		Specialist	C1	3	III-b	
	Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
		Specialist monitorimi	C1	12	III-b	
		Specialist analize risku	C1	8	III-b	
Totali Drejtorisë				26		
Totali i Departamentit Operativ Hetimor				194		
TOTALI, DREJTORIA E PËRGJITHSHME				429		
Dega Doganore Shkodër		Kryetar Dogane	A	1	III-a	
		Specialit aposterior/analizë risku	C1	1	III-b	
	Zyra e Administratës	Specialist/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
		Financier	C1	1	III-b	
		Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1		
		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Sektori i Operacioneve Doganore	Zyra Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës, Zyra e Mbikëqyrjes	C1	1	III-b
			Doganier	C2	4	IV-a
		Zyra Doganore Shkodër	Përgjegjës zyre/turni Shkodër	C1	1	III-b
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	1	
			Doganier	C2	2	IV-a
		Zyra Doganore Hani Hotit	Përgjegjës Zyre, Hani Hotit	C1	3	III-b
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
			Doganier	C2	6	IV-a
		Zyra Doganore Bajze/Tuz	Përgjegjës Zyre, Bajze/Tuz	C1	1	III-b
			Doganier	C2	4	IV-a
	Zyra Doganore Murriqan	Përgjegjës Zyre (Murriqan)	C1	1	III-b	
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3		
		Doganier	C2	6	IV-a	
	Zyra Doganore Vermosh	Përgjegjës Zyre (Vermosh)	C1	1	III-b	
		Doganier	C2	2	IV-a	
	Zyra Doganore Grabon	Përgjegjës Zyre, Grabon	C1	1	III-b	
		Doganier	C2	2	IV-a	
Totali i Degës Doganore Shkodër				48		
Dega Doganore Lezhë		Kryetar dogane	B	1	III-a/1	
		Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b	
	Zyra e Administratës	Specialist/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
		Financier	C1	1	III-b	
		Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1		
		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	2		
		Doganier	C2	2	IV-a	
		Doganier	C2	2	IV-a	
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	



		Doganier	C2	2	IV-a	
Totali i Degës Doganore Lezhë				15		
Doga Doganore Blladë (Peshkopi)		Kryetar dogane	B	1	III-a/1	
		Specialist analizë rishikimi/aposterior/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
	Zyra e Administratës	Financier	C1	1	III-b	
		Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1		
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3		
		Doganier	C2	3	IV-a	
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
Doganier		C2	2	IV-a		
Totali i Degës Doganore Blladë (Peshkopi)				14		
Dogana Doganore Kukës (Morinë)	Zyra e Administratës	Kryetar dogane	A	1	III -a	
		Specialist analizë rishikimi/aposterior	C1	1	III-b	
		Financier	C1	1	III-b	
		Specialist/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
		Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1		
	Sektori Operacioneve Doganore	Zyra Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës, Sektori Operacioneve Doganore	B	1	III-a/1
			Përgjegjës i Zyres së Mbikëqyrjes	C1	1	III-b
			Doganier	C2	2	IV-a
		Zyra Doganore Morine	Përgjegjës Zyre, Morine	C1	3	III-b
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	6	
			Doganier	C2	9	IV-a
		Zyra e Skanerit	Përgjegjës Zyre	C1	0	III-b
			Doganier	C2	3	IV-a
		Zyra Doganore Qafe Prush	Përgjegjës Zyre Qafëprush	C1	1	III-b
			Doganier	C2	3	IV-a
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	2	
		Zyra Doganore Shishtavec	Përgjegjës Zyre, Shishtavec	C1	1	III-b
	Doganier		C2	2	IV-a	
	Doganier peshoreje/pike kontrolli		C3	2		
	Zyra Doganore Qafe Morine Tropoje	Përgjegjës Zyre Qafëmorinë Tropojë	C1	1	III-b	
		Doganier	C2	3	IV-a	
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	2		
	Totali i Degës Doganore Kukës (Morinë)				47	
Aeroporti i Kukësit		Kryetar Dogane	B	1	III-a/1	
		Specialist analizë rishikimi/aposterior/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
	Zyra e Administratës	Financier	C1	1	III-b	
		Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1		
	Zyra Operacional/ Terminal	Përgjegjës turni	C1	3	III-b	
		Doganier	C2	12	IV-a	
	Zyra e Operacioneve Doganore/ Cargo	Përgjegjës zyre/turni	C1	1	III-b	
Doganier		C2	3	IV-a		
Totali Aeroporti i Kukësit				23		
Dega Doganore Tiranë		Kryetar Dogane	A	1	III-a	
		Specialist aposterior/analizë rishikimi	C1	2	III-b	
		Specialist borxhi	C1	2	III-b	
		Specialist jurist	C1	2	III-b	
	Zyra e Administratës dhe Shërbimit	Financier	C1	1	III-b	
		Specialist i nivelit të dytë	C2	1	IV-a	



			Sekretar	C3	1		
			Arkivist	C3	2		
			Magaziniere	D1	1		
Sektori i Operacioneve Doganore			Përgjegjës Sektori	B	1	III-a/1	
	Zyra e Akcizës Doganore		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
			Doganier akcize	C2	8	IV-a	
	Zyra Regjimeve Doganore	e	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
			Doganier Regjimesh	C2	9	IV-a	
	Zyra e pikës së hyrjes-daljes		Përgjegjës zyre peshoreje/pikë kontrolli	C1	1	III-b	
			Doganier peshoreje/pikë kontrolli	C3	8		
	Zyra Operacioneve Doganore	e	Përgjegjës zyrë operacionet doganore	C1	1	III-b	
			Doganier	C2	12	IV-a	
	Zyra Magazinit të Përkohshëm	e	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
		Doganier	C2	2	IV-a		
Totali i Degës Doganore Tiranë					58		
Dega Doganore Durrës			Kryetar Dogane	A	1	III-a	
			Specialist posterior/analizë risku	C1	3	III-b	
	Zyra e Administratës			Specialist/borxhi	C1	2	III-b
				Specialist/jurist	C1	3	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Specialist i nivelit të dytë	C2	1	IV-a
				Sekretar	C3	1	
				Arkivist	C3	2	
				Magaziniere	D1	1	
		Sektori i Operacioneve Doganore	Zyra e kontrollit		Përgjegjës, Sektori Operacione Doganore	B	1
				Përgjegjës Zyre i Pikës së Kontrollit	C1	2	III-b
				Doganier	C2	6	IV-a
				Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	10	
	Zyra e Eksporteve			Përgjegjës i Zyrës së Eksporteve	C1	2	III-b
				Doganier	C2	8	IV-a
	Zyra e Skanerit			Përgjegjës i Zyrës së Skanerit	C1	1	III-b
				Doganier	C2	2	IV-a
	Zyra e Terminalit të pasagjereve			Përgjegjës i Zyre së Terminalit të Pasagjereve	C1	1	III-b
				Doganier	C2	2	IV-a
				Përgjegjës Zyre, Terminali i Trageteve	C1	2	III-b
	Terminali i Trageteve			Doganier	C2	10	IV-a
				Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	2	
				Përgjegjës i Zyrës së Përpunimit të Anijeve	C1	1	III-b
	Përpunimi i Anijeve			Doganier	C2	8	IV-a
			Përgjegjës i Zyrës së Terminalit të Kontejnerëve	C1	2	III-b	
			Doganier	C2	6	IV-a	
	Terminali i Kontejnerëve		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	4		
		Zyra kundër trafiqeve (Task Force)		Përgjegjës i Zyrës kundër Trafiqeve (Task Force)	C1	0	III-b
				Doganier	C2	2	IV-a
	Zyra e Akcizës Doganore		Përgjegjës i Zyrës së Akcizës	C1	1	III-b	
			Doganier akcize	C2	4	IV-a	
	Zyra e Regjimeve Doganore		Përgjegjës i Zyrës së Regjimeve	C1	1	III-b	
			Doganier regjimesh	C2	10	IV-a	
Sektori			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	



	Doganor Porto-Romano	Zyra Doganore Hidrokarburet	Përgjegjës zyre/turni	C1	2	III-b	
			Doganier	C2	18	IV-a	
		Zyra Doganore MBM	Përgjegjës zyre/turni	C1	2	III-b	
			Doganier	C2	8	IV-a	
Totali i Degës Doganore Durrës					134		
Dega Doganore Rinas			Kryetar dogane	A	1	III-a	
			Specialist/analize risku/aposterior	C1	1	III-b	
			Specialist/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
	Zyra Administratës ^e		Financier	C1	1	III-b	
			Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1		
	Sektori Operacional/Terminal		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Përgjegjës turni	C1	3	III-b	
			Doganier	C2	29	IV-a	
Zyra Doganore/Cargo		Përgjegjës zyre/turni	C1	1	III-b		
		Doganier	C2	6	IV-a		
Totali i Degës Doganore Rinas					45		
Dega Doganore Elbasan			Kryetar Dogane	B	1	III-a/1	
			Specialist /analizë risku/aposterior	C1	1	III-b	
	Zyra e Administratës		Specialist/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
			Financier	C1	1	III-b	
			Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
			Doganier	C2	3	IV-a	
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
			Doganier	C2	4	IV-a	
	Zyra Doganore RBH		Përgjegjës turni	C1	1	III-b	
			Doganier	C2	6	IV-a	
	Totali i Degës Doganore Elbasan					24	
Dega Doganore Qafë Thanë			Kryetar dogane	B	1	III-a/1	
			Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b	
	Zyra e Administratës		Specialist /jurist borxhi	C1	1	III-b	
			Financier	C1	1	III-b	
			Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore		Përgjegjës turni /përgjegjës pike	C1	3	III-b
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	6		
			Doganier	C2	9	IV-a	
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
			Doganier	C2	3	IV-a	
	Zyra e Skanerit		Doganier	C2	3	IV-a	
	Zyra Doganore Tushemisht		Përgjegjës turni/ zyre	C1	1	III-b	
			Doganier	C2	3	IV-a	
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3			
Totali i Degës Doganore Qafëthanë					37		
Dega Doganore Korçë			Kryetar Dogane	B	1	III-a/1	
			Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b	
			Specialist /jurist borxhi	C1	1	III-b	
			Financier	C1	1	III-b	
			Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3		
			Doganier	C2	2	IV-a	
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	



		Doganier	C2	3	IV-a
	Zyra Doganore Goricë	Përgjegjës turni/ zyre	C1	1	III-b
		Doganier	C2	3	IV-a
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
Totali i Degës Doganore Korçë				22	
Dega Doganore Kapshticë		Kryetar dogane	B	1	III-a/1
		specialist/analizë risku/aposterior	c1	1	III-b
	Zyra Administratës	Specialist/jurist/borxhi	C1	1	III-b
		Financier	C1	1	III-b
		Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës turni /zyre	C1	3	III-b
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	6	
		Doganier	C2	6	IV-a
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier	C2	4	IV-a
Zyra e Skanerit	Doganier	C2	3	IV-a	
Totali i Degës Doganore Kapshticë				28	
Dega Doganore Vlorë		Kryetar dogane	B	1	III-a/1
		Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
	Zyra e Administratës	Specialist /jurist borxhi	C1	1	III-b
		Financier	C1	1	III-b
		Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
		Doganier	C2	6	IV-a
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier	C2	4	IV-a
	Zyre Doganore Himarë	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier	C2	1	IV-a
Zyra Doganore e Terminalit Bregdetar për Depozitim të Naftës dhe Nënprodukteve në Gjirin e Vlorës	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
	Doganier	C2	2	IV-a	
	Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3		
Totali i Degës Doganore Vlorë				28	
Dega Doganore Fier		Kryetar dogane	B	1	III-a/1
		Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
	Zyra e Administratës	Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
		Financier	C1	1	III-b
		Magazinier	D1	1	
		Sekretar/arkivist	C3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
		Doganier	C2	3	IV-a
Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
	Doganier	C2	16	IV-a	
	Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3		
Totali i Degës Doganore Fier				33	
Dega Doganore Berat		Kryetar dogane	B	1	III-a/1
		Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
	Zyra e Administratës	Specialist/jurist/borxhi	C1	1	III-b
		Financier	C1	1	III-b
		Sekretar/arkivist/magazinier	C3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	



		Doganier	C2	3	IV-a
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës Zyre	C1	1	III-b
		Doganier	C2	3	IV-a
Totali i Degës Doganore Berat				16	
Dega Doganore Kakavijë (Gjirokastrë)		Kryetar dogane	A	1	III-a
		Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
	Zyra e Administratës	Specialist/jurist borxhi	C1	1	III-b
		Financier	C1	1	III-b
		Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës turni	C1	3	III-b
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	6	
		Doganier	C2	12	IV-a
	Zyra e Skanerit	Doganier	C2	3	IV-a
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës turni /zyre	C1	1	III-b
Doganier		C2	2	IV-a	
Zyra Doganore Sopike	Doganier	C2	0	IV-a	
	Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	0		
Totali i Degës Doganore Kakavijë (Gjirokastrë)				32	
Dega Doganore Sarandë		Kryetar dogane	B	1	III-a/1
		Specialist/analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
	Zyra e Administratës	Specialist /jurist borxhi	C1	1	III-b
		Financier	C1	1	III-b
		Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
		Doganier	C2	3	IV-a
	Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier	C2	3	IV-a
		Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
	Zyra Doganore Qafëbotë	Përgjegjës turni/zyre	C1	3	III-b
Doganier		C2	6	IV-a	
Doganier peshoreje/pike kontrolli		C3	3		
Totali i Degës Doganore Sarandë				28	
Dega Doganore Tri Urat (Përmet)		Kryetar dogane	B	1	III-a/1
		Specialist/analize risku/aposterior	C1	1	III-b
	Zyra e Administratës	Financier	C1	1	III-b
		Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1	
		Përgjegjës turni	C1	1	III-b
	Zyra e Operacioneve Doganore	Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	2	
		Doganier	C2	3	IV-a
		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
Zyra e Mbikëqyrjes Doganore	Doganier	C2	2	IV-a	
Totali i Degës Doganore Tri Urat Përmet				13	
Totali i DPD				429	
Totali i Degëve Doganore				645	
Totali i Administratës Doganore				1074	



VENDIM
Nr. 356, datë 26.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZATAVE
TË PUNËDHËNËSVE DHE TË
ORGANIZATAVE SINDIKALE NË
KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat e punëdhënësve dhe organizatat sindikale, anëtarë të Këshillit Kombëtar të Punës, janë si më poshtë vijon:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

a) Bashkimi i Bizneseve Shqiptare (BIZNES ALBANIA): 1 anëtar, 1 kandidat;

b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB): 1 anëtar, 1 kandidat;

c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT): 1 anëtar, 1 kandidat;

d) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS): 1 anëtar, 1 kandidat;

dh) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Shoqata “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë” (SHBPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

f) Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve/Këpucëve - Proeksport Albania (DHKPVPA): 1 anëtar, 1 kandidat;

g) Shoqata e Bukës Pastërisë dhe Brumërave (SHBPB): 1 anëtar, 1 kandidat.

B. Për organizatat sindikale:

a) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

b) Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Ndërtimit dhe Shërbimeve Publike të Shqipërisë (SPPNSHPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

d) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

dh) Federata e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FPISH): 1 anëtar, 1 kandidat;

e) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (FSPSHSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Tekstileve, Konfeksioneve dhe Shërbimeve të Artizanatit të Shqipërisë (FSPTKSHASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

f) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimeve Financiare, Tregtare, Bankare dhe Turizmit (FSPSHFTBTSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

g) Sindikata Autonome e Ushqimit, Agrikulturës, Tregtisë dhe Turizmit (SAUATT): 1 anëtar, 1 kandidat.

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri përgjegjës për punën, sipas propozimeve të organizatave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 129, datë 7.3.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 357, datë 26.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË RREGULLAVE TË
TRANSFERIMIT TË TË DREJTAVE
MINERARE NGA ZOTËRUESI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. KRITERET PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE MINERARE

1. Lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, janë të transferueshme pas një periudhe 5-vjeçare nga data e dhënies së lejes dhe me miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.

2. Lejet e tjera minerare, të dhëna sipas procedurave të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994, “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.

3. Kriteret, që duhet të përmbushin personat juridikë, të cilëve do t’u transferohet leja minerare, janë:

a) Ligjore:

i. të jetë një person juridik, vendas ose i huaj, i regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

ii. të pranojë sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, së bashku me transferimin e lejes minerare, përgjegjësinë për të gjitha detyrimet kundrejt shtetit apo palëve të treta, të cilat rrjedhin nga leja minerare që transferohet;

iii. të dyja subjektet, zotëruesi i lejes minerare dhe përfituesi i saj, të pranojnë sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim se ndërtimet dhe instalimet e tjera, që mbështesin operacionet kryesore të veprimtarisë minerare, vlerësohen veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës minerare dhe transferohen bashkë me të;

b) Financiare:

Të kenë aftësi financiare për vazhdimin e realizimit të investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare, në përputhje me parashikimet e nënndarjes “i”, të shkronjës “dh”, të pikës 6, të këtij kreu;

c) Teknike dhe profesionale:

Të kenë aftësi teknike dhe profesionale për realizimin e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare dhe projektit të rehabilitimit të mjedisit, në përputhje me parashikimet e shkronjave “e”, “p”, “g”, të pikës 6, të këtij kreu.

4. Zotëruesi i lejes minerare paraqet në Qendrën Kombëtare të Biznes (QKB) dokumentacionin e plotë për transferimin e lejes minerare. QKB-ja, pas verifikimit të dokumentacionit, e përcjell atë pranë ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.

5. Dokumentet për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të transferimit, që duhet të plotësojnë kërkuarit për transferimin e një lejeje minerare, janë, si më poshtë vijon:

a) kërkesa në QKB për transferimin e lejes minerare nga zotëruesi i lejes minerare, ku të jetë përcaktuar arsyeja/arsyet e transferimit;

b) vendimi i asamblesë së ortakëve/asamblesë së përgjithshme të shoqërisë zotëruese të lejes minerare për transferimin e lejes minerare;

c) vendimi për marrjen e lejes i asamblesë së ortakëve/asamblesë së përgjithshme të shoqërisë që kërkon t’i transferohet leja minerare;

ç) aktmarrëveshja e nënshkruar përpara noterit ndërmjet dy shoqërive për transferimin e lejes minerare, ku të jetë përcaktuar që subjekti, i cili kërkon t’i transferohet leja minerare, pranon, së bashku me transferimin e lejes minerare, përgjegjësinë për të gjitha detyrimet kundrejt shtetit apo palëve të treta, të cilat rrjedhin nga leja minerare që transferohet, si dhe detyrimet, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

6. Dokumentet e subjektit, që kërkon t’i transferohet leja minerare, janë, si më poshtë vijon:

a) vërtetimi se subjekti ka statusin aktiv;

b) vërtetimi se subjekti nuk është i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë dhe nuk është në ndjekje penale;

c) ekstrakti nga QKB-ja për regjistrimin si person juridik, në objektin e të cilit të jetë përfshirë edhe zhvillimi i veprimtarisë minerare;

ç) vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe ka plotësuar detyrimet fiskale;

d) vërtetimi se subjekti ka paguar detyrimet për energjinë elektrike, të lëshuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

dh) konfirmimi për burimet financiare të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare, të vërtetuar nga dokumentet e mëposhtme:

i. kopja e pasqyrave financiare të dy viteve të fundit, e certifikuar nga administrata tatimore;

ii. vërtetimi nga banka që konfirmon se personi juridik ka të depozituar në numrin e llogarisë të paktën 20% të vlerës së investimit të parashikuar



për t'u realizuar në programin e investimeve. Vërtetimi duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të dokumenteve;

iii. në rastet kur shoqëria ka paraqitur një dokument noterial me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit, ky dokument duhet të shoqërohet me dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit, të përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “dh”, të kësaj pike;

e) vërtetime mbi përvojën në fushën minerare apo referenca për përmbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngjashme, të lëshuara nga një ent publik ose privat, që tregon vlerën, kohën dhe natyrën e punimeve të ekzekutuara, dhe/ose çfarëdolloj dokumenti tjetër që parashikon legjislacioni minerar në fuqi. Në rast se subjekti nuk ka përvojë në fushën minerare, atëherë ai duhet të paraqesë një dokument noterial (marrëveshje bashkëpunimi) në të cilin shprehet vullneti për mbështetje teknike nga një subjekt me përvojë në fushën minerare. Subjekti mbështetës duhet të vërtetojë eksperiencën e tij në fushën minerare me dokumentacionin e parashikuar në këtë vendim;

ë) historiku i aktivitetit të shoqërisë;

f) kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit, si: *curriculum vitae*, diploma, leje profesionale apo dokumente të tjera të ngjashme;

g) certifikata profesionale e drejtuesit teknik dhe kontrata me drejtuesin teknik;

gj) vetëdeklarimi mbi punonjësit dhe stafin drejtues të shoqërisë;

h) lista e mjeteve, e shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj tyre (pronësi, qira, përdorim apo çdolloj tjetër posedimi).

7. Dokumentet e zotëruesit të lejes minerare janë, si më poshtë vijon:

a) vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe ka plotësuar detyrimet fiskale;

b) miratimi nga strukturat përgjegjëse për kapacitetet e prodhimit vjetor, vlerën e investimeve, vlerat e garancive, të përcaktuara në nenin 31, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. RREGULLAT PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE MINERARE NGA ZOTËRUESI

1. Vlerësimi i kushteve të transferimit dhe dokumentet vërtetuese për kërkesat për transferimin e një lejeje minerare realizohen nga drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, në bazë të dokumentacionit të përcjellë nga QKB-ja. Kjo drejtori harton aktin e transferimit ose refuzimit të lejes minerare, që miratohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.

2. Ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare, brenda një afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së dokumentacionit, nënshkruan aktin e miratimit ose refuzimit të transferimit të lejes minerare, të cilin e dërgon në QKB. Në rastin e refuzimit, subjektet e interesuara kanë të drejtën e ankimit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Akti i transferimit depozitohet pranë strukturës përgjegjëse dhe transferimi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave/Autorizimeve dhe Lejeve, duke e plotësuar me të dhënat e identifikimit të zotëruesit të ri. Data e transferimit është data e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave/Autorizimeve dhe Lejeve. Akti i transferimit regjistrohet edhe në regjistrin minerar nga strukturat përgjegjëse.

4. Të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në transferimin e lejes minerare informohen për miratimin ose jo të kërkesës nga QKB-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i aktit të transferimit.

IV. TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 362, datë 29.4.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 361, datë 26.5.2022

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI
“SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS
‘FUAT TOPTANI’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Sistemim-asfaltim i rrugës ‘Fuat Toptani’”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 65 798 622 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 65 798 622 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekë dhe përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, pasqyron në kartelat e pasurive të paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit për interes publik të pasurive, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit. Regjistrimi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë të kryhet pas aplikimit nga bashkia për shërbimin përkatës.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA PËRFUNDIMTARE

E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “SISTEMIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS ‘FUAT TOPTANI’”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim				Shënime (kufizime hipotekore barrë mbi pasurinë etj.)
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Truall (m ²)	Vol.	Faqe	Truall			Vlera totale (lekë)	
												Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q
1	Ylli	Zylyftar	Bylo	Tiranë	8190	13/1030	Truall	1135	1135	45	142	51	33755	1,721,505	1,721,505	Përshkrimi i veçantë: pasuria shpronësohet për sipërfaqen 65.2 m ² me VKM-në nr. 230, datë 21.3.2017, ref. 8010; D-mbi këtë truall pozicionohet ndërtesa me nr. pas. 13/191-nd., vol. 40 f. 84 z.k. 8190; E- kufizohet kryerja e veprimeve me pasurinë në zgjidhjen e problematikës së krijuar; të moskryhet asnjë veprim me pasurinë masë sigurie padie në origjinë të pasurisë.
2	Bashkëpronarët		Bajrami, Berami, Guri, Hasa, Cingo, Musta, Dapi, Kora, Vako, Nelku, Elmazi, Haruni	Tiranë	8190	13/1031	Truall	296	296	45	143	19	33755	641,345	641,345	Përshkrimi i veçantë – pasuria shpronësohet për sipërfaqen 65.2 m ² me VKM-në nr. 230, datë 21.3.2017, ref. 8010; mbi këtë truall pozicionohet ndërtesa 13/191-nd. Ka pesë ndërtime pa leje. Regjistrohet kontrata e shitjes me kusht për pjesët takuese të Besnik Bajramit, Ramazan Bajramit, Majlinda Bajramit, Irma Hadros, Altin Bajramit



3	Bashkëpronarët		Bajrami, Berami, Guri, Hasa, Cingo, Musta, Dapi, Kora, Vako, Nelku, Elmazi, Haruni	Tiranë	8190	13/185	Truall	1938	1938	4	226	66	33755	2,227,830	2,227,830	Vendoset masa sekuestro konservative nga përmbartes Euglent Osmanaj. Regjistrohet kontrata e shitjes me kusht për pjesët takuese të Besnik Bajramit, Ramazan Bajramit, Majlinda Bajramit, Irma Hadro, Altin Bajrami.
4	Bashkëpronarët		Bajrami, Berami, Guri, Hasa, Cingo, Musta, Dapi, Kora, Vako, Nelku, Elmazi, Haruni	Tiranë	8190	13/186	Truall	1938	1938			35	33755	1,181,425	1,181,425	Kjo pasuri është okupuar regjistrohet kontrata e shitjes me kusht për pjesët takuese të Besnik Bajramit, Ramazan Bajramit, Majlinda Bajramit, Irma Hadro, Altin Bajrami.
5	Gentian	Dhimitraq	Milo	Tiranë	8190	13/189	Truall	365	365	4	230	46	33755	1,552,730	1,552,730	Përshkrimi i veçantë: l. Leg. nr. 91796, datë 3.6.2016; VKM-ja e shpronësimit nr. 230, datë 21.3.2017, godinë banimi 2-katëshe + 1 kat nëntokë; sip. e katit përdhe 103.9 m ² , sip. e verandës + shkallëve 18.7 m ² ; sip. e katit të parë 152.4 m ² , sip. e bodrumit 60.1 m ² , kufizohen veprimet, vendim gjykatë për sigurim padie.
6	Behar, Robert		Maili, Feto	Tiranë	8190	13/455	Truall	3680	3680	8	249	48	0	-	-	Ka një ndërtim të paligjshëm. Bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil nr. 1177 datë 16.10.2009, përcjellë në ZVRPP Tiranë me dosjen përmbartimore nr. 3799 prot., datë 8.3.2010, është vendosur “anulimi i pjesshëm i VKKKP-së nr. 410/1995, dhe njohja trashëgimtar në sip. 2500 m ² , të trashëgimtarëve të Ali Beramit, sipas pjesëve që i vijnë nga trashëgimia. Në këto kushte të jepet pëlqimi me deklaratë noteriale nga të gjithë bashkëpronarët për transaksionet e kryera ose pasojat të rregullohen me vendim gjykatë. Bllokohet pasuria në favor të shoq.



																	“Girona” sh.p.k.; menaxhuar me leje ndërtimi.
7	Bashkëpronarët		Bajrami, Berami, Guri, Hasa, Cingo, Musta, Dapi, Kora, Vako, Nelku, Elmazi, Haruni	Tiranë	8190	13/856	Truall	9667	9667	34	117	44	33755	1,485,220	1,485,220		Regjistrohet kontrata e shitjes me kusht për pjesët takuese të Besnik Bajramit, Ramazan Bajramit, Majlinda Bajramit, Irma Hadros, Altin Bajramit.
8	Fatmir	Han	Peposhi	Tiranë	8190	8/1101	Truall	375	375	42	244	13	33755	438,815	438,815		Përshkrim i veçantë - leje legalizimi nr. 124643, datë 20.8.2019, objekt banimi 2-katëshe, sip. e katit përdhe 107.6 m ² , sip. e katit të parë 96 m ² .
9	Petrit	Fadil	Tresa	Tiranë	8190	8/1084	Truall	500	500	40	126	15	33755	506,325	506,325		
10	Ilir	Sali	Bezati	Tiranë	8190	8/819	Truall	338	338	24	98	16	33755	540,080	540,080		Përshkrimi i veçantë: l. Leg. nr. 2624606, datë 14.12.2017, godinë banimi 3-katëshe; sip. e katit përdhe 128.0 m ² ; sip. e kati të parë 1.2 m ² ; sip. e verandës 11.7 m ² ;
11	Mahmut	Dervish	Abazi	Tiranë	8190	15/845	Truall	947	947	35	111	151	33755	5,097,005	5,097,005		Përshkrimi i veçantë: l. Leg nr. 126568, datë 27.7.2020, godinë banimi 2-katëshe +1 kat nëntokë, sip. e katit nëntokë 108.6 m ² ; sip. e katit përdhe 111.1 m ² , verandë + shkallë 22.1 m ² , sip. e katit të parë 102.8 m ² , verandë 24.2 m ²



12	Osman		Abazi	Tiranë	8190	15/801	Truall	725	725	32	63	245	33755	8,269,975	8,269,975	
13	Bashkëpronarët		Abazi, Çullhaj, Derja, Balla, Mumajesi, Hoxha, Raufi.	Tiranë	8190	15/424	Truall	715	715	42	228	246	33755	8,303,730	8,303,730	Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa 8/858-nd. vol. 35, f. 212, Halim Biba. Ndërtesa 8/857-nd., z.k. 8190, në pronësi të Petrit Bibës. Ka 5 ndërtime të paligjshme.
14	Shefqet	Maliq	Abazi	Tiranë	8190	15/401	Truall	98	98	11	105	98	33755	3,318,117	3,318,117	D- e vlefshme për shpronësim pranë institucionit përkatës sipas planit të rëlevimit ortofoto është rrugë.
15	Bajram	Col	Gelaj	Tiranë	8190	15/400	Truall	400	400	11	104	18	33755	607,590	607,590	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim pa leje.
16	Reshat	Dervish	Abazi	Tiranë	8190	15/393	Truall	1281	1281	10	213	256	33755	8,641,280	8,641,280	K. shitje.
17	Bashkëpronarët		Taip Maliq Abazi; Enver Maliq Abazi; Bardhyl Abazi; Hatixhe Balla; Haxhire Bakalli; Haziz Abazi; Kaje Mumajesi; Kumeri Balla; Muharrem Abazi; Musa Abazi; Osman Abazi; Razije Raufi; Refik Abazi; Sheqere Abazi; Sherife Abazi; Veli Abazi; Xharije Abazi; Xhemile Abazi; Shefqet Maliq Abazi;	Tiranë	8190	15/381	Truall	280	280	10	143	144	33755	4,860,720	4,860,720	Ka tri ndërtime të paligjshme.



			Afmet Maliq Abazi; Pashe Maliq Picori; Fiqirete Maliq Varosi; Pasha Ramazan Derja; Mereme Pasha Bardhi; Hasan Pasha Derja; Ismail Pasha Derja; Selim Pasha Derja; Hanke Pasha Bardhi; Flutura Pasha Haxhiu													
18	Veli		Abazi	Tiranë	8190	15/380	Truall	1300	1300	10	142	256	33755	8,641,280	8,641,280	Përshkrim i veçantë: - leje leg. nr. 127411, datë 17.1.2021, godinë banimi 3-katëshe, sip. e katit përdhe 123 m ² ; sip. e katit të parë 125.9 m ² (verandë 20 m ²); sip. e katit të dytë 125.9 (verandë 20 m ²).
19	Petrit	Bardhok	Lleshi	Tiranë	8190	15/365	Truall	400	400	10	40	145	33755	4,894,475	4,894,475	D- rivlerësohet pasuria për shumën 13502000 lekë, E- ka tri ndërtime të paligjshme.



20	Seit	Ismail	Tresa	Tiranë	8190	15/339	Truall	708	708	10	10	20	33755	675,100	675,100	Leje legalizimi nr. 125035, datë 31.1.2020 godinë banimi 3-katëshe + papafingo sip. e katit përdhe 119.1 m ² , sip. e katit të parë 119.1 m ² , (verandë + shkallë 23.3 m ²), sip. e katit të dytë 115.1 m ² (verandë + shkallë 52.9 m ²), sip. e papafingos 83.4 m ² (verandë 76 m ²); mbi këtë truall pozicionohet pjesërisht nd. me nr. 8/857-nd. z.k. 8190 në pronësi të Petrit Biba. Ka dy ndërtime të paligjshme.
21	Bashkëpronarët		Mevlude Zaim Parllaku; Alban Bajram Parllaku; Dritan Bajram Parllaku; Gëzim Bajram Parllaku; Mimoza Bajram Krasniqi	Tiranë	8190	15/272	Truall	400	400	7	224	20	33755	675,100	675,100	Ka një ndërtim të paligjshëm.
22	Altin	Dalip	Hysa	Tiranë	8190	15/267	Tuall	300	300	6	99	45	33755	1,518,975	1,518,975	K. shitje.
	Shuma													65,798,622	65,798,622	
	Shënime.															

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në të dhënat e marra nga konfirmimi i Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Jug nr. prot. 5365/1, datë 8.7.2021.

3. Për llojin e pasurisë trotuar, rrugë, shesh në pronësi të shtetit janë konfirmuar me shkresën nr. prot. 2389/1, datë 4.7.2019 dhe janë hequr nga tabela e llogaritjeve paraprake sipas shkresës së MIE-së me nr. prot. 8406/1, datë 30.12.2019.



VENDIM
Nr. 363, datë 26.5.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 436, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITET AKADEMIKE 2020–2021 DHE 2021–2022 E NË VIJIM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1 Kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë), mund të aplikojnë edhe në programet e studimit të gjuhëve të huaja dhe në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë “Master” në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të vendimit, por këta kandidatë pajisen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me numër të veçantë matrikullimi, i cili nuk i lejon të ndjekin më pas programet e ciklit të dytë “Master” në fushën e mësuesisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 367, datë 30.5.2022

PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË HOLLËSISHME DHE INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT, HEDHJES NË TREG, PRODHIMIT, IMPORTIMIT APO FUTJES NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË QESEVE PLASTIKE MBAJTËSE, SI DHE QESEVE PLASTIKE MBAJTËSE TË OXO-DEGRADUESHME APO OXO-BIODEGRADUESHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e masave të hollësishme për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, me trashësi të mureve të qeses për çdo anë më të vogël se 70 mikronë, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 kilogramë dhe me përmasa më të vogla se 50 cm gjatësia dhe 24 cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve, nga subjektet, sipas parashikimeve të këtij vendimi, nga data 1 qershor 2022.

2. Përfshihen nga zbatimi i këtij vendimi qeset plastike mbajtëse me trashësi për çdo anë 70 dhe më të madhe se 70 mikronë, me kapacitet mbajtës 10 dhe mbi 10 kilogramë, me përmasa 50 cm gjatësia dhe 24 cm gjerësia dhe më të mëdha se kaq, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve.

3. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (këtu e në vijim “ISHMT”) është institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të



hollësisht për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike mbajtëse, si më poshtë vijon:

a) mbikëqyr dhe kontrollon subjektet që përdorin dhe/ose i ofrojnë konsumatorit gjatë veprimtarisë tregtare qeset plastike mbajtëse dhe qeset plastike të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme nëpërmjet kontrollit dokumentar dhe fizik të tyre, sipas kritereve ligjore të përcaktuara në këtë vendim;

b) inspekton me mjete të certifikuara për verifikimin e parametrave të trashësisë së mureve të qeses plastike;

c) inspekton subjektet për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi sipas pikës 1, për të cilat ka marrë njoftim nga autoriteti doganor sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 6, të këtij vendimi, dhe njofton autoritetin doganor, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë mbi vendimmarrjen për subjektet dhe mallrat e inspektuara, mbi lejimin apo ndalimin e qeseve plastike për t'u futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

ç) në rastet kur subjektet nuk respektojnë kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, ISHMT-ja ndalon tregtimin e qeseve plastike, procedon me sekuestrimin dhe vendosjen e gjobës, sipas parashikimeve të pikës 25/1, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

d) njofton në mënyrë të menjëhershme Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave për ruajtjen në ambientet e përcaktuara për këtë qëllim të qeseve plastike të sekuestruara deri në marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit nga ISHMT-ja;

dh) njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për vendimin përfundimtar për subjektet e inspektuara.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të hollësisht për ndalimin e prodhimit të qeseve plastike mbajtëse, si më poshtë vijon:

a) organizon dhe zhvillon fushata ndërgjegjësuese mbi ndalimin e prodhimit, përdorimit, importit dhe futjes së qeseve plastike mbajtëse, qeseve plastike të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të këtij vendimi;

b) njofton menjëherë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, subjektet e pajisura me leje

mjedisore për prodhimin e qeseve plastike, mbi ndalimin e prodhimit të qeseve plastike sipas parashikimeve të ligjit nr. 10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe kërkesave të këtij vendimi;

c) inspekton dhe kontrollon subjektet që prodhojnë qese plastike për përmbushjen e kritereve të prodhimit, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi;

ç) në rastet kur subjektet nuk respektojnë kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, AKM-ja procedon me sekuestrimin dhe vendosjen e gjobës ndaj prodhuesve të qeseve plastike, sipas parashikimeve të pikës 25/1, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

d) merr masa për sigurimin e transportit dhe të ambienteve të përshtatshme për ruajtjen e përkohshme dhe magazinimin e qeseve plastike mbajtëse, qeseve plastike të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, të cilat janë sekuestruar me vendim të strukturave përgjegjëse të inspektimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

dh) merr masa deri në lidhjen e kontratës për vijimin e procedurës për riciklimin e sasisë së qeseve plastike të sekuestruara sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet, kur vendimi për sekuestrimin e qeseve plastike ka marrë formë të prerë sipas legjislacionit në fuqi;

e) krijon regjistër të dhënash, për:

i. masat e marra ndaj subjekteve që prodhojnë qeset plastike mbajtëse dhe qese plastike të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme;

ii. të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për subjektet e inspektuara;

iii. sasi të sekuestruara të qeseve plastike mbajtëse dhe qese plastike të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme nga subjektet që kryejnë importin, futjen dhe përdorimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike të ndaluara;

iv. prodhuesit e qeseve plastike mbajtëse, qeseve të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme dhe subjektet të cilat tregtohen për qëllime përdorimi qeset e prodhuara.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për pajisjen e strukturës përgjegjëse për inspektimin në mjedis dhe asaj të



mbikëqyrjes së tregjeve me mjete të certifikuar për verifikimin e parametrave të trashësisë së mureve të qeses plastike 70 mikronë për çdo anë.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është struktura kryesore përgjegjëse për ndalimin e importimit (çlirim për qarkullim të lirë) apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike, objekt i këtij vendimi, duke marrë masat e hollësishme, si më poshtë vijon:

a) mbikëqyrjen dhe kontrollin e personave/subjekteve që importojnë apo fusin në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, qese plastike të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme me parametra, me trashësi të mureve të qeses për çdo anë më të vogël se 70 mikronë, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 kilogram dhe me përmasa më të vogla se 50 cm gjatësia dhe 24 cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve;

b) verifikimin e të dhënave që ka deklaruar personi për qeset plastike. Në rast se në deklaratën doganore të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, të sakta, autoriteti doganor kryen verifikimin e parametrave të gjatësisë dhe gjerësisë së qeses plastike mbajtëse dhe qeses plastike të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

c) në rast se autoriteti doganor dyshon se qeset plastike mbajtëse, qeset plastike të oxo-degradueshme dhe të oxo-biodegradueshme nuk janë konform standardit, njofton menjëherë në rrugë elektronike ISHMT-në:

i. në rast se brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 3, ISHMT-ja konfirmon se qeset plastike përmbushin standardet autoriteti doganor çliron mallin;

ii. në rast se brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 3, ISHMT-ja konfirmon se qeset plastike nuk përmbushin standardet autoriteti doganor kryen procedurat e parashikuara në legjislacionin doganor për mallrat e ndaluara;

ç) në rast konstatimi se parametrat e verifikuar nuk përputhen me ato të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, autoriteti doganor procedon me bllokimin e mallit dhe kryen procedurat e tjera të parashikuara në legjislacionin doganor për mallrat e ndaluara. Njëkohësisht njofton menjëherë në rrugë elektronike dhe zyrtarisht Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe ISHMT-në për vijimin e procedurave

të mëtejshme të vendosjes së gjobës dhe sekuestrimit të qeseve plastike, të ndaluara.

7. Personi/subjekti, që importon qese plastike, objekt të këtij vendimi, deklaron në degët doganore se qeset plastike mbajtëse dhe qeset plastike të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme përmbajnë elementet sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe mban përgjegjësi për mosdeklarim apo deklarim të rremë sipas legjislacionit në fuqi.

8. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe agjencitë rajonale të mjedisit raportojnë periodikisht çdo javë, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, lidhur me:

a) konstatimin e rasteve të shkeljes të kërkesave të këtij vendimi;

b) vendimet përkatëse të marra nga inspektoratet përgjegjëse;

c) sasitë e importuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Shpenzimet për transportin, ruajtjen e përkohshme, sekuestrimin, magazinimin dhe riciklimin e qeseve të sekuestruara mbulohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

10. Të ardhurat e krijuara nga procesi i riciklimit të qeseve plastike të sekuestruara klasifikohen si të ardhura dytësore dhe përdoren nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

11. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



UDHËZIM

Nr. 1, datë 26.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR HEQJEN DORË NGA REKURSET E
DEPOZITUARA NGA ADMINISTRATA
SHTETËRORE NËN PËRGJEGJËSINË E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË
PASHQYRTUARA NGA GJYKATA E
LARTË, PËR DISA ÇËSHTJE ME
NATYRË CIVILE DHE
ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 472 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të nenit 56 e vijues të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, duke mbajtur në konsideratë stokun e çështjeve gjyqësore të prapambetura dhe numrin e lartë të çështjeve të reja që regjistrohen në Gjykatën e Lartë, ngarkesën e krijuar për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve efektivë në Gjykatën e Lartë, si dhe rëndësinë jetike të rritjes së eficiencës në sistemin e drejtësisë dhe zbatimin e plotë të reformës në drejtësi, si një nga objektivat dhe prioritetet madhore të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Administrata shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, heq dorë nga rekursët e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, kundër vendimeve të gjykatave të apelit dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet me natyrë civile dhe administrative me objekt:

a) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhëniet e punës, në të cilat administrata shtetërore, në përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, shfaqet në cilësinë e punëdhënësit, kur gjykata e apelit apo Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur pranimin e padisë dhe përmbushjen e detyrimit nga institucioni, në vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) njohjen/vërtetimin e vjetërsisë në punë, si dhe vërtetësinë/pavërtetësinë/njohjen e të dhënave

të dokumentit (librezë pune, regjistër themeltar, listëpagesa, libër pagash, vërtetim e të tjerë);

c) shpërblimin për dëmet pasurore apo jopasurore, kontraktore ose jashtëkontraktore ndaj personave fizikë e juridikë, privatë, vendas e të huaj, kur gjykata e apelit apo Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur pranimin e padisë dhe shpërblimin e dëmit nga institucioni, në vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) ndryshimin, shfuqizimin apo konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, të nxjerrë nga organi publik, kur plotëson një nga këto kushte:

i. Këto kërtime nuk janë të shoqëruar me kërkimin për shpërblimin e dëmit apo për shlyerjen e detyrimeve të tjera financiare, si dhe nuk dëmtojnë interesat pasurore të shtetit; ose

ii. Gjykata e apelit ose Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë dhe detyrimin e organit publik për shpërblimin e dëmit apo shlyerjen e detyrimeve të tjera financiare, në vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

d) detyrimin e organit publik për të nxjerrë aktin administrativ për të kryer veprimin administrativ ose një veprim tjetër administrativ, kur plotëson një nga këto kushte:

i. Këto kërtime nuk janë të shoqëruara me kërkimin për shpërblimin e dëmit apo për shlyerjen e detyrimeve të tjera financiare, si dhe nuk dëmtojnë interesat pasurore të shtetit; ose

ii. Gjykata e apelit ose Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë dhe detyrimin e organit publik për shpërblimin e dëmit apo shlyerjen e detyrimeve të tjera financiare, në vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

2. Përveç çështjeve me objekt të cilësuar, sipas pikës 1, të këtij udhëzimi, administrata shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, heq dorë nga rekursët e paraqitura, përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi edhe për:

a) paditë e tjera, pavarësisht llojit të kërtimeve në objekt, të depozituara prej institucioneve të administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e



Këshillit të Ministrave, për të gjitha çështjet administrative dhe civile me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi, për të cilat gjykatat e apelit ose Gjykata Administrative e Apelit kanë vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e padisë;

b) paditë që, pavarësisht llojit të kërtimeve në objekt dhe vlerës së tyre, rezultojnë të kenë mbetur pa objekt, për shkak të shuarjes së rrethanave të çështjes;

c) paditë për të cilat, pavarësisht llojit të kërtimeve në objekt, gjykata e apelit apo Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë dhe përmbushjen e detyrimit dhe/ose shpërblimin e dëmit nga organi publik, në vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi, i cili është ekzekutuar plotësisht dhe që plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

i. çështja është humbur nga organi publik në të dyja shkallët e para të gjykimit; ose

ii. çështja vlerësohet si e pafitueshme, nisur nga vendimet unifikuese/njësuese të kolegjeve të bashkuara ose të kolegjeve të veçanta.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij udhëzimi, zbatohen edhe nga shoqëritë tregtare me mbi 50% kapital shtetëror, aksionet ose kuotat e të cilave zotërohen nga institucionet e administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

4. Heqja dorë nga rekursi, sipas këtij udhëzimi, bëhet vetëm në rastet kur Gjykata e Lartë nuk ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

5. Heqja dorë nga rekursi bëhet me shkrim, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin procedural civil dhe administrativ, pasi organi administrativ ta ketë arsyetuar atë në bazë të një prej rasteve të parashikuara në dispozitat e këtij udhëzimi.

6. Në rastet kur institucioni përfaqësohet nga Avokatura e Shtetit, kjo e fundit shqyrton kërkesën e institucionit ndërgjyqës për heqjen dorë nga rekursi, përpara se ajo të dorëzohet pranë Gjykatës së Lartë. Në rast se edhe Avokatura e Shtetit konstaton rrethanat e heqjes dorë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, ajo vijon me

paraqitjen e kërkesës për heqjen dorë nga rekursi pranë Gjykatës së Lartë.

7. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore dhe shoqëritë tregtare me mbi 50% kapital shtetëror, aksionet ose kuotat e të cilave zotërohen nga institucionet e administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 234, datë 24.5.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të shkresës nr. 465/2 prot., datë 18.5.2022 “Kërkesë për miratimin e autorizimeve për lëvizjet e punonjësve jashtë qendrës së punës” nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë te drejtori i përgjithshëm, z.Ergys Qirici për dërgimin me shërbim brenda vendit jashtë qendrës së punës, të punonjësve të Ndhmës Juridike Falas.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja



URDHËR
Nr. 313, datë 24.5.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, z.Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, do të ushtrohen për periudhën nga data 25.5.2022 deri në datën 30.5.2022.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrin ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z.Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë